

Dr. Musli Vërbani

# Dashuria

12



Planprogrami i muslimanit të vogël

*Korrik, 2004*

**Dr. Musli Vërbani**

# **DASHURIA**

**12**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

Kaçanik, 2011

*Autor:*  
**Dr. Musli VËRBANI**

*Titulli:*  
**MORALI I MUSLIMANIT TË VOGËL**

*Korrektura:*  
**Burim Bunjaku**

*Radhitja kompjuterike,  
kopertina dhe dizajni grafik*  
**Mumin Shehu**

*Botues:* **Autori**

*Shtypi:*  
**“FokusPrint”**

***Të drejtën e ribotimit e rezervon autori***

## Hyrje

Dashuria është jetë, është forcë, është lumturi, por gjithashtu është dritë e zemrës dhe e shpirtit.

Dashuria është prej ibadeteve më të vlefshme dhe më të rëndësishme; dashuria është lidhje e besatimit në mes të krijesës dhe Krijuesit, pra, në mes të njeriut dhe Zotit.

Dashuria është fuqi e mrekullueshme. E kundërta e dashurisë është urrejtja.

Dashurinë, Kur'ani e konsideron civilizim, shkencë, urtësi dhe udhëzues, i cili shpie te shpirti më i pastër.

Dashuria është prej ibadeteve më fisnike dhe qëllimeve më të larta, me të pastrohet zemra, ndriçohet shpirti dhe lulëzon jeta.

Çdo njeri, i cili ka karakterin e fortë, moralin dhe edukatën e mirë, e duan njerëzit dhe i do ata.

O fëmijë, punoni punë të mira do të shpërbleheni me dashuri dhe simpati. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

*“I Gjithëmëshirshmi në zemrat e besimtarëve do të përgatitë ambient që ata t'i duan të tjerët, të tjerët t'i duan ata; ata ta duan Allahun, dhe Allahu t'i dojë ata”.*

*(Merjem, 96)*

Nuk ka më mirë se shoqëria të mbushet me dashuri për Allah dhe që të gjithë të bëhen si një grusht, ashtu që prindërit i duan fëmijët, fëmijët i duan prindërit; burri ta dojë bashkëshorten, bashkëshortja ta dojë burrin; vëllai e do vëllanë; shoku shokun, e

kështu me radhë. Muslimani e do vendit dhe atdheun e tij, ai do moral të mirë, dhe do çdo të mirë rreth tij.

Nëse pyesim veten: “Kush është krijuesi i dashurisë? Nuk do të kishim gjetur përgjigjie të qartë e të saktë në mendje tona, përderisa ajetin kur’anor:

***“... s'ka dyshim se All-llahu do ta sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin), ...”.***

*(El-Maide, 54)*

Nëse bëhet pyetja se kush është zbatuesi më i mirë i dashurisë, përgjigjja është: Zbatuesi më i mirë i dashurisë është Muhamedi s.a.v.s., krijesa më e mirë e Allahut dhe rob i dashur i Allahut, i zgjedhur, i dërguar për njerëzimin.

## DASHURIA NDAJ ALLAHUT

Dashuria e parë dhe kryesore është dashuria ndaj Allahut të Lartmadhëruar. Nuk ka dashuri më të mirë dhe më të çmuar; nuk ka dashuri më fisnike se dashuria ndaj Allahut të Lartmadhëruar. Besimtari i mirë në çdo kusht e ruan këtë dashuri, sepse kjo i sjell lumturi dhe shpëtim edhe në këtë botë edhe në botën tjetër.

Dashuria e besimtarit ndaj Zotit të tij duhet të jetë e veçantë ndaj çdo dashurie tjetër. Nuk lejohet të jetë sikurse dashuria ndaj fëmijës, apo ndaj prindit, apo sikurse dashuria ndaj bashkëshortes, apo sikurse dashuria ndaj pasurisë, as sikurse dashuria ndaj shokëve. Askush prej krijesave nuk lejohet të ndërhyjë në dashurinë ndaj Krijuesit.

Ashtu siç duhet të jetë dashuria për Allah, ashtu duhet të jetë edhe rrjeta për Allah. Ne dimë se shumë do të digjen në zjarr, sepse i duan e i adhurojnë të tjerët pos Allahut; po ashtu ka njerëz, të cilët do të hynë në xhenet, sepse i urrejnë banorët e zjarrit.

Ka lloj dashurie që të afron te Zoti, ka lloj dashurie që të largon prej Zotit.

Ka lloj dashurie që të qon në xhenet; ka lloj dashurie që të qon në xhehenem.

Dashuria është që të lartëson, por mund të jetë edhe ajo që të poshtëron.

Dashuria ndaj Allahut dhe për Allah është dashuri që të lartëson, dhe të ngritë në shkallët më të larta të reputacionit, pastaj fiton begatitë më të mëdha, më të çmueshme dhe të përgjithmonshme në xhenetit më të larta, të cilat janë begati për të devotshmit.

Dashuria që poshtëron është dashuria ndaj disa krijesave që nuk kanë për qëllim kujtimin e Allahut, por largimin nga Allahu. Ajo dashuri është dashuri e epshit dhe e emocioneve, të cilat dirigjohen prej vesveseve të shejtanit, dhe që të shti në zjarr përgjithmonë.

Për të qenë njeriu i kompletuar dhe i çliruar tërësisht patjetër duhet të jetë i çliruar nga pesë cilësi, e ato janë: Çlirimi nga epshi, nga urrejtja, nga lakmia, nga tradhtia dhe plogështia. Të gjitha këto cilësi janë cilësitë e kundërta të dashurisë.

Ashtu siç është dashuria ndaj Allahut, ashtu është edhe dashuria e Allahut ndaj robit të Tij.

## DASHURIA PREJ ALLAHUT

Pejgamberi s.a.v.s. na tregon dashurinë e Zotit ndaj njeriut duke thënë kështu:

*“Nëse Zoti e do një njeri, e thërret Xhibrilin dhe thotë: “O Xhibril, Unë e dua filanin, prandaj duaje dhe ti, dhe e do atë njeri Xhibrili. Më pas Xhibrili thërret e thotë: “O barorë të qiellit, Allahu e do filanin, prandaj duajeni edhe ju dhe atë njeri e duan banorët e qiellit. Më pastaj dashuria i vendoset edhe tek njerëzit në tokë”.*

Në hadith kudsij Allahu i Lartmadhëruar thotë:

*“Nuk ka çështje më të mirë për robin tim, se sa kur të më afrohet Mua, dhe nuk ka çështje më të dashur për Mua se sa kryerja e obligimeve. Njeriu do të vazhdojë duke kryer detyra tjera shtesë (nafile) ndaj Meje derisa ta dua, e kur ta dua, do të bëhem vesh me të cilin dëgjon, dorë me të cilën punon, këmbë me të cilat vepron. Çdo herë kur të kërkojë diçka prej Meje do t’ia jap dhe çdo herë kur të kërkojë mbrojtje prej Meje do ta mbroj”.*

Dashuria më e madhe e Allahut për njeriun është që në xhenet do t’i thotë atij: *“O robi im! Unë jam i kënaqur me ty, po ti a je i kënaqur me Mua?”.*

## DASHURIA PËR ALLAH

Ashtu siç duhet të jetë dashuria ndaj Allahut, ashtu është dashuria e Allahut ndaj robit të Tij, por nuk është vetëm kjo, sepse robi duhet të dojë edhe të tjerët pos Allahut, Omeri r.a. transmeton se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Ka prej njerëzve që janë robër të Allahut, të cilët nuk janë as pejgamber, e as dëshmorë, mirëpo për shkak të afërsisë që do të kenë me Allahun në ditën e Kijametit, do t’ua kenë lakmi pejgamberët dhe shehidët”.*

*Kur e pyesin: “O i Dërguar i Allahut, a po na tregon se kush janë ata njerëz”. Pejgamberi s.a.v.s. u thotë:*

*“Ata janë një popull, të cilët duhen vetëm për Allahun, Ata nuk janë vëllezër prej nëne e fisi, dhe nuk kanë mes vete interes material.. Për Zotin fytyrat e tyre do të jenë dritë, ata do të jenë reflektorë drite. Nuk do të frikohen kur frikohen njerëzit dhe nuk do të jenë të pikëlluar kur pikëllohen njerëzit. Pastaj ka lexuar ajetin kur’anor:*

*“E pra, nuk ka dyshim se për të dashurit e Allahut nuk ka frikë për ta, e ata nuk do të jenë të pikëlluar”.*

*(Ebu Davudi)*

Kush do për Allahun, urren për Allahun, jep vetëm për Allahun, pengon vetëm për Allahun, ai e ka plotësuar imanin.

Allahu i do ata të cilët vizitohen për Allahun.

Allahu i do ata të cilët duhen për Allahun.

Allahu i do ata të cilët ndihmohen për Allahun.

## DASHURIA E ALLAHUT

Abdullah bin Husejni r.a. kishte një robëreshë nga një vend të largët. Një natë prej netëve ajo zgjohet, merr abdest, fal namaz dhe në fund të namazit bie në sexhde dhe në sexhde bën këtë lutje, me zë paksa të ngritur:

*“O Zoti im! Për dashurinë tënde ndaj meje m’i fal mëkatet”.*

Abdullahu e dëgjon dhe pastaj i thotë: “Mos thuaj ashtu, por thuaj:

*“Për dashurinë time ndaj Teje”*, sepse ndoshta Allahu nuk të do ty”.

Ajo i thotë: “Po mos të më kishte dashur Allahu, nuk do t’më kishte zgjuar derisa ti flije. Allahu me dashurinë e Tij më ka larguar prej vendit (familjes) pabesimtare dhe jam blerë nga familja besimtare”.

Në atë çast Abdullahu i thotë: “Shko ti je e lirë për hir të Allahut”. Ajo i thotë: “Pronari im, po më bën keq, sepse më parë kisha dy shpërblime për një vepër, e tani do të kem vetëm një”. Pastaj klithi dhe tha: “Më liroi zotëria i vogël, po si do të jetë lirimi prej Zotit tim të Madh dhe i bie të fikët dhe shpirti i saj u ngrit në qiell duke qenë e kënaqur me Zotin, e Zoti i kënaqur me të.

## DASHURIA E ALLAHUT NDAJ ROBIT TË TIJ

Dashuria e Allahut ndaj robit të Tij do të thotë se Ai ia do të mirën robit, është i kujdesshëm dhe i sjellshëm ndaj tij dhe e nderon në forma të ndryshme.

Nderimi i Allahut ndaj robit të Tij ndonjëherë manifestohet duke i dhuruar të mira, por ndonjëherë duke e penguar përkohësisht nga ndonjë e mirë, ndonjëherë duke e furnizuar me begati të mëdha, por ndonjëherë duke ia ngushtuar furnizimin për ta ngritur në nivel të lartë.

Kjo dashuri nuk vërehet fizikisht, dhe nuk kuptohet me shqisa dhe nuk krahasohet me krahasimin tonë, por vetëm mund të kuptohet vetëm si një dritë e cila depërton thellë në zemër dhe në atë thellësi të zemrës, takohet dashuria me dashuri.

Kur Allahu e do robin e Tij, depërton dashuria në zemrën e atij robi, e cila dashuri reflekton dritë në zemrën e tij dhe bën që ai të kuptojë Allahun dhe ta dojë Atë.

## RABIA ADEVIFE

Rabija Adevife ishte një grua muslimane, e cila ka qenë tepër e devotshme. Në ditë ajo zgjohet herët në mëngjes merr abdest, fal namaz dhe pas përfundimit të namazit e bën këtë dua:

*“O Zoti im! Për dashurinë Tënde që ke ndaj meje, falmi gabimet”.*

Njëri i cili ishte prezent i thotë: “Mos thuaj ashtu”. – Po si të them? – Thuaj: *“Për dashurinë time ndaj Teje, falmi gabimet”.*

Ajo i thotë: “Po mos të më kishte dashur Allahu nuk do të më kishte zgjuar në këtë mëngjes. Po mos të më kishte dashur Allahu, nuk e kishte bërë këtë gjuhë që t’i lutem Atij, pora Ai më ka dashur dhe m’i ka dhënë këto begati, dhe unë i lutem Atij”.

## DASHURIA NDAJ TË DËRGUARIT S.A.V.S.

Pas dashurisë madhështore ndaj Allahut, në radhë të dytë vjen dashuria ndaj Pejgamberit s.a.v.s.

Prej kushteve të dashurisë së Pejgamberit s.a.v.s. është pasimi i sunetit të tij:

**Thuaj:** *“Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është që fal shumë, mëshiron shumë.*

*(Ali Imran, 31)*

**Thuaj (o i dërguar):** *“Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që e fituat, tregtia që frikoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se All-llahu, se i dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë, pritni derisa All-llahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur.*

*(Et-Tevbe, 24)*

Një njeri shkon te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e pyet:

*“O i Dërguar i Allahut, kur do të ndodhë Dita e Kijametit. Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: “Po çka keni përgatitur për atë ditë, pasi po pyetni?” Ai i thotë: “Asgjë, por e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij”. Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: “Ti do të jesh me atë që e do”.*

Enesi r.a., i cili ka transmetuar këtë hadith ka thënë: “Kurrë nuk kemi qenë më të gëzuar se sa në momentin kur ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.: “Ti do të jesh me atë që e do”. Pastaj Enesi ka treguar: “Unë e dua Pejgamberin s.a.v.s., Ebu Bekrin dhe Omerin r.a. dhe shpresoj se do të jem me ta pasi i dua, edhe pse nuk kam punuar sa kanë punuar ata.

Një njeri shkon te pejgamberi s.a.v.s. dhe i thotë:

*“O i Dërguar i Allahut, ty të dua më shumë se veten , më shumë se familjen, mirëpo përderisa isha në shtëpi m’u kujtua diçka dhe nuk munda të qëndroja pa ardhur për të të parë. Mirëpo kur kujtova vdekjen time dhe vdekjen tënde, kuptova se ti do të jesh në shkallë të larta me pejgamberët, e unë edhe nëse hyjë në xhenet nuk do të të shoh.*

*Pejgamberi s.a.v.s. nuk i dha përgjigje përderisa Zoti i Lartmadhëruar zbriti ajetin kur'anor:*

***E kush do që i bindet All-llahut dhe të dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata që All-llahu i shpërbleu: (me) pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe me të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!***

*(En-Nisa, 69)*

Atëherë sehabiu e kuptoi se për të qenë me të dashurin e tij, Pejgamberin s.a.v.s. duhet ta dëgjojë dhe ta pasojë rrugën e tij.

Prej plotësimit të dashurisë ndaj të dërguarit të Allahut s.a.v.s. është përsëndetja dhe të dërguarit salavate për të.

## DASHURIA E SHOKËVE TË MUHAMEDIT A.S. PËR TË

Idhujtarët e Mekes e kishin zënë rob të luftës Zejd bin Dethineten. Kur e sjellin në vendin e dënimit me vdekje, Sufjani i thotë: *“Për Zotin o Zejd, a më tregon drejt? – A kishe dashur që në këtë moment në këtë vend të jetë Muhamedi duke u dënuar me vdekje, ndërsa ti në shtëpinë tënde me familje?”* Zejdi i thotë: *“Pasha Zotin, kurrë nuk do të kisha dashur që Muhamedi të jet në këtë vend, e t’i shkaktohej ndonjë dhimbje çoftë shumë e vogël, e unë të isha në shtëpinë time me familje”*. Pastaj Sufjani ka thënë: *“Kurrë nuk kam parë njerëz, të cilën i duan të tjerët ashtu siç e duan Muhamedin shokët e tij”*

(Bejhekiu)

Kështu e kanë manifestuar sehabët dhe tabi’inët dashurinë e tyre ndaj Pejgamberit s.a.v.s., sa që kanë qenë në gjendje të japin edhe jetën e tyre.

\* \* \*

Beteja e Uhudit kishte përfunduar, luftëtarët ishin kthyer në Medine. Në hyrje të qytetit një nënë muslimane pyet se ku e ka burrin, banën dhe vëllanë e saj. I thonë se, që të tre kanë rënë dëshmorë. Atëherë ajo pyet: - Po i Dërguari i Allahut s.a.v.s. si është? I thonë: “Falë Zotit, ai është mirë, ashtu siç do ti”. Ajo menjëherë kërkon që ta shohë të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. ashtu që t’i pushojë zemra e saj. Kur e sheh, i kalon pikëllimi, e falënderon Allahun dhe thotë: “Pas kësaj fatkeqësie do të më lehtësohet dhe do t’i tejkaloj dhembjet”.

Kështu muslimani duhet të ketë dashuri ndaj të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. që ai të jetë më prioritar në dashuri ndaj babait, nënës, vëllait, bashkëshortit, bile edhe më shumë se veten e tij.

\* \* \*

Të gjithë sahabët e kanë dashur Pejgamberin s.a.v.s.  
Ebu Sufjani ka thënë: “Nuk kam parë kurrë në jetën time njerëz, të cilët e duan dikë, ashtu siç e duan shokët e Muhamedit s.a.v.s. Muhamedin.

Një ditë, një sahab shkon te Pejgamberi s.a.v.s dhe i thotë: “O i Dërguar i Allahut, të dua më shumë se prindërit e mi, të dua më shumë se veten time, mirëpo kur qëndroj në shtëpi sa po më kujtohesh nuk po mund të duroj deri sa të vij tek ti të të shoh. Mirëpo kur kujtoj vdekjen time dhe vdekjen tënde, po e kujtoj se ti do të jesh në xhenet me pejgamberët, ndërsa unë edhe po që se do të jem në xhenet nuk do të të shoh më. Pejgamberi s.a.v.s. nuk i dha përgjigje, deri sa zbriti ajeti kur'anor, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“E kush do që i bindet All-llahut dhe të dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata që All-llahu i shpërbleu: (me) pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe me të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!”***  
(En-Nisa, 69)

Atëherë sahabiu e kuptoi se duhet të angazhohet me ibadet që të arrij shkallë të larta në xhenet, e të jetë me të dashurin, Pejgamberi s.a.v.s.

\* \* \*

## DASHURIA NDAJ ATDHEUT

Atdhe quhet vendi në të cilin lind njeriu, por në të njëjtën kohë quhet edhe mëmëdhe.

Sipas islamit, muslimanët duhet ta duan atdheun e vet.

Njerëzit për shkak të nevojave shkojnë në vende të ndryshme, në të shumtën e rasteve për të kërkuar punë, ndonjëherë dëbohen, ndonjëherë maltretohen nëse nuk ikin nga atdheu. Dashuria për atdhe është prej imanit. Besimtari e do vendin e vet, punon për vendin e vet, angazhohet në përparimin dhe zhvillimin e vendit të tij. Ai kurrë nuk e harron vendin e vet.

I Dërguari ynë – Pejgamberi s.a.v.s. ka lindur në Meke, është rritur dhe ka jetuar aty; më vonë i zbrit shpallja – Kur’ani. Pas fillimit të zbritjes së Kur’anit, Muhamedi dhe shokët e tij torturohen prej banorëve të Mekes dhe dëbohen nga vendlindja e tyre.

Kur Muhamedi s.a.v.s. me Ebu Bekri Sidikin kanë migruar, në kodër të Mekes Muhamedi s.a.v.s. është ndalur, e ka shikuar disa herë me mallëngjim vendlindjen, i kanë pikur lotët dhe me mallëngjim i thotë vendlindjes:

*“Për Zotin, nuk ka dyshim se ti je vendi më i mirë i Allahut, e dua tokën e Allahut, të dua ty Meke, por po të mos më kishin dëbuar kurrë nuk do të isha larguar nga ti (mëmëdheu im)”.*

Tek pas dhjetë vjetësh të migrimit Muhamedi s.a.v.s. është kthyer në atdhe dhe e ka kryer haxhin.

## DASHURIA NDAJ PRINDËRVE

Dashuria ndaj prindërve është çelës i xheneteve dhe çelës për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

*Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese).*

*(El-Isra, 23)*

Zoti e ka barazuar Ibadetin me mirësinë ndaj prindërve.

## NËNA DHE SHEHADETI

Në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. ishte një as'hab i quajtur Alkame. Ai shoqërohej me Muhamedin s.a.v.s. dhe e dëgjonte. Mirëpo një ditë sëmuret. Ai e kuptoi se i kishte ardhur çasti i vdekjes dhe mendohej që ta thoshte shehadetin, por kot përpiquej. Kur shkoi Pejgamberi s.a.v.s. për ta vizituar kërkoi prej tij ta thoshte shehadetin, por ai nuk ishte në gjendje ta thoshte, sepse gjuha i ishte ndërlidhur në fyt. Pejgamberi s.a.v.s. pyeti për familjen e tij. Ata i thanë se ai e kishte nënën, kështu kërkoi që të prezantonte në tubimin edhe nëna e Alkames. Kur erdhi ajo Pejgamberi s.a.v.s. e pyeti: “Si është sjellë djali me ju?” Ajo i përgjigjet: “Ai ty të ka dëgjuar, ndërsa mua jo, ty të ka kënaqur, ndërsa mua më ka hidhëruar”. Pejgamberi s.a.v.s., pasi që heshti një kohë, kërkoi prej saj t’ia falte djalit të saj, por ajo refuzoi. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. urdhëroi sababët që të sjellin dru e ata i sollën drutë dhe e ndezën një zjarr. Kur nëna e pa se djali i saj do të digjej në zjarr tha: “A pjesa e zemrës sime të digjet në zjarr para syve të mi?!” Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: “Ai do të digjet në zjarr të xhehenemit nëse nuk ia falë.” Pasi që nëna ia fali djalit të saj, Alkames, atij i çlirohet gjuha dhe thotë: “Eshhedu en la ilahe il-lallah, ve eshhedu enne Muhameden abduhu ve resuluhu” dhe menjëherë pas shehadetit ndërroi jetë.

## DASHURIA NË MES TË BASHKËSHORTËVE

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

*“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.”*

*(Err-Rrum, 21)*

Raporti në mes të pjesëtarëve të familjes, e posaçërisht në mes të bashkëshortëve është raport shpirtëror, prej të cilit buron dashuria, besimi reciprok, mirëkuptimi, ndihma në ves vete, mbështetja në njëri-tjetrin dhe sakrifica për njëri-tjetrin.

Në fund po bëjmë këtë dua, të cilën na ka mësuar Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an për ta bërë:

*“Edhe ata që thonë: “O Zoti ynë dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, çka është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët.”*

*(Furkan, 74)*

## DASHURIA NDAJ FËMIJËVE

Fëmijët janë stolia e kësaj bote dhe dhuratë prej Allahut, qetësi e zemrës, ushqim i shpirtit dhe lumturi e jetës.

*Një ditë Usame bin Zejdi r.a. shkon te Pejgamberi s.a.v.s. për të kërkuar një nevojë të veten, kur arrin tek ai, sheh se me rrobat e tij kishte fshehur diçka pas vete. Usame bin Zejdi r.a. e pyet: “Çka po fsheh me ato rroba: Muhamedi s.a.v.s. shpalosi rrobat dhe ja aty ishin Hasani dhe Hysejini, dhe thotë: “Këta dy janë dy fëmijët e mi dhe dy fëmijët e vajzës sime. O Zoti im, vërtet i dua shumë këta, duaj edhe Ti, duaji edhe ata të cilët i donë këta dy”.*

*(Tirmidhiu)*

*Një ditë derisa ligjëronte në minber i sheh se si ata e kërkonin, zbriti nga lart, i mori në krah dhe tha: “Sadakallahu, i Cili ka thënë: “Nuk ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë sprovë. Dhe kur i pash këta dy fëmijë duke më kërkuar, unë për këtë arsye e ndërpreva fjalimin, zbrita dhe i mora në krah”.*

*(Tirmidhiu)*

Pejgamberi s.a.v.s. i ka dashur shumë Hasanin dhe Hysejnin dhe sa herë që i shihte i përqafonte. Po ashtu edhe vajza e Pejgamberit s.a.v.s. – Fatimja i donte dhe sa herë që i shihte i përqafonte dhe i ulte pranë vetes.

## DASHURIA E JAKUBIT NDAJ JUSUFIT A.S.

Jaëkubi a.s. ka qenë pejgamber, ai i kishte njëmbëdhjetë fëmijë. Njëri prej djemve të tij ishte Jusufi a.s., i cili ishte i vogël. Për shkak se ishte i vogël Jaëkubi a.s. Për shkak se ishte i vogël Jaëkubi a.s. e donte shumë dhe kujdesej për të. Nuk ka dyshim se edhe kafshët tregojnë kujdes dhe dashuri të veçantë ndaj më të voglit, sepse e dinë se më i vogli është i paaftë.

Kur e kanë pyetur një nënë: *“Cilin fëmijë e do më së shumti?”* Ajo është përgjigjur: *“Të gjithë fëmijët i dua shumë, të gjithë janë si një zinxhirë ku nuk dihet ku është fillimi se ku mbarimi”*. Por, pastaj prapë e kanë pyetur: - *Ndaj cilit fëmijë ke dashuri më së shumti?* Ajo është përgjigjur: *“Më së shumti e dua të voglin derisa të rritet; atë i cili zhduket derisa të kthehet dhe atë i cili sëmuret derisa të shërohet”*.

Pra, këto janë dy llojet të dashurisë: Dashuria e simpatisë dhe dashuria e mendjes. Për këtë arsye, kur njëherë Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Nuk ka besuar askush prej jush deri sa nuk më do mua më shumë se veten e tij”*. Omeri r.a. i ka thënë: *“O i Dërguar i Allahut, të dua më shumë se prindërit e mi, më shumë se pasurinë time, por nuk të dua më shumë se veten time. Muhamedit s.a.v.s. i tha: “Nuk ka besuar askush më shumë se veten e tij. Pastaj Omeri i tha: “O i Dërguar i Allahut, të dua më shumë se veten time”. Atëherë i Dërguari i Allahut i tha: “Tani o Omer e ke kuptuar dallimin në mes të dashurisë së ndjenjave, simpatisë dhe dashurisë së mendjes”*.

Këtë mund ta tregojmë me shembullin, kur e përdor ilaçin e ithët se të shëron, edhe pse ndjenjat nuk e donë, por mendja thotë: “Duaje, pse ai ilaç është rrugë e shërimit dhe e shpëtimit. Kështu edhe Jaëkubi a.s. e ka dashur Jusufin a.s. se ka qenë i vogël dhe përpos kësaj e ka ditur se vëllezërit tjerë të tij kanë xhelozi ndaj tij. Kështu Jaëkubi a.s. nga aspekti i ndjenjave të gjithë fëmijët i ka dashur njësoj, ndërsa Jusufin a.s. e ka dashur se ka qenë i vogël dhe Pejgamber i ardhshëm.

## DASHURIA NDAJ VËLLAIT

Besimtari i mirë e do Allahun, të Dërguarin e Tij, nënën e tij, babanë e tij, vëllanë e tij, motrën e tij, fëmijën e tij, farefisën e tij dhe gjithë shoqërinë.

Besimtari e di se vëllai është ai i cili i ndihmon në kohë të vështira dhe e mbron në rast rreziku. Për këtë arsye ai duron nëse ndonjëherë nga hidhërimi e qorton, edhe nëse nuk e ka me të drejtë, sepse pas hidhërimit ai mund të qetësohet kështu ka ndodhur me Musa a.s.

Musa a.s. para se të shkojë te firauni ka bërë këtë lutje:

*Ai (Musai) tha: “Ma zgjero (më ndihmo) gjoksin tim! Dhe më lehtëso në këtë punë timen! Ma zgjidh nyjën e gjuhës sime! Që ta kuptojnë fjalën time! Më cakto një ndihmëtar nga familja ime,*

*Harunin, vëllanë tim, që me të të ma forcosh fuqinë time, bëma shok atë në punën time, në mënyrë që të madhërojmë Ty më shumë,*

*(Ta ha, 25-33)*

Pastaj Haruin është bërë ndihmësi i tij. Mirëpo përderisa Musa a.s. kishte munguar 40 ditë populli i tij kishin filluar ta adhuronin një lopë prej ari. Kur kthehet Musa a.s. ia ngjet për mjekre vëllait të tij. Mirëpo vëllai i tij – Haruni i thotë: “O djali i nënës time, populli im më bënë të dobët, të paaftë, pasi deshën të më mbysin. Pastaj Musa a.s. i kalon hidhërimi dhe fjala e ëmbël e vëllait të tij ia dridhi zemrën, dhe bëri lutje: “O Zoti im, më fal mua dhe vëllanë tim, dhe na fut në xhenet së bashku, nuk ka dyshim se Ti je më i Mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve”.

Pra, Musa a.s. është lutur për vëllanë e tij, por edhe ne duhet të lutemi për vëllezërit tanë, atëherë Allahu na falë edhe gabimet tona. Ja si thotë Zoti i Madhëruar:

*O ju që besuat, vërtet, disa nga bashkëshortet tuaja dhe nga fëmijët tuaj janë armiq tuaj, andaj kini kujdes ndaj tyre, e nëse nuk merrni masa, nuk ua vini veshin dhe i falni, ta dini se edhe All-llahu është mëkatfalës, mëshirues.*

*(Et-Tegabun, 14)*

## ZEMRA E SHËNDOSHË

*Zoti im, më dhuro mua urtësi dhe më bashko me të mirët! Më bën përkujtim të mirë ndër ata që vijnë pas, më bën prej trashëguesve të xhennetit të begatshëm, dhe fale babain tim, se ai vërtet ishte nga ata të humburit, e mos më turpëro në ditën kur do të ringjallen. Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët. (bën dobi) Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë.*

*(Esh-Shuaraë, 83-89)*

Zemër e shëndosh do të thotë të pastruarit e zemrës nga idhujtaria, hipokrizia, tradhtia, mashtrimi, urrejtja dhe nënçmimi.

Nëse zemra jote i urren krijesat e Allahut nuk është e shëndosh.

Nëse zemra jote i urren krijesat e Allahut nuk është e shëndoshë.

Nëse zemra jote i urren, bën zili nuk është e shëndosh. Nëse zemra jote nuk përmbahet prej hidhërimit nuk është e shëndosh. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Nuk është hero (trim) ai, i cili fiton në ndeshje dyluftimi, por hero (trim) është ai i cili e përmban veten në rast hidhërimi”.*

Hidhërimi është shkëputës i dashurisë dhe nxitës i urrejtjes. Është vërtetuar në mjekësi se hidhërimi është prej shkaqeve kryesore të ngritjes së shtypjes së gjakut.

## RREGULLAT E DASHURISË

Dashuria është prej ibadetve më të rëndësishme, më me vlerë, prej ibadeteve më të ngritura dhe më të çmuara, andaj sikurse ibadetet i kanë rregullat e tyre ashtu edhe dashuria i ka rregullat të cilat njeriu dashurues duhet t'iu përmbahet atyre rregullave me shpirtin e tij, me trupin e tij dhe me gjuhën e tij. Nëse ndonjë rregull të asaj dashurie e shkel, atëherë vërtetohet se dashuria e tij nuk është e vërtetë, por artificiale.

Dashuria para se gjithash do të thotë sjellja me përkushtim të plotë ndaj të dashurit.

Namazi i ka rregullat e veta, po ashtu agjërimi i ka rregullat e veta, edhe zekati i ka rregullat e veta, po ashtu edhe haxhi i ka rregullat e veta. Të gjitha këto rregulla përfshihen në një rregull të përgjithshëm, ashtu siç ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

*“Adhuro (bëni ibadet) Allahut sikurse e sheh Atë, sepse, edhe pse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty”.*

Prej atyre të cilët e kanë dashur Allahun, ka të cilët iu është hequr koka, ka të cilët janë maltretuar, ka të cilët janë torturuar.

## DASHURIA DHE URREJTJA

Dashuria dhe urrejtja janë natyrshmëri e njeriut dhe janë pjesë përbërëse të jetës së njeriut.

Dashuria ka ekzistuar prej Ademit a.s., ndërsa dashuria dhe urrejtja, pra që të dyja, në trupin e njeriut kanë filluar prej dy bijve të Ademit a.s. – Habilit dhe Kabilit.

*“Lexoju (Muhammed) atyre (jehudive e të tjerëve) ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbanë, nga të cilët njërit iu pranua. Ai (që nuk iu pranua) tha: “Unë do të të mbys ty” (Kabili i tha Habilit).*

*E ai (që iu pranua) tha: “All-llahu pranon vetëm prej të singertëve”, dhe, nëse ti e zgjatë te unë dorën tënde për të më mbytur, unë nuk e zgjas te ti dorën time për të të mbytur; unë i frikësohem All-llahut, Zotit të botëve!” Unë (nuk dua të të mbys, por) dua që ta bartësh mëkatin tim dhe mëkatin tënd, e të bëhesh nga banorët e zjarrit, e ai është dënim i zullumqarëve.*

*Atëherë epsi i tij e bindi atë për mbytjen e të vëllait dhe e mbyti atë. Ai mbeti prej më të dëshpëruarve (hidhëroi prindërit, mbeti pa vëlla, u përbuz prej Zotit dhe u fut në xhehennem).*

*All-llahu dërgoi një sorrë, e cila groponte në dhe, për t'i treguar atij se si ta mbulojë trupin e vëllait. E ai i tha: “I mjeri unë, a nuk qesh i aftë të bëhem si kjo sorrë, e ta mbuloja trupin e vëllait tim?” Ashtu mbeti i penduar.*

*(El-Maide, 27-31)*

Prej dashurisë buron mëshira.  
Prej dashurisë buron bashkëpunimi.  
Prej dashurisë buron ndërlidhshmëria.  
Prej dashurisë buron lumturia, ndërsa  
Prej urrejtjes krijohet ndarja.  
Prej urrejtjes fillojnë kundërshtimet.  
Prej urrejtjes shkaktohen fatkeqësitë.

# ALLAHU I DO

Allahu i do:

1. Të drejtët,
2. të pastërtit,
3. bamirësit,
4. të devotshmit,
5. penduesit,
6. durimtarët,
7. mbështetësit në Allahun,
8. luftëtarët në rrugën e tij.

1. Për të drejtët Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
“Vërtet Allahu i do të drejtët”.

2. Për të pastërtit Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
“... dhe i do të pastërtit”.

3. Për të bamirësit Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
“Vërtet Allahu i do bamirësit”.

4. Për të devotshmit Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
“Vërtet Allahu i do të devotshmit”.

5. Për penduesit Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
“Vërtet Allahu i do penduesit”.

6. Për durimtarët Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
“Allahu i do durimtarët”.

7. Për mbështetësit në Allahut, Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
“Vërtet Allahu i do mbështetësit”.

8. Për luftëtarët Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
“Vërtet Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij të radhitur e të rreshtuar, sikurse të jenë një trup i fortifikuar”.

## ALLAHU NUK I DO

*Allahu nuk i do:*

1. Të padrejtët,
2. tradhtarët,
3. kryelartët,
4. krekosësit,
5. mendjemëdhenjtë - mashtruesit,
6. çrregulluesit,
7. shkapërderdhësit,
8. sulmuesit.
9. folkeqësit haptazi.

1. Për të padrejtët Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
*“Allahu nuk i do të padrejtët”.*
2. Për tradhtarët Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
*“Vërtet Allahu nuk i do tradhtarët”.*
3. Për të kryelartët Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
*“Vërtet Ai nuk i do kryelartët”.*
4. Për krekosësit - mashtruesit Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
*“Vërtet Allahu nuk i do të krekosurit”.*
5. Për mendjemëdhenjtë Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
*“Vërtet Allahu nuk e do atë që është mendjemadh, mashtrues”.*
6. Për çrregulluesit Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
*“Allahu nuk i do çrregulluesit”.*
7. Për shkapërderdhësit Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
*“Vërtet Allahu nuk i do shkapërderdhësit”.*
8. Për sulmuesit Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
*“Vërtet Allahu nuk i do sulmuesit (armiqësinë)”.*
9. Për folkeqësit haptazi Zoti i Lartmadhëruar thotë:  
*“Allahu nuk do që të flitet keq haptazi, pos (nëse nevojitet dëshmia) nëse u është bërë dikujt padrejtësi”.*

## POEZI

O Krijues i Dashurisë  
O Dhurues i mirësisë  
O Zgjerues i furnizimit  
Më shto dashurinë ndaj Teje  
Më shto besimin tek Ti  
Më bën t'u bëj mirë të tjerëve  
E t'ua fali gabimin atyre  
Më bën të kem dashuri të pastër  
Të jetë dashuria e robit ndaj Zotit  
E dashuria e Zotit ndaj robit  
Dashuria ndaj të Dërguarit  
Dhe dashuria ndaj krijesave.

O Zoti im, unë të besoj  
O Zoti im, unë të njoh e të pranoj  
O Zoti im, unë të dua  
O Zoti im, e dua atë që të do.

## LUTJE

O Zoti im, na bën të duam atë që Ti e do.  
Na bën të jemi të kënaqur me atë që Ti je i kënaqur.  
Na fal ne, ashtu siç i ke falur të tjerët, O Fisnik.

Ebu Jezid Bestamiiu ka thënë:

Në katër gjëra kisha gabuar:

*“Kam menduar se unë e kujtoj, e njoh, e dua dhe e kërkoj Allahun, në fund përfundova se: Kujtimi i Allahut ndaj meje është para kujtimit tim ndaj Tij; njohja e Allahut ndaj meje para njohjes sime ndaj Tij; dashuria e Allahut ndaj meje është para dashurisë sime ndaj Tij; dhe Allahu më ka kërkuar mua para se ta kërkoj Atë”.*

## ÇKA PËRFITJËMË NGA KY LIBËR

Nga ky libër përfitojmë se:

- Dashuria e parë dhe kryesore është dashuria ndaj Allahut.
- Dashuria e dytë është dashuria ndaj të Dërguarit të Tij dhe kusht i dashurisë ndaj tij është pasimi i Sunetit.
- Besimtari, pasi që ta dojë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e do atdheun, prindërit, fëmijët, vëllanë, farefisën dhe të gjithë shoqërinë.
- Kush i do të tjerët për Allahun dhe u ndihmon të tjerëve për Allahun, ai e ka plotësuar imanin.
- Dashuria është prej ibadeteve më të çmuara dhe më të rëndësishme.
- Prej dashurisë buron bashkëpunimi, ndërlidhja dhe lumturia.
- Allahu i do të drejtët, të pastërtit, bamirësit, të devotshmit, pendimtarët, durimtarët, mbështetësit në Allahun dhe luftëtarët në rrugën e Tij.
- Urrejtja ka ekzistuar që nga dy bijtë e parë të Ademit a.s., Habilit dhe Kabilit.
- Prej urrejtjes krijohet ndarja, fillojnë kundërshtimet dhe shkaktohen fatkeqësitë.
- Allahu i urren të padrejtët, tradhtarët, kryelartët, ata që krekosen, mendjemëdhenjtë, çrregulluesit, shkapërderdhësit, sulmuesit dhe folkeqësit haptazi.

## PËRFUNDIM

Të kujtojmë se dashuria është prej ibadeteve më të çmuara dhe më të rëndësishme, e prej dashurisë buron bashkëpunimi, ndërlidhshmëria dhe lumturia. Ndërsa përkujtimi është për ata që kanë zemër, përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën. Ndoshta kjo çka është shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

Ndoshta kjo çka është shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

# **SINQERITETI**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

**13**



## HYRJE

Shumica e njerëzve bëjnë ibadet formalisht dhe sa për sy e faqe. Kështu shohim se ka prej njerëzve, të cilët shkojnë herë pas here në xhami, falen, por bëhet pyetja: “A e falin atë namaz vetëm për Allahun, apo e falin vetëm e vetëm që ta shohin njerëzit se është njeri i namazit?”.

Po ashtu shohim njerëzit që japin sadaka para njerëzve, lavdërohen, krenohen dhe dëshirojnë që për ato punë të ngriten lartë dhe të lavdërohen.

Po ashtu shohim njerëz, të cilët agjërojnë, mirëpo në të vërtetë prej agjërit të tyre nuk përfitojnë asgjë, përpos etjes dhe urisë. Kjo nga shkakun se atë agjërim e bëjnë për syfaqësi, e jo vetëm për Allahun.

Po ashtu ka prej njerëzve, të cilët shkojnë në haxh vetëm për t’u lavdëruar dhe vetëm për ta marrë titullin haxhi. Mirëpo robi i vërtetë dhe i singertë kur ta bëjë një punë e bën vetëm për Allahun. Ai singëritetin e ka në zemër, tërë trupi, tërë shpirti i tij është i mbushur me singëritet.

Një natë Muhamedi s.a.v.s. ishte duke kaluar nëpër rrugët e Medinës, së bashku me të ishte Burejdete, duke ecur e dëgjojnë një të qajtur nga brendia e xhamisë. Në xhami një njeri falej, lexonte Kur’an dhe qante. Mirëpo pse qante nuk dihej, ndoshta prej frikës së xhehenemit, apo dëshirës për të hyrë në xhenet.

Besimtari duhet të jetë i singertë në fenë e tij, në jetën e tij, haptazi dhe fshehurazi.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur’an i ka thënë Muhamedit s.a.v.s.:

***“Thuaj: Unë jam i urdhëruar ta adhuroj Allahun me një adhurim të singertë ndaj Tij”.***

*(Ez-Zumer, 11)*

Zoti i Lartmadhëruar ka urdhëruar që edhe ne besimtarët ta vazhdojnë rrugën e tij, që të jemi të sinqertë në adhurimet tona në fe.

***“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë.”***

*(El-Bejine, 5)*

## SINQERITETI

Sinqeriteti do të thotë pastërti, çiltërsi dhe kthjelltësi, e kjo do të thotë që muslimani fjalët dhe veprat e tij t'i ketë posaçërisht vetëm për Allahun dhe për të fituar kënaqësi ndaj Allahut, e jo për reputacion, e as për t'u proklamuar, ai nuk vepron që ta shohin njerëzit e ta lavdërojnë.

Po ashtu sinqeritet do të thotë pastërtia e zemrës nga çfarëdo njolle.

Disa dijetarë e kanë quajtur sinqeritetin kështu:

*“Që ti ta bësh veprën e të mos e dijë askush tjetër, pos Allahut”.*

Kjo cilësi vërtet është cilësi madhështore. Sinqeriteti në vepra e largon shejtanin dhe shejtani nuk mund të afrohet, dhe nuk mund të fusë dyshime në fjalë apo në veprime, sepse Zoti i Lartmadhëruar i ruan besimtarët e sinqertë nga shejtani: Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an na ka treguar se si ka thënë Iblisi:

***(Iblisi) Tha: “Zoti im, për shkak se më përzure (më largove), unë do t'ua zbukuroj (të këqijat) atyre sa të jenë në tokë (në këtë botë) dhe të gjithë ata do t'i largoj nga rruga e drejtë! Përveç robërve të Tu, të cilët i ke bërë të sinqertë.”***

*(El-Hixhr, 39-40)*

E kundërta e sinqeritetit është dyfaqësia apo hipokrizia.

Sinqeriteti është shkëndijë, të cilën Zoti i Lartmadhëruar e vendos në zemrat e robërve të zgjedhur të Tij, që t'i ndriçojë, t'i pastrojë, t'i lulëzojë, t'i gjallërojë dhe t'i forcojë zemrat e tyre.

Sinqeriteti është kandari në të cilën maten burrat dhe peshojë në të cilën vendosen veprat.

Me sinqeritet besimtari e përsos besimin e tij.

Sinqeriteti bën që besimtari të japë vetëm për Allahun, të dojë vetëm për Allahun, të urren vetëm për Allahun, të pengojë vetëm për Allahun dhe të gjitha këto vetëm e vetëm për ta fituar kënaqësinë e Allahut.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Kush do vetëm për Allahun, urren vetëm për Allahun, jep vetëm për Allahun dhe nuk jep vetëm për Allahun, ai veç e ka plotësuar imanin e tij.”*

Sinqeriteti është rruga, e cila e bën jetën të qetë, të lumtur dhe pa brenga. Sinqeriteti sjell furnizim me urdhrin e Allahut pa ndërprerë:

***“Kush vepron mirë, qoftë mashkull apo femër dhe është besimtar, Ne do ta bëjmë që ai të jetojë një jetë shumë të mirë, dhe ata do t’i shpërblejmë shumë më shumë dhe më mirë se çka kanë punuar”.***

*(En-Nahl, 97)*

Sinqeriteti është në kundërshtim me idhujtarinë; kush nuk është i sinqertë është idhujtar.

## SINQERITETI NË KUR'AN

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an i ka thënë Muhamedit s.a.v.s.:

***“Thuaj: Unë jam i urdhëruar ta adhuroj Allahun me një adhurim të singertë ndaj Tij”.***

*(Ez-Zumer, 11)*

Zoti i Lartmadhëruar ka urdhëruar që edhe ne besimtarët ta vazhdojnë rrugën e tij, që të jemi të singertë në adhurimet tona në fe.

E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të singertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë.

*(El-Bejine, 5)*

Besimtari duhet të pendohet, të përmirësohet të mbështetet tek Allahu dhe të ketë besim të singertë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Por ata që pendohen, përmirësohen, mbështeten fort tek Allahu dhe që besimin e tyre e kanë singërisht vetëm për Allahun, do të jenë me besimtarët e vërtetë, Allahu do t'u japë shpërblim të madh besimtarëve”.***

*(En-Nisa, 146)*

Të gjitha lutjet duhet t'i bëjmë lutje të singerta. Zoti i Lartmadhëruar në Kuran thotë:

***“Andaj, luteni Allahun me adhurim të singertë për Të, edhe nëse këtë e urrejnë pabesimtarët.”***

*(El-Gafir, 14)*

## SINQERITETI NË HADITHË

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Veprat shpërblehen sipas qëllimit. Çdo njeri shpërblehet për veprën e tij se për çka e ka vendosur ta bëjë atë vepër. Nëse hixhreti i ndonjërit është për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, atëherë edhe shpërblimi i atij hixhretit bëhet shpërblim për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Po nëse ndonjëri e ka bërë hixhretin që të përfitojë diçka në këtë botë apo për t’u martuar me ndonjë grua, atëherë edhe shpërblimi i atij hixhreti është për atë qëllim”.*

*(Mutefekun alejhi)*

Transmeton Mus’ab bin Saidi nga babai i tij dhe thotë:

“Babai im ka paragjykuar se është më i vlefshëm në krahasim me shokët tjerë të Muhamedit s.a.v.s. Mirëpo, Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Vërtet Allahu ndihmon këtë umet (popull) me më të dobët të mesit të tij, nëpërmjet namazit dhe lutjeve të tyre të singerta.”*

*(Transmeton Nesaiju)*

Thuëbani transmeton se ka dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

*“Lum për të singertit. Ata janë kandila të rrugës së drejtë, me të ndriçohet çdo errësi, për të kaluar rrugën pa pengesë.”*

*(Transmeton Bejhekiu)*

Sinqeriteti ndihmon për t’i arritur dëshirat dhe shpresat, sa do që të jenë të mëdha.

Transmeton Muadh bin Xhebeli se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Bëhu i singertë në fenë tënde, të mjafton edhe puna më e vogël”.*

*(Hakimi)*

Shpirti i çdo pune është sinqeriteti; çdo punë pa sinqeritet është i pavlefshëm dhe nuk sjell fryte fare, por zhduket, sikurse pluhurin kur e merr era.

*“Kush kalon prej kësaj bote në botën tjetër duke qenë i singertë me Allahun, duke mos i bërë idhujtari Atij, e fal namazin, e jep zekatin, - ai ka vdekur duke qenë Allahu i kënaqur me të.”*

*(Ibn Maxhe dhe Hakimi nga Enes bin Maliki)*

## SINQERITETI I PEJGAMBERËVE

Të gjithë pejgamberët kanë qenë të sinqertë, në krye të të sinqertëve është Pejgamberi ynë Muhamedi s.a.v.s., i cili edhe ka kërkuar që të gjitha veprat t'i kryejmë me sinqeritet.

Zoti i Lartmadhëruar në Kuran përmend sinqeritetin e Musa a.s. ku thotë:

***“Përkujto në libër (Kuran) edhe Musanë! Vërtet ai është i përzgjedhur, i sinqertë. Ishte i dërguar Pejgamber.”***

*(Merjem, 51)*

Pastaj Kurani ka përmendur sinqeritetin e Ibrahimit, Is’hakut dhe Jaëkubit, ku thotë:

***“Kujto robërit tanë: Ibrahimin, Is’hakun dhe Jaëkubin të fortë (në besim) dhe largpamës. Ne u dhuruam atyre një virtyt të veçantë që ta kenë gjithmonë në botën e ardhshme. Vërtet ata janë tek Ne, nga njerëzit më të mirë e më të zgjedhur.”***

*(Sad, 45-47)*

Lusim Allahun që edhe ne të bëhemi të sinqertë dhe të pasojmë rrugën e më të zgjedhurve!

## SUREJA E SINGHERITETIT – SURETUL IHLAS

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ (1) اللَّهُ الصَّمَدُ (2) لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ (3)  
وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ (4)

(El-Ihlas, 1-4)

Në këtë sure përfshihen cilësitë e Allahut.

1. **Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!**
2. **Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.**
3. **Ai as nuk lind, e nuk ka lind, e as nuk është i lindur.**
4. **Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë.**

Në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. një njeri e ka dëgjuar se si një njeri tjetër e ka lexuar suretul Ihlas (suren e Singheritetit) në mbrëmje një herë, pastaj prapë e ka përsëritur dhe i është dukur se ka lexuar pak. Të nesërmen në mëngjes këtë ia tregon Pejgamberit s.a.v.s., ndërsa Muhamedi s.a.v.s. i thotë:

*“Pasha Atë (Allahun) në dorën e të Cilit është shpirti im, kjo sure (suret Ihlas) është me vlerë sa një e treta e Kur’anit.”*

Është e vërtetë se kjo sure ka vlerë të posaçme, sepse në të është njëshmëria e Krijuesit, pra është sureja e imanit të singertë në Allahun.

## SI TA FITOJMË SINQERITETIN

Në një vendbanim jetonin dy njerëz: njëri quhej Muhsin, e tjetri Hamdan. Ata dallonin shumë njëri me tjetrin.

Muhsini punonte punë të mira në fshehtësi, punët e tij të mira nuk i shihte askush, përpos një numri të vogël të njerëzve. Edhe pse njerëzit përfitonin shumë të mira prej tij, ata nuk e dinin se ato të mira ishin si rezultat i Muhsinit.

Hamdani kur e bënte një punë të mirë e përhapte lajmin, tregohej e lavdërohej dhe dëshironte të lavdërohej.

Një ditë, gjatë namazit të xhumasë, imami e shpjegonte ligjëratën e sinqeritetit. Në mes tjerash ai tregonte se në Ditën e Kijametit shumë njerëz do të dalin para Allahut me të mira të shumta, por Allahu nuk do t’ua pranojë ato të mira, përkundrazi do t’i shpie në zjarr, sepse ata njerëz, ata të mira i kanë bërë për t’u lavdëruar dhe për t’u proklamuar para njerëzve.

Pas namazit Hamdani shkon te ligjëruesi dhe i thotë: “Cila është rruga për të arritur deri te sinqeriteti, që të m’i pranojë Allahu punët e mira?” Imami i thotë: “Nëse ke kohë, eja që të shkojmë në shtëpinë time që të bisedojmë për këtë çështje”. Muhsini, i cili ishte aty i thotë: “Po shtëpia ime është më afër, po shkojmë në shtëpinë time”. Pastaj shkuan në shtëpinë e Muhsinit.

Filloi biseda në mes Muhsinit dhe Hamdanit për çështjen e të fituarit të veçorisë së sinqeritetit dhe për faktorët, të cilët ndikojnë që njeriu të bëhet i sinqertë. Duke sqaruar imami, në mes tjerash, thotë:

“Për të qenë muslimani i sinqertë duhet pasur parasysh disa gjëra”. - Cilat janë ato? – pyeti Hamdani.

E para: Duhet ditur kuptimin e sinqeritetit, rëndësinë dhe domosdoshmërinë për jetë, dhe që ta dish se Allahu e ka bërë obligim adhurimin ndaj Tij, dhe çështjet tjera të jetës.

- Cili është përfitimi i sinqeritetit – pyeti Hamdani. Imami u përgjigj: “Sinqeriteti shpërblehet pa masë tek Allahu. A e di ti se sinqeriteti është shkaktar për të fituar shefaatin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Një ditë prej ditëve Ebu Hurejre e pyet të Dërguarin s.a.v.s.: “Cili është më fatlumi i cili do ta fitojë shefaatin tënd në Ditën e Kijametit?” Muhamedi s.a.v.s. i thotë:

*“O Ebu Hurejre e kam ditur se për këtë çështje nuk do të më pyes askush para teje, pasi që e kam vërejtur interesimin tënd për këtë çështje. Më fatlumi, i cili do ta fitojë shefaatin tim në Ditën e Kijametit do të jetë ai i cili thotë “La ilahe il-lallah” me zemër të singertë apo me shpirt të singertë”.*

*(Buhariu)*

Muhsini pyet: “Po tjetër, çka mund të na thuash për singeritetin?” Imami thotë: “Duhet, që muslimani ta dijë çka është dyfaqësia dhe pasojat prej saj dhe të largohet nga ajo cilësi e keqe. Atëherë Hamdani ndërhyr dhe thotë: “Dëshmoj në Allahun se sot e tutje kurrë nuk do të krenohem për asnjë punë timen, nuk do ta proklamoj, nuk do ta tregoj me qëllim që punët e mija të jenë vetëm për Allahun. Më në fund, të gjithë shkuan nëpër shtëpitë e tyre, dhe të gjithë u ndanë të lumtur, dhe secili shpresonte, që punët e tij të jenë të singerta vetëm për Allahun.

## SINQERITETI NË ZEKAT DHE SADAKA

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Një njeri tha: ‘Do të jap sadaka’. Doli dhe e dha sadakanë në dorë të një hajni. Të nesërmen të tjerët thoshin: “Dje ky njeri i ka dhënë sadaka hajnit”. Ai thoshte në vetvete: “O Zoti im! Vetëm Ty të takon falënderimi (sadakanë e kam dhënë vetëm për Allahun)! Unë prapë do të jap sadaka”. Del nga shtëpia dhe i jep sadaka një prostitute. Të nesërmen njerëzit thoshin se ky njeri i ka dhënë sadaka prostitutës! Ai thoshte në vetvete: “O Zoti im! Vetëm Ty të takon falënderimi (sadakanë e kam dhënë vetëm për Allahun)! Unë prapë do të jap sadaka”. Kështu që del nga shtëpia dhe i jep sadaka një të pasuri. Të nesërmen njerëzit thoshin se ai i ka dhënë sadaka një të pasuri! Ai thoshte në vetvete: “O Zoti im! Vetëm Ty të takon falënderimi (sadakanë e kam dhënë vetëm për Allahun), për atë që i kam dhënë sadaka: hajnit, prostitutës dhe të pasurit!” Atij pastaj i paraqitet (në ëndërr) një thënie se: “Sadakaja e jote e dhënë hajnit ndikoi, që ai të largohet nga vjedhja; sadakaja e jote e dhënë prostitutës ndikoi, që ajo të largohet nga prostitucioni; sadakaja e jote e dhënë të pasurit ndikoi, që ai të ketë në konsideratë, dhe të shpenzojë (t’u japë të tjerëve) prej asaj çka i ka dhënë Allahu”.

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

## SINQERITETI I ZEJNUL ABIDINIT

Një pjesë e banorëve të Medinës ishin të varfër, mirëpo kur të varfrit zgjoheshin nga gjumi në mëngjes para derës së tyre gjenin ushqim. Ata interesoheshin ta dinin se kush ishte ai, por nuk mundën ta gjenin përplot dhjetë vite. Pas dhjetë vjetësh njëri prej banorëve të Medinës, i quajtur Zejnul Abidin, vdes. Kur të nesërmen në mëngjes, asnjëri prej tyre nuk kishte ushqim pranë shtëpisë së tyre, atëherë e kuptuan se ai, i cili ua sillte ushqimin kishte qenë Zejnul Abidin. Për ta vërtetuar edhe më shumë këtë, ata kur e morën ta pastrojnë trupin e tij e panë se shpina iu kishte nxirë, sepse ai me shpinën e tij e kishte bartur ushqimin dhe e kishte dërguar para dyerve të të varfërve.

***“Kur të prezantojnë në pjesëtimin e pasurisë që ka lënë i vdekuri të afërm, bonjakë dhe varfanjakë (që nuk janë pjesëtarë në trashëgim), jepuani nga ajo (pasuri e lënë) dhe atyre thoni fjalë të mira. Le të frikësohen ata (në prag të vdekjes) sikur të linin pas vete pasardhës të paafte, për të cilët kanë dro (si do të jetë gjendja e tyre) le t'i ruhen Allahut (dënimt të Tij) dhe le t'ju thonë (jetimëve) fjalë prindërore.”***

*(En-Nisa, 8-9)*

## SUHEJBI( R.A.)

Suhejbi ishte një djalë i mirë, bujar dhe fisnik. Fytyra e tij shkëlqente, kishte flokë të kuqe dhe ishte shumë i shkathët. Një ditë ushtria bizantine shkon dhe e zë rob në shtëpinë e tij. Pasi që e zë rob, ai rritet si skllavopronar, por pasi që rritet ikë dhe shkon në Mekë. Në Mekë filloi të merrej me tregti. Duke u marrë me tregti pasurohet shumë. Një ditë, derisa kthehej nga tregtia, dëgjon se Muhamedi, i biri i Abdullahut është dërguar Pejgamber dhe ka filluar t'i thërras njerëzit në besimin e të vetmit Zot. Kështu prej të parëve, që e kanë pranuar Islamin është edhe Suhejbi. Për shkak të Islamit është maltretuar shumë. Pasi që muslimanët migrojnë në Medinë, edhe Suhejbi vendos të migrojë. Kur e merr rrugën e migrimit, i shkojnë pas mekasit dhe e arrijnë atë në periferi të Mekës. Ai përgatit shigjetën dhe u thotë:

“Asnjë nuk mund të më afrohet derisa të më harxhohen të gjitha shigjetat, e pastaj e kam shpatën dhe nuk do të dorëzohem derisa të më punoj dora.”

Njëri prej mekasve i thotë:

“Ti ke ardhur në Mekë pa pasuri, ndërsa sot je prej më të pasurve.” Atëherë Suhejbi i thotë: “Po sikur t’ju lë tërë pasurinë time, a do të ma lironit rrugën?” “Po”- i përgjigjen.

Suhejbi i tregoi atyre ku e kishte pasurinë dhe ata shkuan, e morën pasurinë e tij dhe e lironë.

Suhejbit nuk iu dhimb pasuria, por kishte mallëngjim, që sa më shpejtë të takohej me të Dërguarin e Allahut. Ecte me të shpejtë, lodhej e nuk pushonte derisa e pa të Dërguarin e Allahut. Kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i thotë Suhejbit:

*“O Ebu Jahja, triumfoi pasuria jote.”*

Atëherë filloi fytyra e Suhejbit të shkëlqejë dhe thotë: “Për Allahun ty nuk të ka treguar askush, pos Xhibrilit.”. Xhibrili e kishte zbritur ajetin kur’anor, shkak i të cilit ishte rasti i Suhejbit:

***“Ka njerëz që flijojnë veten për të fituar kënaqësinë e Allahut, Allahu është shumë mirënjohës ndaj robërve të Vet”.***

*(El-Bekare, 207)*

Sinqeriteti dhe sakrifica e Suhejbit duhet të jetë shembull për ne që të jemi të sinqertë në veprat tona dhe që ta fitojmë kënaqësinë e Allahut.

## NAMAZI I PAPRANUAR

أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالْإِيمَانِ (1) فَذَلِكَ الَّذِي يَدْعُ الْيَتِيمَ (2) وَلَا يَحْضُ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ (3)  
فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ (4) الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ (5) الَّذِينَ هُمْ يُرَاؤُونَ (6)  
وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ (7)

*“A e ke parë ti (a e sheh) atë, që përgënjeshtroi përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër?*

*Po ai është që e përzë në mënyrë të vrazhdë bonjakun.*

*Dhe që nuk nxit për ta ushqyer të varfrin.*

*Pra shkatërrim është për ata që falen,*

*Të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm.*

*Ata që vetëm shtiren (sa për sy e faqe).*

*Dhe nuk japin as sendin më të vogël (as hua)”.*

*(El-Maun, 1-7)*

I Dërguari i Allahut na ka tërhequr vërejtjen, që namazin mos ta falim vetëm për t’u proklamuar para njerëzve. Sepse namazi falet për të fituar kënaqësinë e Allahut, e jo për t’u krenuar para njerëzve apo për t’u lavdëruar para tyre.

Përderisa njëri falej në arë, disa djelmosha kalojnë pranë dhe thonë: “Sa mirë, ky njeri e ka lënë punën e arës dhe po falet”. Ndërsa, ai përderisa ishte në namaz u thotë:

*“Unë, përpos që falem, jam edhe duke agjëruar” !!!*

## SINQERITETI SJELL SHPËTIM

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Prej gjeneratave para jush, tre persona janë nisur për një udhëtim, deri sa i zë nata para një shpelle, në të cilën vendosen për ta kaluar natën. Nga kodra rrokulliset një shkëmb dhe e bllokon tërësisht hyrjen dhe daljen e shpellës. (Ata duke biseduar mes vete) thonë: Ne nuk mund të shpëtojmë gjallë nga kjo shpellë ndryshe, vetëm se duke i bërë lutje Allahut të Lartmadhëruar, në bazë të punëve tona të mira.

**Personi i parë** prej tyre lutet: O Zoti im! I kam pasur prindërit shume pleq dhe asnjëherë ujë nuk kam pirë para tyre, as nuk i kam dhënë familjes sime, po edhe punëtorëve të mi. Një ditë u vonova për shkak të kërimit të kullosës sa më të mirë, e kur u ktheva ata veç kishin fjetur. Pasi e mola bagëtinë, qumështin ua dërgova para tyre, por ata ishin fjetur. Unë nuk desha t’ua prish gjumin atyre, por edhe nuk e kam pirë qumështin para tyre, e as nuk i dhashë të pinë familjes dhe punëtorëve të mi. Qëndrova në këmbë zgjuar me qumështin në dorë duke i pritur deri sa të zgjoheshin. (Kështu prita) përderisa agoi dita, e fëmijët e mi qanin për qumësht para këmbëve të mia, e unë u dhashë të pinë qumësht, tek atëherë, pasi u zgjuan prindërit e mi dhe pinë para tyre. O Zoti im! Nëse këtë e kam bërë vetëm për të fituar kënaqësinë Tënde, na tejkaloi këtë fatkeqësi dhe lëvize këtë shkëmb (e të dalim në dritë)! Shkëmbi lëvizi, por jo edhe aq sa mund të dilnin jashtë.

**I dyti u lut:** O Zoti im, kam pasur një kushërirë të afërm, të cilën e kam dashur më shumë se tërë botën (në një transmetim tjetër: Kam qenë aq fortë i dashuruar në të, ashtu siç i donë së tepërmi burrat gratë), andaj kërkoja prej saj (siç kërkojnë meshkujt prej femrave), por ajo më refuzoi. Një vit prej viteve mbretëronte uri e madhe, e ajo u paraqit tek unë. E unë ia dhashë asaj 120 dinarë ari, me qëllim që të pranojë të vetmohej me mua. Pasi i mori të hollat dhe e kisha në disponim (që të veproj me të çka të dua), ajo më tha: “Frikësoju Allahut, e mos ma prish virgjërinë padrejtësisht!”. Atëherë u largova prej saj dhe nuk kontaktova me të, edhe pse e doja më shumë se çdokënd tjetër, kurse të hollat, të cilat ia pata dhënë, nuk ia morra. O Zoti im, nëse këtë e kam bërë vetëm për ta fituar Kënaqësinë tënde, na shpëtoi nga kjo vështirësi, në të cilën gjendemi”. Shkëmbi prapë lëvizi (nga hyrja e shpellës), por jo në tërësi për të dalë nga aty.

**Personi i tretë** u lut: o Zoti im, unë kam pasur punëtorë dhe të gjithëve ua kam dhënë pagën e fitimit menjëherë, përpos një punëtori, i cili ka shkuar pa e marrë pagën (e fundit). Pastaj pagën e tij e kam vendosur në qarkullim dhe pasuria e tij u shtua. Pas një kohë me erdhi e më tha : “O rob i Allahut, më jep pagën!” I thash: “Krejt çka sheh prej kësaj pasurie, si: këto dele, këto lopë, këto deve dhe ky rob, të gjithë janë shtuar prej pagës tënde”. Ai më tha: “O rob i Allahut, mos u tall me mua!” Unë i thash: “Nuk jam duke u tallur me ty”. Pastaj e mori tërë pasurinë e tij dhe nuk la asgjë prej tyre. O Zot im, këtë e kam bërë vetëm e vetëm për ta fituar kënaqësinë Tënde; na shpëto nga kjo fatkeqësi! Atëherë shkëmbi lëvizi i tëri, dhe që të tre dolën nga aty, e shpëtuan.

(Buhari Dhe Muslimi)

## FJALA E SINGERITETIT

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

Një ditë prej ditësh i Dërguari i Allahut ishte ulur me sahabët e tij. Ai u thotë atyre:

*“Ai, i cili thotë **La ilahe il-lallah**, i singertë në thënien e tij, do të hyjë në xhenet.”*

Sahabët e pyesin: “Po ç’është singeriteti i asaj thënie, o i Dërguar i Allahut?” Muhamedi s.a.v.s. përgjigjet: *“Që të largohet nga ajo që e ka ndaluar Allahu.”*

Për këtë arsye fjala **La ilahe il-lallah** kërkon që ajo të thuhet me singeritet të pastër, me zemër, duke mos i bërë ortak Allahut dhe ibadet të bëhet vetëm për Allahun, sepse Allahu i pranon veprat që bëhen me singeritet ndaj Tij.

Në një hadith Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Çdo herë kur rob (njeriu) thotë **La ilahe il-lallah** me singeritet, i hapen atij dyert e qiejve deri te Arshi i madh dhe nëse largohet prej mëkateve të mëdha.”*

## DY DINARËT

Një beni Israil dëgjon se një popull e adhuronte një pemë. Ky njeri hidhërohet dhe e merr sëpatën, që të shkojë dhe ta pres atë pemë. Në mes të rrugës, në formë të një njeriu të moshuar i paraqitet shejtani dhe e pyet:

- Ku po shkon?
- Që ta pres një pemë.
- Po pse po e pret?
- Sepse po e adhuron ky popull.

Në atë moment shejtani në formë njeriu ndeshet me të, mirëpo ngadhënjimtar del beni Israili. Mirëpo, shejtani përdor një metodologji tjetër, duke i thënë atij: “Nëse nuk e prenë atë pemë për çdo ditë do të t’i jap nga dy dinarë”.

Në ditën e parë dhe të dytë njeriut në shtëpi i vijnë nga dy dinarë, ndërsa në ditën e tretë jo. Atëherë bini Israili hidhërohet përsëri dhe e merr sëpatën, që të shkojë ta presë pemën në mes të rrugës, prapë i del shejtani në formë të njeriut, që ta pengojë. Ata ndeshen, mirëpo kësaj radhe shejtani del fitimtar. Njeriu i thotë: “Si është e mundur? Përse tash ti dole fitimtar?” Sepse herën e parë ke qenë i singertë dhe singëriteti ka qenë, që t’i je nisur ta presësh pemën vetëm për Allahun, ndërsa tani ti je nisur ta presësh pemën për shkak të dy dinarëve. E për këtë shkak fitova, e ti humbe”.

## IDHUJTARIA E FSHEHTË

Ebu Musa Esh'ariu, është njëri prej shokëve të ngushtë të Pejgamberit s.a.v.s., një ditë prej ditësh, përderisa mbante një fjalim para njerëzve, thotë: “O ju njerëz, ruajuni nga idhujtaria e fshehtë, se ky lloj idhujtarie është më e fshehtë se hapat e buburrecit”.

Dy njerëz nuk u pajtuan me këtë fjalim dhe i thonë se do të ankohe mi te emiri i besimtarëve – Omeri r.a., përderisa nuk na sjell argument. Atëherë Ebu Musa Esh'ariu thotë: “Një ditë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. na ka mbajtur një fjalim dhe ka thënë:

*“O ju njerëz, ruajuni nga idhujtaria e fshehtë, se ky lloj idhujtarie është më e fshehtë se hapat e buburrecit.”*

Shokët i thanë: “O i Dërguar i Allahut, po si të ruhemi nga ky lloj idhujtarie, përderisa është aq i fshehtë si hapat e buburrecit?” Pejgamberi s.a.v.s. thotë:

*“Bëjeni këtë lutje: O Zoti ynë, kërkojmë mbrojtje prej Teje nga çdo lloj idhujtarie, të cilën e dimë, dhe kërkojmë falje për ato që nuk i dimë”.*

## MUHAXHIRI I UMI KAJ SIT

Një banor i Mekës dëshironte të martohej me një vajzë fisnike të fisit kurejsh, e cila quhej Umi Kajs. Mirëpo, familja e saj nuk pranojnë. Pastaj Umi Kajs pranon Islamin. Kur muslimanët në vitin 622 bëjnë hixhretin prej Mekës në Medine, edhe ajo Umi Kajs në Medine. Pas saj në Medine hixhretin e bën edhe ai, duke lakmuar se atje do të ketë mundësi ta fejojë dhe të martohet me të. Për këtë arsye sahabët e quanin Muhaxhiri i Umi Kajsit. Sepse ai e ka bërë hixhretin për t'u martuar me të, e jo për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij.

Për këtë Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Veprat shpërblehen sipas qëllimit. Çdo njeri shpërblehet për veprën e tij se për çka e ka vendosur ta bëjë atë vepër. Nëse hixhreti i ndonjërit është për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, atëherë edhe shpërblimi i atij hixhretit bëhet shpërblim për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Po nëse ndonjëri e ka bërë hixhretin, që të përfitojë diçka në këtë botë apo për t'u martuar me ndonjë grua, atëherë edhe shpërblimi i atij hixhreti është për atë qëllim”.*

## SHKAKU I TË QAJTURIT

Një ditë prej ditësh Omer bin El-Hatabi r.a. hyri në xhami, kur befas e sheh Muadh bin Xhebelin r.a. duke qarë.

Omeri r.a. e pyet: - Përse po qan?

Muadhi i përgjigjet: - Kam dëgjuar një hadithë të të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. duke thënë:

*“Proklamimi i lehtë është idhujtari. Kush armiqësohet me dashamirët e Allahut, Allahu i shpallë luftë. Vërtet Allahu i do të devotshmit e padukur, të cilët edhe nëse nuk janë prezent janë prezent (me vepër), e nëse janë prezent nuk njihen. Zemrat e tyre janë drita shkëlqimi të udhëzimit.”*

Më të dashurit te Allahu janë të sinqertit.

## ÇLIRUESI I KËSHTJELLËS

Në kohën e hilafetit të Omer bin Hatabit r.a. muslimanët e kishin rrethuar një kështjellë të armikut. Udhëheqës ishte Sead Ibn Vekas r.a. Ushtria muslimane tentonte të depërtonte në brendi por kështjella ishte e fortifikuar me një mur të gjerë, të lartë dhe të gjatë. Kështu ata nuk mund të hynin. Tentuan në ditën e parë, por pa sukses; tentuan në ditën e dytë, pa sukses; tentuan edhe ditën e tretë, por pa sukses.

Në ditën e katërt para sabahut një ushtar kishte marrë abdest, i kishte falur dy rekate namaz, kishte depërtuar në brendësi, pasi kishte hapur një vrimë dhe i kishte thyer dyert e derës dhe i kishte hapur dyert e kështjellës thërret: “Ejani, ejani! Kur ushtria muslimane e dëgjoi zërin atëherë me shpejtësi u tubuan dhe depërtuan në kështjellë dhe e çliruan.

Pas përfundimit të betejës, Seadi thërret. Ku është çliruesi i kështjellës, asnjëri nuk lajmërohet. Atëherë Seadi thotë: Jam përbetuar në Allahun, se patjetër do ta takoj dhe dëshiroj që në mbrëmjet të vjen në tendën time.

Kur në mbrëmje një ushtar me fytyrë të mbuluar shkon te tenda e Seadit, kërkon leje dhe hyn në të. Seadi i thotë: - A ju jeni çlirues i kështjellës? I përgjigjet: - Po. – Atëherë zbuloje fytyrën tënde. Ai i thotë: - Unë e zbuloj fytyrën, por me tre kushte. – Urdhëro, cilat janë ato tre kushte?

Ushtari i thotë: - Që mos ta dijë askush tjetër, pos teje.

E dyta: - Që të mos më shpërblesh dhe të mos gradohem. Dhe që edhe ti mos të më pyesësh për emrin tim.

Seadi i pranoi kushtet, ndërsa ushtari e zbuloi fytyrën, e Seadi e njohu fytyrën e tij. Pastaj ushtari doli nga dera me punën e tij të singertë, të cilën e kishte bërë vetëm për Allahun.

## MONEDHA FALSE

Një plak shkon në treg për të blerë sende për nevojat e tij. Kur hyn në shitore ia jep monedhën. Shitësi e merr monedhën, e shikon plakun dhe i thotë: - O axhë, sa po shoh në fytyrën tënde e kuptoj se jeni shumë i ndershëm dhe fisnik. Prej nga e keni marrë këtë monedhë? Plaku u befasua dhe i tha shitësit: - Po çfarë ka lidhje fisnikëria ime me monedhën?!

Shitësi i thotë: - të lutem më trego se ku e ke marrë këtë monedhë.

Dje kam punuar në një vend dhe kjo është monedha që e kam fituar me djersën time.

Shitësi i thotë: - Po, a e dini se kjo monedhë është false?

Plaku i thotë: - Jo.

Pastaj plaku e pyet: - Pse, a me të vërtetë është monedhë false?

Shitësi i thotë: - Po.

Para se ta përfundojë fjalën plakut i bie të fikët dhe e humb vetëdijen.

Shitësi mundohet t'ia kthejë vetëdijen, aty tubohen njerëz. Njëri prej njerëzve i hedh ujë plakut e atij i vjen vetëdija. Atëherë shitësi brengoset dhe i thotë: - Merr çfarë të nevojitet. Njerëzit e pyesin: - Çka ishte puna me ty? Ai u thotë: - Kur më tha shitësi se monedha është false, menjëherë m'u kujtua sikur para meje është Allahu i Lartmadhëruar dhe Ai duke m'i kthyer veprat e mia duke më thënë: - Këto vepra tua janë false, veprat e tua nuk kanë pasur sinqeritet. Dhe nga ky kuptim më ka rënë të fikët.

Kështu ne duhet të mundohemi, që të veprojmë me sinqeritet dhe veprat tona mos të jenë të falsifikuara.

## **ÇKA PËRFUNDOJMË PREJ KËTIJ LIBRI**

- Të gjithë jemi të urdhëruar që veprat t'i kryejmë me sinqeritet.
- E kundërta e sinqeritetit është dyfityrësia.
- Shejtani nuk mund t'i përvetësojë asnjëherë të sinqertit.
- Sinqeriteti është shkak për të fituar shefaatin e Pejgamberit s.a.v.s.
- Veprat shpërblehen sipas qëllimit.
- Më të dashurit e Allahut janë më të sinqertit.
- Duhet të kemi kujdes dhe të ruhem nga idhujtaria e fshehtë.

## PËRFUNDIM

Të kujtojmë se veprat shpërblehen sipas qëllimit, e ne duhet t'i kryejmë veprat me sinqeritet, se sinqeriteti është shkak për të fituar shefaatin e Pejgamberit s.a.v.s. Ndërsa përkujtimi është për ata që kanë zemër, përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën.

Ndoshta kjo çka është shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.



# **DREJTËSIA**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

**14**



## DREJTËSIA

Drejtësia është cilësi madhështore. *I Drejtë* është emër prej emrave më të bukur të Allahut.

Drejtësia është cilësi, të cilën e do Zoti i Madhëruar.

Drejtësia është që secili të gëzojë atë që është e tij dhe atë që i takon atij, dhe të tjerëve t'ua lejojë atë të drejtë që u takon atyre.

Me drejtësi të gjithë njerëzit janë të forcuar mes veti sikurse dhëmbët.

E kundërta e drejtësisë është *padrejtësia*.

Nuk ka jetë më të lumtur se kur burri është i drejtë me bashkëshorten e tij, prindi i drejtë me fëmijët e tij, shteti i drejtë me qytetarët e tij.

Njeriu i drejtë e di se padrejtësia është errësirë prej errësirave të Ditës së Kijametit. Allahu nuk i do të padrejtët, Allahu i do të drejtët.

Drejtësia është cilësi e Zotit, Zoti është i drejtë, ia ka ndaluar Vetes të padrejtën dhe ka urdhëruar për drejtësi.

Islami na mëson se të drejtët do të jenë të shpëtuar në Ditën e Kijametit, do të jenë pranë Allahut, do të jenë fitimtarë, do të fitojnë kënaqësinë e Allahut dhe shpërblimi i atyre që veprojnë me drejtësi do të jetë Xheneti. Pejgamberi s.a.v.s ka thënë:

*“Të drejtët do të jenë në vende të ndriçuara nga ana e djathtë e të Gjithëmëshirshmit dhe do t'i kenë të ndriçuara duart e tyre, ata janë të cilët gjykojnë me drejtësi për atë që janë të autorizuar.”* (Ahmedi)

Njeriu i drejtë i shpëton dënimit të Allahut, sepse ai përhap drejtësinë në mes të njerëzve. Allahu e ndihmon dhe e përkrah të drejtin, sepse i drejti vepron atë që ka urdhëruar Allahu të veprohet.

Drejtësia duhet të jetë te të gjithë kategoritë e njerëzve, si te i pasuri ashtu edhe te i varfëri; si te i fuqishmi, ashtu edhe te i dobëti; si te qeveritari, ashtu edhe te i qeverisuri.

***“Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është (vepra) sa pesha e një kokrrë të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës.”***

*(Enbija, 47)*

## DREJTËSIA NË KUR'AN

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

*“All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.”*

*(En-Nahl, 90)*

*“All-llahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejt mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni.”*

*(En-Nisa, 58)*

*“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hirë të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfnjak, pse All-llahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrëmbëroni ose tërhiqeni, All-llahu hollësisht di ç'ka punoni.”*

*(En-Nisa, 135)*

*“E për këtë shkak (të përçarjes së tyre), ti thirr dhe përqëndrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tyre dhe thuaj: “Unë kam besuar në librat që i shpalli All-llahu, jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush, All-llahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj; Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona e ju të veprave tuaja, nuk ka polemikë mes nesh e jush; All-llahu bën tubimin mes nesh dhe vetëm te Ai është përfundimi!”*

*(Esh Shura, 15)*

## DREJTËSIA NË SUNET

Pejgamberi s.a.v.s ka qenë i drejtë dhe gjithnjë urdhëronte për drejtësi. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë se në Ditën e Kijametit, kur nuk ka hije tjetër, pos hijes së Allahut, do të jenë shtatë kategori njerëzish, të cilët do të hyjnë nën hijen e Tij. E kategoria e parë është *“Imami i drejtë”*.

Po ashtu Pejgamberi s.a.v.s ka thënë se të drejtit nuk i kthehet duaja prapë.

Tre personave nuk iu kthehet duaja prapë, e ata janë: *“Agjëruesi para se të fillojë iftarin, **imami i drejtë** dhe lutja e atij, të cilit **i është bërë e pa padrejtë.**” Allahu e ngrit atë dua lartë mbi re, ia hapë dyert e qiellit dhe thotë: “Pasha fuqinë dhe madhërinë Time, do të të ndihmoj edhe nëse vonon pak.”*

(Muslimi)

Drejtësia është në nivelin e ibadetit. Pejgamberi s.a.v.s ka thënë:

*“Ibadeti i një imami të drejtë është më e vlefshme se ibadeti i gjashtëdhjetë viteve. Më e vlefshme është që të praktikohet drejtësia dhe të ekzekutohet i padrejti në tokë se sa të bie shi dyzet ditë.”*

(Taberaniu)

## DREJTËSIA DHE BARAZIA NË MES FËMIJËVE

Sahabiju i mirënjohur, Beshir bin Sead, dëshironte t'i jepte njërit prej bijve të tij një dhuratë. Mirëpo gruaja e tij Umrete bin Revaha r.a. refuzon t'i japë dhuratë fëmijës, përderisa nuk shkon te Pejgamberi s.a.v.s.

Beshiri shkon te Pejgamberi s.a.v.s dhe i tregon se dëshiron t'i japë djalit të tij një dhuratë. Pejgamberi s.a.v.s i thotë: *“A ju ke dhënë fëmijëve të tjerë të njëjtën dhuratë?”*

Beshiri thotë: “Jo.”

Pejgamberi s.a.v.s thotë: *“Frikojuni Allahut, silluni drejtë dhe tregoni barazi mes fëmijëve.”*

Atëherë Beshiri kthehet, zbaton urdhrin e Pejgamberit s.a.v.s dhe bëhet i drejtë ndaj fëmijëve të tij.

## VJEDHJA E GRUAS NGA FAMILJA ME FAMË

Pejgamberi s.a.v.s është shembull për çdo cilësi të mirë, për çdo vepër fisnike, për çdo çështje. Ai ka qenë i drejtë, ka urdhëruar për drejtësi, ka gjykuar me drejtësi dhe ka thënë:

*“Para ligjit të Allahut të gjithë njerëzit janë të barabartë; nuk ka dallim në mes të dobëtisë dhe të fortisë, as në mes të pasurit dhe të varfërit e as në mes të qeveritarit dhe qytetarit.”*

Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ لِلَّهِ شُهَدَاءَ بِالْقِسْطِ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَا نُ قَوْمٍ عَلَىٰ أَلَّا تَعْدِلُوا اعْدِلُوا هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَىٰ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ

*“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kijeni dro All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni”.*

(El Maide, 8)

Po ashtu Zoti i Madhëruar thotë:

فَلِذَلِكَ فَادْعُ وَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَقُلْ آمَنْتُ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ مِنْ كِتَابٍ وَأُمِرْتُ لِأَعْدِلَ بَيْنَكُمْ اللَّهُ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ لَنَا أَعْمَالُنَا وَلَكُمْ أَعْمَالُكُمْ لَا حُجَّةَ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ اللَّهُ يَجْمَعُ بَيْنَنَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ

*“E për këtë shkak (të përçarjes së tyre) ti thirr dhe përqendrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tua e thuaj: Unë kam besuar në librat që i shpalli All-llahu, jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush, All-llahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj; ne kemi përgjegjësinë e veprave tona e ju të veprave tuaja, nuk ka polemikë mes nesh e jush; All-llahu bën tubimin mes nesh dhe vetëm tek Ai është përfundimi!”*

(Esh Shura, 15)

Ja çfarë ka ndodhur në kohën e Pejgamberit s.a.v.s.

Në shtetin islam e drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u gjykuar janë të garantuara dhe të pacenueshme. Çdo qytetar ka të drejtë për t'u ankuar te gjykatësi suprem (i autorizuar). Dhe secili ka të drejtë mbrojtjeje dhe secila palë duhet të sjellë fakte për atë që pretendon.

Sipas ligjit të Sheriatit nuk lejohet mbrojtja me tradhti, me falsifikime dhe rrena, sepse kjo konsiderohet krim, shpifje dhe prej mëkateve më të mëdha të All-llahu i Lartmadhëruar.

Shkaku i zbritjes së një ajeti kur'anor është ky: Njëri prej muslimanëve kishte vjedhur një mburojë dhe e kishte fshehur në shtëpinë e një jehudiu pa e ditur ai. Kur është zbuluar mburoja të jehudiu, vjedhësi e kishte akuzuar atë për vjedhje. Ai (jehudi) është përbetuar se nuk e ka vjedhur. Populli i tij (vjedhësit) kanë shkuar te Muhammedi a.s. për ta shpallur atë të pafajshëm, ndërsa jehudin për ta dënuar. Atëherë zbret ajeti kur'anor për të zbuluar se çfarë fshehin në zemrat e tyre, për t'ia kthyer sendin e vjedhur pronarit, për ta hequr padrejtësinë prej jehudiut dhe për të treguar domosdoshmërinë e vërtetimit të gjyimit dhe të argumenteve. Dhe bën thirrje për të mos polemizuar pa nevojë, po ashtu e ngriti vlerën e së vërtetës dhe drejtësisë, dhe për t'i bindur njerëzit se All-llahu sheh dhe kontrollon çdo veprim që bëhet fshehtazi apo haptazi, se All-llahu gjykon akuzimin e të pafajshmëve dhe mbrojtjen e kriminelëve dhe atë me metodologji të mrekullueshme të Zotit të Lartmadhëruar.

## URTËSIA DHE DREJTËSIA

Muslimanët kishin fituar luftën kundër pabesimtarëve, pas mbarimit të luftës pasuria kishte mbetur dhe nevojitej t'iu ndahej luftëtarëve.

Muhamedi s.a.v.s është ulur në mesin e shokëve të tij dhe ndante pasurinë në pjesë të barabarta dhe me drejtësi.

Një beduin i mllëfosur me fortësi i shkon Pejgamberit s.a.v.s dhe i thotë:

*“O pejgamber i Allahut ,vepro drejtë.”*

Si gjithnjë, edhe kësaj radhe Pejgamberi s.a.v.s tregoi urtësi, butësi dhe heshti e nuk e vazhdoi bisedën. Beduini i thotë për të dytën herë:

*“O Pejgamber i Allahut vepro drejtë.”*

Atëherë Pejgamberi s.a.v.s e shikoi dhe i tha:

*“Mjerë për ty, po nëse unë nuk jam i drejtë, atëherë kush tjetër do të ishte i drejtë?!”*

Disa prej shokëve u ngritën në këmbë dhe deshën që beduinin ta rrahin, mirëpo Pejgamberi s.a.v.s. nuk i lejoi por e kaloi situatën me urtësi dhe butësi.

## DREJTËSIA E EBU BEKRI SIDIKIT

Mashkulli i parë, i cili e ka pranuar Islamin është Ebu Bekri. Ai ka qenë shoqëruesi vazhdueshëm i Muhamedit a.s. I pari i cili e ka falur namazin me xhemat me Muhamedin a.s.

Kur Muhamedi a.s. ishte i sëmurë, sahabët me padurim e pritnin në xhami për faljen e namazit të sabahut. Mirëpo, përderisa nuk paraqitej në xhami behet gati që Imam të behet Ebu Bekri, por kur hyri Muhamedi a.s. Ebu Bekri zbret prej minberi, por Muhamedi a.s e sinjalizoi që të vazhdojë dhe të behej Imam i xhematit.

Pasi që Muhamedi a.s. ngritet te i Dashuri i Tij, te Allahu xh.sh., Ebu Bekri bëhet halifeja i parë i myslimanëve.

Kure filloi detyrën dhe e jep betimin, në mes tjerash tha:

*”O ju njerëz, ta dini se vërtetësia është emanet, ndërsa gënjeshtria tradhti. I dobëti nga ju është i fortë, deri sa ta fitojë të drejtën e tij. I forti i juaj është i dobët, derisa t’i merret e drejta prej tij.”*

## DREJTËSIA E OMERIT

Në kohën e halifes së dytë të muslimanëve, Omer bin Hatabit, në Egjipt guvernator ka qenë Amër bin Asi. Në këtë kohë mbaheshin garat në vrapim. Në garë merr pjesë edhe djali i guvernatorit. Vrapimi filloi dhe secili dëshironte të fitonte garën. Ndërsa, para arritjes në cak, ndër të parët ishte djali i Amër bin Asit, mirëpo një Egjiptas ishte më i shpejt dhe e zë vendin e parë, ndërsa djali i Amërit e humbi garën. Pas përfundimit të garës, kur Egjiptasi e merr shpërblimin, djali i Amër bin Asit e merr një kamxhik dhe i bie Egjiptasit dhe i thotë: *“Si guxove të ma kalosh, përderisa unë kam marrë pjesë në garë dhe jam djalë i fisnikëve.”*

Publiku e vërejti këtë veprim dhe i thonë Egjiptasit që të ankohet te guvernatori, mirëpo ai nuk tentoi që të paraqesë ankesë, pasi që dyshonte se babai do t’ia mbante anën të birit. Disa të tjerë i thonë që të ankohet te halifeja i drejtë i muslimanëve, Omer bin Hatabi, i cili nuk ja shkel të drejtën askujt dhe u ndihmon të dobëtëve ndaj të fortëve.

Egjiptasi shkon në Medine dhe me lehtësi arrin te halifja dhe i thotë: *“O Emir i besimtarëve, unë jam Egjiptas dhe kam fituar në vrapim, mirëpo prej dëshpërimit se nuk ka fituar djali i Amërit më ka rënë me kamxhik duke më thënë se si guxove të ma kalosh, kurse unë jam djali i fisnikëve.”*

Omeri r.a. dërgoi një letër te Amër bin Asi, në të cilën shkruante:

*“Në emër të Allahut, Bëmirësit të përgjithshëm Mëshiruesit.” Nga robi i Zotit, emirit të besimtarëve, deri të Amër bin Asit. “Kur të arrijë kjo letër deri tek ju, eja ti së bashku me djalin.”*

Kur Amëri e pranoi letrën shkon në Medine dhe i thotë Omerit se për çfarë është fjala. Omeri e kuptoi se babai nuk dinte asgjë dhe e kuptoi se ankesa e Egjiptasit ishte e drejtë, pasi e vërtetoi me dëshmitarët. Ia jep kamxhikun Egjiptasit dhe i thotë: *“Bjeri djalit të fisnikëve”*. Egjiptasi i bie dhe e merr të drejtën e tij.

Omeri është shëmbëlltyrë se si qeveritarët duhet t’u ndihmojnë të dobëtëve kur atyre u bëhet padrejtësi.

## SHTËPIA E ABASIT(R.A)

Abas bin Abdul Mutalibi r.a. e kishte shtëpinë të ngjitur me xhaminë e Pejgamberit s.a.v.s. Omeri r.a. dëshironte t'ia merrte dhe ta zgjeronte xhaminë. Për këtë arsye kërkoi nga ai, ose t'ia blejë, ose t'ia dhurojë, me qëllim që ta zgjerojë xhaminë. Mirëpo, Abasi i refuzoi të gjitha ofertat. Atëherë Omeri i thotë: *“Je i detyruar ose ta shesësh, ose ta japësh dhuratë.”* Mirëpo Abasi vazhdimisht refuzonte. Kështu ata shkuan te Ubeje bin Keabi r.a. Ubeje bin Keabi i thotë Omerit:

*“Nuk shoh se ke të drejtë që ta dëbosh nga shtëpia pa pëlqimin e tij.”*

Omeri kërkoi arsyen pse nuk kishte të drejtë të bënte një gjë të tillë.

Ubeje bin Keabi i thotë: *“Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s duke thënë:*

*“Kur e ndërtoi Mesxhidi Aksanë Sulejmani a.s. ka vendosur ligj se kush ndërton një mur rreth xhamisë do t'i rrëzohet. Mirëpo Zoti i Lartmadhëruar e inspiroi që mos të ndërtojë në pronë të tjetrit, deri sa ai ka të drejtë, pa pëlqimin e tij.”*

Kur e dëgjoi Omeri këtë thënie, hoqi dorë dhe e la në të drejtën e tij, Abasin dhe shtëpinë e tij. Pastaj Abasi atë pronë e dha sadaka për dobi të muslimanëve dhe u zgjerua xhamia e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

## SI TA FITOJMË DREJTËSINË

Seadi ishte një njeri i pasur, ai kishte një parcelë toke dhe katër fëmijë - dy djem dhe dy vajza. Ai dëshironte që tokën ta trashëgonin vetëm djemtë, ndërsa vajzat të mos merrnin asgjë, sepse ai mendonte se nëse tokën e trashëgojnë gratë, atëherë atë tokë do ta merrnin të huajt (dhëndurët). Për këtë arsye ai dëshironte të shkruante një akt shit-blerjeje me djemtë. Djali i madh e pranon këtë, mirëpo djali i vogël i cili ishte i devotshëm i thotë vëllait të tij të madh: *“Atë çfarë po dëshiron të veproj është haram, sepse të gjithë fëmijët patjetër duhet të trashëgojnë ashtu siç e ka paraparë Allahu: një hise mashkullit sa dy të femrave.”*

Mirëpo, vëllai i madh i hidhëruar i thotë: *“Ti po dëshiron që tokën tonë ta pronësojnë të huajt.”* Vëllai i vogël e kuptoi se biseda me të është e kotë, e po ashtu nëse flet me babanë edhe ai nuk do ta dëgjojë. Mendoi se si të veprojë dhe si ta bëjë që babai i tij të veprojë me drejtësi ndaj fëmijëve. Ai shkon te imami i xhamisë dhe ia tregon rastin. Imami i xhamisë i tha djalit se së shpejti do të bisedojë për atë çështje.

Fëmija u kthye i lumtur në shtëpi. Pas disa ditësh imami shkoi në shtëpinë e tij për t’u takuar me prindin e tij. Imami dhe prindi bisedonin për shume çështje. Pastaj imami e pyet:

*“Çka mendon për Omer bin Hatabin?”* Seadi i thotë: *“Ka qenë njeri madhështorë.”* – *“Po cila ka qenë cilësia më e njohur e tij?”* Seadi i përgjigjet: *“Ai ka qenë udhëheqës i drejtë.”* Imami e shfrytëzoi rastin dhe filloi të flet për drejtësi. Pastaj thotë: *“Muslimani gjithmonë gjatë jetës së tij duhet të angazhohet për drejtësi, ashtu që t’i afrohet Allahut.”* Pastaj djali i vogël ndërhyr: *“Po në ç’mënyrë të bëhet i drejtë muslimani gjatë jetës së tij?”* – *“Ka shumë çështje, por drejtësia është që secilit t’i jepet ajo që i takon. Pra, duhet të jetë i drejtë në shit-blerje, në kandar, në matje etj.”* Imami pastaj tregoi një ngjarje, e cila ka ndodhur në kohën e Pejgamberit s.a.v.s duke thënë:

*“Ka qenë një sahabi i quajtur Beshir bin Seadi el Ensarij, ai dëshironte që njërit prej fëmijëve të tij t’i jepte dhuratë, mirëpo gruaja e tij, Umrete bin Revahate, refuzonte duke i thënë se nuk duhet t’i japësh asgjë, derisa të mos shkosh te Pejgamberi s.a.v.s dhe t’ia tregosh rastin.*

Beshiri shkon te Pejgamberi s.a.v.s dhe i tregon, ndërsa Pejgamberi s.a.v.s i thotë: ***“A ju ke dhënë të gjithë fëmijëve të tjerë njësoj?”*** Beshiri i thotë: “Jo.” Atëherë Pejgamberi s.a.v.s i thotë: ***“Frikojuni Allahut dhe bëhuni të drejtë ndaj fëmijëve tuaj.”*** Atëherë Beshiri u kthye dhe e realizoi urdhrin e Pejgamberit s.a.v.s dhe veproi drejtë me fëmijët e tij.”

*(Buhariu)*

Pasi imami shkon në shtëpinë e tij, Seadi i thërret fëmijët e tij dhe u thotë: *“O bijtë e mi, sot kam mësuar një mësim të rëndësishëm për drejtësinë. Nëse unë vdes le të trashëgojnë edhe bijat e mia, sepse edhe ata kanë të drejtën e trashëgimisë nga pasuria ime, ato janë pjesë e zemrës sime.”* Të gjithë fëmijët u gëzuan dhe u lutën që prindi i tyre të jetojë gjatë dhe të ketë jetë të lumtur.

## PËR NJË TË RËNË KOMPENSIMI ME HAXH

Një ditë prej ditësh Omeri r.a. e bën një vizitë rrugëve të Medinës. Në mes të rrugës e sheh Selmete bin el Ekvein r.a. Omeri pa hezitim me një të rënë të lehtë i bie rrobave të tij dhe i thotë: *“Largohu nga mesi i rrugës dhe vazhdo rrugën në skaj të saj.”*

Vitin tjetër, në të njëjtin vend e sheh Selmeten e i thotë: *“O Selmete! A dëshiron të shkosh në haxh?”*

Selmete i thotë: *“Po, o Emir i besimtarëve.”*

Omeri r.a. e merr për dore, e shpie në shtëpinë e tij, ia jep 600 dërhem dhe i thotë: *“Me këto të holla kryeje haxhin, dhe ta dish se kjo është kompensim për dëmin që ta kam bërë vitin e kaluar.”*

Selmete i thotë: *“O Emir i besimtarëve, po mua nuk më kujtohet se më ke bërë ndonjë dëm mua!”*

Omeri r.a. i thotë: *“Por, unë nuk e kam harruar atë se çfarë ka ndodhur vitin e kaluar.”*

## THERA E PESHKUT

Në një mëngjes, një peshkatar del të kërkojë furnizimin e tij hallall. E hedh shportën (rrjetën) dhe nuk zë asgjë. Ai filloi t'i lutet Allahut, se fëmijët e tij klithnin të uritur në shtëpinë e tij. Pak para se të perëndon dielli, Zoti ia mundëson atij që të zë një peshk të madh. E falënderon Allahun dhe i gëzuar e merr ta dërgojë në shtëpi. Rastësisht atë pasdite mbreti kishte dalë në shëtitje dhe e sheh atë se çka kishte zënë. I pëlqeu peshku i zënë dhe me të fortë ia merr, e pastaj shkon në kështjellën e tij. Ai dëshironte që ta gëzonte mbretëreshën, dhe ia tregon peshkun duke sjellë në të djathtë dhe në të majtë në dorën e tij, me ç'rast i hyn një therë dhe ia lëndon gishtin e tij. Nuk mundi të flinte i qetë atë natë, prandaj i ftoi mjekët. Ata i thanë se duhet të bëhet amputimi i gishtit. Edhe pas amputimit të gishtit, ai nuk mund të flinte i qetë, sepse helmi i kishte kaluar në dorën e tij. I ftoi mjekët dhe ata ia amputojnë edhe dorën. Mirëpo edhe pas kësaj nuk mund të flinte i qetë, por ndiente dhimbje edhe më të madhe, e klithte pandërprerë. Dhe prapë kërkon mjekim. I thonë së duhet të amputohet dora deri në bërryl. Pasi që u shërua nga dhembja trupore nuk ishte i qetë shpirtërisht dhe i dhembte zemra. Atëherë filloi ta kuptojë seriozitetin dhe shkakun e sëmundjes. E drejtuan të shkojë te mjeku i zemrës. Shkon dhe ia tregon atij rastin me peshkun. Mjeku i zemrës i thotë: "Nuk do të jesh i qetë, përderisa nuk ta falë peshkatari". Mbreti filloi të pyes se ku është peshkatari, deri sa e takon atë. Filloi t'i ankohej dhe kërkon falje prej tij dhe peshkatari ia fali, e ai u shërua. Mbreti tha: "A ke mundësi të më tregosh çfarë lutje (ankese) ke bërë kundër meje?" Peshkatari i thotë: "Nuk kam thënë asgjë, pos një fjalie, e ajo ka qenë: 'O Zoti im! Ai e tregoi forcën e tij ndaj meje. Të lutem tregoja edhe Ti forcën Tënde, e le ta shohë'".

## **ÇKA PËRFITJMË NGA KY LIBËR**

Nga ky libër përfitojmë se:

- Drejtësia është cilësi, të cilën e do Zoti i Lartmadhëruar.
- E kundërta e drejtësi është padrejtësia.
- Të drejtit janë të shpëtuar.
- Drejtësia është në nivelin e ibadetit.
- Para ligjit të Allahut të gjithë njerëzit janë të barabartë.
- Për padrejtësi njeriu ndëshkohet.

## PËRFUNDIM

Të përkujtojmë ajetin: *“Vërtet Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmeve, e ndalon imoralitetin, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim”*.

Ndërsa, përkujtimi është për ata që kanë zemër, përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën. Ndoshta kjo çka është shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

Ndoshta kjo çka është shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

# **EMANETI**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

**15**



## EMANETI

Emaneti është cilësi madhështore e njeriut. Emanet do të thotë vënia e çdo sendi në vendin e duhur, në vendin meritot dhe adekuat.

Emaneti është ndërgjegjja për të kuptuar dhe vepruar me Kur'an dhe Sunet. Nëse vdes ndërgjegjja hiqet emaneti dhe atëherë njeriut nuk i bën dobi leximi i Kur'anit dhe mësimi i Sunetit. Besa nuk rri në një zemër, e cila injoron të vërtetën.

Prej kuptimeve të besueshmërisë është: Që të shikosh me shqisat e shikimit, me të cilat të ka begatuar Allahu; që të vësh në funksion aftësitë, të cilat t'i ka dhënë Allahu; që të kesh kujdes në pasurinë dhe fëmijët, të cilët t'i ka dhuruar Allahu, - dhe ta dish se të gjitha këto janë gjëra të shenjta, të cilat t'i ka lënë emanet (ne besë) Allahu. Për këtë arsye, të gjitha këto të mira duhet t'i vendosësh në disponim për të mirën e të tjerëve, për të fituar kënaqësinë e Allahut. Zoti i Lartmadhëruar ne Kur'an thotë:

***“O ju që besuat, mos e tradhtoni All-llahun dhe të Dërguarin, e ashtu të tradhtoni amanetet tuaja, derisa e dini sa e keqe është kjo.”***

***“Dhe, dini se pasuria e juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një provë, dhe se te All-llahu është shpërblimi i madh.”***

*(El Enfal, 27-28)*

Një medinas, me emrin Thealebe, shkon të ensarët dhe kërkon prej tyre që të jenë dëshmitarë se nëse Allahu i jep të mira do t'i japë të mira çdo njeriu që meriton, do të japë lëmoshë dhe do ta ndihmojë farefisin. Kur vdiq një djalë i axhës së tij ky trashëgon nga ai pasuri, por nuk plotësoi asgjë nga ajo çka premtoi, që do të thotë se e ka thyer besën e dhënë. Për këtë arsye kanë zbritur ajete kur'anore, si vijon:

***“E prej tyre (hipokritëve) pati sish që i patën dhënë besën All-llahut që: “Nëse na jep (All-llahu) nga mirësia e Tij, ne do të ndajmë lëmoshë dhe do të bëhemi prej punëmirëve.”***

***“Kur ju dha (All-llahu) nga të mirat e Veta, ata bënë koprraci me atë (që u dha), e thyen besën dhe u zbrapsën nga respekti ndaj All-llahut.”***

***“Dhe për shkak se e thyen besën që i patën dhënë All-llahut, dhe për shkak të asaj se gënjenin, All-llahu u ngjeshi hipokrizinë në zemrat e tyre deri në ditën që e takojnë Atë.”***

***“A nuk e ditën ata se All-llahu e di fshehtësinë e tyre (në zemra), bisedën e tyre, dhe se Ai (All-llahu) i di të gjitha të fshehtat.”***

*(Et Tevbe, 75-78)*

Ebu Hurerje transmeton një hadith të Pejgamberit s.a.v.s. për tre persona, ku dy prej tyre e kanë thyer besën, ndërsa i treti jo.

Të shohim se si ka ndodhur me tre persona të një vendi, ku njëri e kishte zgjebën, i dyti ishte pa flokë (qel) dhe i treti i verbër.

Që të tre kishin të meta, që të tre ishin të vetmuar, njerëzit largoheshin prej tyre për shkak të sëmundjeve neveritëse të tyre dhe për shkak të papastërtisë së tyre.

Allahu dërgoi një melaqe te ata për t'i sprovuar, duke u dhënë atyre pasuri dhe duke ua larguar sëmundjet.

Melaqja shkoi te njeriu i parë:

- *Çka dëshiron, i tha?*
- Nuk dua asgjë, pos të më shërojë Zoti nga kjo sëmundje dhe të kem pasuri sa për ekzistencë.

Melaqja e preki dhe ai u shërua nga zgjebja, pastaj i tha se Allahu të jep këto dy dele dhe ti prej tyre do të pasurohesh.

Pastaj melaqja shkoi te njeriu i dytë dhe i tha:

- *Çka dëshiron?*
- Njeriu pa flokë qeli i tha: - Nuk dua asgjë tjetër, pos të më shërojë Zoti nga kjo sëmundje dhe të kem pasuri sa për ekzistencë.
- Melaqja e preki dhe ai u shërua nga sëmundja, pastaj i tha se Allahu të jep këto dy dele dhe ti prej tyre do të pasurohesh.

Në fund melaqja shkoi te njeriu i tretë dhe i tha:

- *Çka dëshiron?*
- I verbëri tha: - Nuk dua asgjë tjetër, pos të më kthejë shikimin Zoti dhe të kem pasuri sa për ekzistencë.
- Melaqja e preki dhe i erdhi shikimi, pastaj i tha se Allahu të jep këto dy dele dhe ti prej tyre do të pasurohesh.

Kaluan shumë vite ata u forcuan dhe u pasuruan pasi që Allahu i Madhëruar i kishte frymëzuar delet të shumohen. Pas atyre viteve të shumta Allahu e dërgoi melaqen dhe e urdhëroi të shndërrohet në formën e një njeriu të varfër, me rroba të vjetra, që t'i sprovtojë ata se a janë bamirës, a e falënderojnë Zotin dhe a u ndihmojnë nevojtarëve.

Në atë formë, si i varfër, melaqja kërkoi ndihmë prej njeriut të parë, i cili kishte pasur zgjebën e i tha: *“Jam udhëtar kam nevojë për ndihmë, më jep diç prej asaj që të ka dhënë Allahu!”*

Ai e refuzoi dhe filloi t'i bërtasë duke e qortuar. Në atë moment befasisht melaqja prej formës së njeriut të varfër u shndërrua në formën e melaqes së vërtetë dhe i tha: *"Pasi ti nuk i njeh të mirat e Allahut dhe njerëzit nuk kanë dobi prej teje kthehu zgjebkan siç ishe më parë."* Dhe menjëherë u kthye në sëmundjen e mëparme.

Melaqja vazhdoi dhe shkoi te njeriu i dytë si i varfër dhe kërkoi ndihmë prej tij. Ai u tregua më koprrac. Filloi t'i bërtas, ta ofendojë dhe ta largojë me forcë. Melaqja me shpejtësi u shndërrua në formën tij të vërtetë dhe i tha: *"Kthehu në sëmundjen e mëparme pa flokë (qel)"*, - dhe me urdhrin e Allahut u sëmur. Ai filloi të qajë dhe u pendua, por pendimi i tij nuk pati efekt.

Vazhdoi melaqja për ta provuar njeriun e tretë. Kur shkoi te ai, kërkoi ndihmë, u paraqit si i varfër, i gJORë, me rroba të vjetra dhe i tha: *"A keni diçka të më ushqeni se jam i uritur."*

Ai me zemërgjerësi i tha: *"O vëlla, ti je i varfër dhe nevojtar. Por, tërë kjo pasuri është begati prej Allahut, prandaj, merr sa të duash dhe sa të kesh nevojë, vetëm se për këtë falënderojë Alahun, e jo mua"*. Melaqja prej të varfërit u shndërrua në formën e vërtetë, e tha:

*"Ti je bamirës, falënderues dhe i dobishëm për shoqërinë, për këtë arsye Allahu do ta shtojë pasurinë dhe do të të japë shëndet të fortë përgjithmonë."*

Ka shumë ajete, të cilat tregojnë mbajtjen e besës dhe realizimin e premtimit.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***"Meqë keni premtuar, pra zbatojeni premtimin e dhënë ndaj Allahut, e mos i prishni betimet pasi i keni vërtetuar ato, duke qenë se All-lahun e bëtë garant tuajin. Vërtet, All-llahu e di se çka punoni."***

***"Mos u bëni (në çështjet e betimit) si ajo (grua) që e prish tjerin e saj pasi ta ketë dredhur fort, e t'i bëni betimet tuaja dredhi (mashttrim) mes jush, për shkak se një popull është më i madh se tjetri. All-llahu vetëm ju sprovon me këtë, e në ditën e gjykimit Ai gjithsesi do t'ua sqarojë atë gjë rreth të cilës kundërshtoheshit."***

(El Nahl, 91-92)

Emaneti më i madh i njeriut është feja Islame. Gjithashtu namazi është emanet, zekati është emanet, agjërimi është emanet, haxhi është emanet, pjesët e trupit i kemi emanet, begatitë që na ka dhënë Allahu i kemi emanet, dituria është emanet, drejtësia në mes të njerëzve është

emanet, gjuha e muslimanit është emanet, - kështu që ai i ruan këto emanete dhe nuk i keqpërdor për gënjeshtër, ofendime, shpifje e përgojime. Po ashtu edhe syri është emanet dhe nuk shikojmë me sy harame, por vetëm atë çka është hallall. Veshi është emanet dhe nuk dëgjojmë çështje të ndaluara. Besimtari duhet të jetë besnik në pasurin e tij dhe të tjerëve.

Nuk ka çështje më madhështore se sa kur muslimani e kryen emanetin ndaj Zotit të tij, ndaj njerëzve dhe ndaj vetes së tij.

Islami urdhëron për emanet dhe ndalon tradhtinë.

Enesi r.a. transmeton se ka thënë: Kur na ka ligjëruar Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: *“Nuk ka besim ai, i cili nuk ka besë; dhe nuk ka fe ai, i cili nuk e mban premtimin.”*

*(Transmeton Ahmedi)*

## EMANETI NË KUR'AN

Fjala emanet është përmendur shpesh në Kur'an. Emaneti është feja jonë, emanet, të cilin janë frikësuar ta marrin përsipër edhe kodrat edhe toka edhe qielli. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Ne ua ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri padrejt vetes, dhe ishte i padijshëm.”***

*(El-Ahzab, 72)*

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

***“Edhe ata që janë besnikë ndaj amanetit që u është besuar dhe ndaj premtimit të dhënë.”***

***“Edhe ata që dëshminë e vet e zbatojnë (nuk e mohojnë, nuk e fshehin).”***

***“Edhe ata që janë të kujdesshëm ndaj rregullave të namazit të tyre.”***

***“Të tillët janë në xhennete dhe janë të nderuar.”***

*(El-Mearixh 32-35)*

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an ka kërkuar që secili t'ia dorëzojë amanetin pronarit të vet:

***“All-llahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si vepronit.”***

*(El-Nisa, 58)*

## EMANETI NË SUNET

Nuk ka besim ai i cili nuk ka emanet (besim) dhe nuk ka fe ai i cili nuk e zbaton premtimin.

(Ahmedi)

Pejgamberi s.a.v.s. po ashtu ka thënë:

*“Kryeja emanetin atij, i cili ta ka besuar, e mos e tradhto atë që të ka tradhtuar.”*

(Ebu Davudi)

Po ashtu Pejgamberi s.a.v.s. në hadith ka thënë se shpërblimi i mbajtjes së emanetit është xheneti.

Transmeton Ebu Dardai se Pejgamberi s.a.v.s ka thënë:

“Kush i vepron pesë gjëra hynë në xhenet:

- Kush i falë pesë kohët e namazit me abdest, ruku e sexhde dhe në kohë të tyre;
- kush agjëron ramazanin;
- kush ka mundësi dhe gjen rrugëdalje për ta kryer haxhin;
- kush e jep zekatin sinqerisht e me zemrën e tij dhe
- kush e kryen emanetin”

Kur është pyetur: - O Ebu Derda! Ç’është kryerja e emanetit? Ka thënë: - *Pastrimi prej papastërtisë.*

(Ebu Davudi)

## EMANETI I PEJGAMBERËVE

Emaneti është cilësi e pejgamberëve, sepse pejgamberët gjithmonë kanë qenë në kulminacion të moralit. Kur'ani na tregon rastin e **Musait** a.s:

*“Atëherë ai u dha ujë (kafshëve) të atyre, pastaj u largua anash nën një hije e tha: “O Zoti im, unë kam nevojë për çkado që të më japësh!”*

*“E njëra prej tyre erdhi te ai, ecte e turpërueshme, e tha: “Babai im të thërret që të paguajë ty shpërblimin për atë që na u dhe (bagëtisë) ujë!” E kur shkoi (Musai) tek ai dhe ia tregoi atij ngjarjen, ai tha: “Mos ki frikë, paske shpëtuar nga populli zullumqar!”*

*“Njëra prej atyre dyjave tha: “O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi e besniku!”*

*(El Kasas, 24-26)*

**Jusufi** a.s ka qenë besnik në shtëpinë e pronarit të tij.

**Pejgamberi** s.a.v.s ka qenë edhe para shpalljes i njohur si besnik, sa që të gjithë Kurejshit ia kanë dhënë titullin “Muhamedul-Eminë”, që do të thotë **Muhamedi Besnik**.

Po ashtu **Xhibrili**, pra melaqja, e cila ia ka sjellë shpalljen Muhamedit a.s prej Zotit të Lartmadhëruar ka qenë besnik, sepse Zoti i Lartmadhëruar e ka quajtur “Ruhul Emin” - *Shpirti besnik*, sepse meleku Xhibril me besnikëri e ka përcjell Kur'anin te *Muhamedi besnik*, por edhe *Muhamedi besnik* me besnikëri e ka bartë Kur'anin deri te ne, e ne duhet me besnikëri ta përcjellim Kur'anin, me besnikëri të veprojmë sipas urdhrave të Kur'anit dhe me besnikëri ta përcjellim besimin tek brezat e ardhshëm.

## SHKOPI INTERESANT

Një tregtar shkoi në një udhëtim për tregti, mirëpo në vendin ku blinte mall me shumicë nuk kishte me vete para të mjaftueshme. Për këtë arsye shkoi te një njeri dhe i kërkoi 1000 dinar hua. Njeriu pranoi, por e kushtëzoi që të sjellë një garantues - dëshmitar. Tregtari thotë: “Mjafton që Allahu të jetë dëshmitar – garantues për ne.” Atëherë njeriu i thotë: “Mirë pra”. Ia jep të hollat borxh për t’ia kthyer në një periudhë të caktuar.

Tregtari bleu mall, shkoi, e shiti mallin dhe fitoi. Kur erdhi afati i kthimit të borxhit shkoi në bregdet, kërkoi një anije për të shkuar në kohën e caktuar te vendi i borxhdhënësit, mirëpo anije nuk kishte.

Ç’të bënte? Mendoi e mendoi. Duke menduar e sheh një dru. Atëherë, e mori drurin, e bëri një vrimë në të, i vendosi në vrimë 1000 dinarët dhe e shkroi në të emrin e borxhdhënësit. Pastaj e mbylli vrimën e drurit mirë e mirë dhe e hodhi në det. Dhe bëri lutje te Allahu që druri të arrijë në dorën e atij, për të cilin ishte pajtuar që Allahu të jetë Dëshmitar, Garantues në mes tyre.

Në ditën e caktuar për kthimin e borxhit, borxhdhënësi del në bregdet për ta pritur tregtarin, mirëpo atë nuk e takon. Duke u kthyer në shtëpi e sheh në ujë drurin, të cilin e merr për t’u ngrohur. Kur kthehet në shtëpi fillon ta shkurtojë më sharrë, kur sheh të hollat në dru dhe letrën. Për këtë falënderoi Allahun.

Pas një kohe, tregtari shkon te ky njeri, kërkoi falje dhe ia ofroi 1000 dinarë të tjera. Mirëpo, ai nuk i pranoi, por tha: “Vërtet Allahu i ka ruajtur të hollat të cilat i ke dërguar nëpërmjet drurit. O besnik! Zoti të shpërbleftë gjithmonë me të mira për besnikërinë tënde.”

## ARI I MBULUAR

Një njeri ia kishte shitur tokën një njeriu tjetër dhe paratë ia kishte pranuar. Blerësi duke punuar arën, në të gjen një thesar të mbuluar nën dhë. Blerësi e merr thesarin dhe shkon te njeriu nga i cili e kishte blerë tokën, dhe i thotë:

- Këtë thesar e kam gjetur në tokën e blerë, ja merre kjo është e jotja.

Shitësi i thotë: - Unë ta kam shitur tokën dhe çdo gjë që është në të.

Kështu që asnjeri prej tyre nuk e pranonte thesarin. Në fund pajtohen që të shkojnë te Kadia, që ai të vendosë.

Kur shkojnë te Kadiu dhe ia tregojnë rastin, kadiu pyet:

- O shitës, a ke ndonjë djalë?
- Po, ia kthen shitësi.
- O, blerës, po ti a ke ndonjë vajzë?
- Po, ia kthen blerësi.

Atëherë kadiu iu drejtua shitësit: - Martoje djalin tënd me vajzën e blerësit dhe atyre le t'u takojë ky thesar, ndërsa ju për vete mos merrni asgjë.

- Që të dy njëzëri thanë: - Të drejtën e thua, o kadi.

Kështu shitësit dhe blerësit i pëlqeu mendimi i kadiut, pasi që asnjëri prej tyre nuk dëshironte emanetin e huaj.

## EMANETI I OMERIT

Ishte vapë, dielli përcëllonte, Othmani r.a. me shërbëtorin e tij qëndronte nën një hije në periferi të Medinës.

Larg nga aty sheh një njeri, i cili i tërhiqte dy deve. Mendoj në vete: - A thua ç'është ajo që e ka shtyrë këtë njeri në këtë vapë, përse nuk e prit kohën kur të flladitet, e pastaj të vazhdojë udhëtimin?! Kur ai njeri afrohet e kuptoi se ai ishte Omeri r.a. Dhe Othmani r.a. menjëherë u nis në drejtim të tij, mirëpo dielli përcëllues e detyroi të kthehej prapë nën hije. Kur Omeri arriti tek ai, Othmani r.a. i tha: - O Emir i besimtarëve, çfarë të shtyri në këtë kohë të nxehtë të jesh këtu?! Omeri iu përgjigj: - Këto dy deve janë deve të zekatit dhe janë ndarë nga të tjerat. E unë u frikësova se mos po humbasin, e Zoti pastaj të më pyes për to në Ditën e Kijametit. Për këtë arsye shkova, i kërkova, deri sa i gjeta. Dhe tash do t'i dërgoj në torishtë, aty ku janë të tjerat. Othmani i thotë: - O Emir i besimtarëve, eja nën hije, se tash, pjesën tjetër të rrugës le të vazhdojë ndonjë tjetër pas teje. Mirëpo Omeri r.a. refuzoi dhe i tërhoqi devetë deri te vendi i caktuar. Othmani r.a. thotë: - Kush dëshiron të shohë të fuqishmin besnik le të shikoj Emirin e besimtarëve, Omerin r.a.

## BARIU BESNIK

Para Islamit ka ekzistuar sistemi skllavopronar, që do të thotë se disa nga njerëzit i kanë robëruar njerëzit e tjerë. Njëra prej specifikave të Islamit është se ai ka ardhur për lirinë e të gjithë njerëzve. Kështu një herë Abdullah bin Omer bin Hatabi derisa ishte në një shëtitje me një shok të tij, lodhet duke ecur. Ai vendos që të ulet dhe të pushojë rreth një kodre. Aty kalon një bari me dele. Abdullahu e thërret dhe e pyet: - A jeni ju bari i këtyre deleve? Bariu thotë: - Po

Abdullahu i thotë: - A ma shet një dele?

Bariu: - Këto dele nuk janë të miat, por i ruaj. Këto janë të pronarit tim.

Abdullahu provon ta testojë besnikërinë e bariut dhe i thotë: - Po më shit delen, ndërsa pronarit tënd thuaji se e ka hëngër ujku.

Bariu i thotë: - O njeri nëse kështu i them pronarit, i cili nuk më sheh, atëherë çfarë do t'i them në Ditën e Kijametit Zotit, i Cili më sheh?

Abdullahu mahnitet me përgjigjen e bariut dhe fillon të qajë prej frikës së Allahut. Më vonë kupton se ai bari ishte rob. Për këtë arsye shkon te pronari i tij, e blen këtë rob dhe e liron. Pastaj shkon, i blen delet dhe ia jep shpërblim të gjitha, vetëm e vetëm se ka treguar besnikëri dhe ka qenë besnik.

## VAJZA E CILA SHISTE QUMËSHT

Omeri r.a. ka qenë halifja e dytë i muslimanëve. Një natë së bashku me shërbëtorin e tij Eslemin del për një inspektim në qytet për të parë nevojat e qytetarëve. Pas një udhëtimi ndalojnë që të pushojnë në një kënd të qytetit. Aty dëgjon një zë të një gruaje të moshuar duke e urdhëruar bijën e saj që ta përziehte qumështin me ujë. Mirëpo, vajza refuzonte që ta përziehte qumështin me ujë, duke i thënë: - Oj nënë, ti e di se Omeri r.a. e ka ndaluar që të përziehet qumështi me ujë dhe të shitet, sepse kështu tradhtohen njerëzit. Nëna i thotë: - Po edhe nëse është ashtu, ku është Omeri tani, Ai nuk na sheh.

Vajza besnike i thotë: - Pse a duhet ta dëgjojmë halifen e muslimanëve - Omerin para njerëzve, ndërsa fshehtë jo?!

Kjo thënie e gëzoi Omerin r.a. dhe e mahniti besimi i saj dhe besnikëria e saj.

Të nesërmen në mëngjes pyeti për atë vajzë dhe u njoftua se ishte Umi Amaretu bin Sufjan bin Abdullah Eth-Thekafij. Kur e kuptoi se ajo vajza ishte e pamartuar, atëherë kërkoi që ajo të martohej me djalin e tij Asimin. Pasi u martuan, Zoti e bekoi këtë martesë dhe pas tyre trashëguan halifen e drejtë, Omer bin Abdul Azizin.

## RROBA DHE KARAVANI

Një tregtar besnik shkoi për një punë tregu, ndërsa punëtorin e tij e lë t'ia shes mallin. Para se të shkojë i thotë punëtorit: - Shiti njerëzve ashtu siç kam shitur unë dhe mos mashtro askënd. Kjo rrobë është me të meta, andaj mos ia shit askujt, sepse, pasi të kthehem, do ta rregulloj e pastaj do ta shes.

Pasi që tregtari besnik shkoi, një jehudi vjen dhe e blen rrobën me të meta, me të njëjtin çmim të rrobave pa të meta.

Jahudia ishte në udhëtim, në shoqëri të një karvani, kështu që karvani vazhdon rrugën.

Në mes të ditës tregtari besnik kthehet dhe nuk e sheh rrobën me të meta. Kur e pyet punëtorin, ai i thotë se ia kam shitur një jehudiut, në vlerë prej 3000 dërhëmëve. Tregtari hidhërohet dhe e pyet: - Ku është ai njeri? - Ai ka udhëtuar me një karvan, i përgjigjet. Tregtari i merr të hollat, i hipi kalit dhe me shpejtësi i shkon pas karvanit dhe pas një udhëtimi të mundimshëm e arrin karvanin. Tregtari pyet se ku është njeriu, i cili e ka blerë rrobën. Pasi që lajmërohet, i thotë: - Më vjen keq, po ju keni blerë rrobën me të meta, merri të hollat dhe ma kthe mallin. Jahudiu habitur i thotë: - Çfarë të shtyri që të veprosh kështu?! Tregtari besnik i thotë: - Feja ime më urdhëron që të jem besnik dhe ma ndalon tradhtinë. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

***“Kush mashton nuk është prej nesh.” (MUSLIMI)***

Jahudiu befasohet. Pasi jahudiu i merr të hollat e tij, ia kthen rrobat tregtarit, dhe i tregon se edhe të hollat kanë qenë të falsifikuara. Atëherë jahudiu e pranon islamin duke thënë:

***Eshhedu en la ilahe il-lallah, ve eshhedu ene Muhameden resulullah.***

## MALLI I KALBUR

Kur të shkojmë në treg është mirë të bëhet kjo lutje:

LA ILAHE IL-LALLAH, VAHDEHU LA SHERIKE LEH,  
LEHUL MULKU VE LEHUL HAMDU, JUHJI VE JUMIT, VE  
HUVE HAJJUN LA JEMUT, BI JEDIHIL HAJR, VE HUVE ALA  
KUL-LI SHEJ IN KADIR.

Në gjuhën shqipe do të thotë:

*“Nuk ka Zot tjetër pos Allahut, i vetmi, i pashoq, Ai ka krijuar jetën dhe vdekjen, Ai është i gjallë nuk vdes, në dorën e Tij është e gjithë e mira, Ai ka mundësi për çdo send”.*

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

***“Tregtari i drejtë dhe besnik do të jetë në shoqërinë e pejgamberëve, të mirëve dhe dëshmorëve.”***

Një ditë Pejgamberi s.a.v.s. shkon në treg për të përcjellë veprimin e njerëzve dhe mënyrën e shitblerjes në treg. Kalon pran një njeriu, i cili kishte vendosur mallin në treg për shitje. E përshëndet me selam dhe e shikon mallin. E vendos dorën në brendi të mallit dhe e sheh se në brendësi malli ishte i lagur.

Pejgamberi s.a.v.s. hidhërohet dhe i thotë tregtarit: *“Çka është puna me këtë mall.”*

Tregtari kërkon falje dhe arsyetohet duke i thënë Pejgamberit s.a.v.s. se ka rënë shi dhe uji i shiut ka depërtuar në brendësi.

Pejgamberi s.a.v.s. nuk e pranon arsyetimin dhe e këshillon që të jetë tregtar besnik dhe ta tregojë të metën e mallit para njerëzve, duke i thënë: “Po përse mallin e lagur nuk e ke vendosur sipër që ta shohin blerësit? Pastaj thotë:

***“Kush tradhton, ai nuk është prej nesh.”***

## PASURIA E PASTËR

**Ebu Hanife** përpos që ka qenë dijetar, ka qenë edhe tregtar.

Një ditë prej ditëve Ebu Hanife e dërgon punëtorin e tij që t'ia shes mallin në treg. Në mesin e rrobave ka qenë një rrobë e klasës së dytë, pra me të meta. Ebu Hanife i tregon punëtorit se kush dëshiron ta blejë këtë rrobë, le ta blejë më çmim më të ulët, në krahasim me rrobat e tjera dhe e porositi që t'ia tregojë të metën e rrobës. E nëse pajtohet blerësi, le ta blejë; nëse nuk pranon, mos ta blejë.

Punëtori shkon në treg dhe i shet të gjitha rrobat, dhe harron që rrobën me të meta ta shes me çmim më të lirë.

Kur i kujtohet fillon të kërkojë nëpër treg blerësin, por kot, nuk munda ta takojë dot.

Kthehet te Ebu Hanife dhe i tregon se çfarë i ka ndodhur.

Ebu Hanife vendosi që të gjitha të hollat e asaj tregtie t'i japë sadaka, nga frika se mos po përzihet malli haram në pasurin e tij.

Kështu pra Ebu Hanife ka qenë tregtar besnik dhe ka vepruar me besnikëri në shit-blerje.

## RROBA E SHTRENJTË

Ebu Hanife shkon te një grua, e cila shiste rroba të mëndafshit.

- Sa kushton rroba, e pyeti Ebu Hanifja.
- Njëqind dërhëm, përgjigjet gruaja.
- Jo, kjo rrobë kushton më shumë se njëqind dërhëm.

Gruaja habitet se si blerësi e rrit çmimin. Kështu Ebu Hanifja ia rrit çmimin në katërqind dërhëm.

- Kjo rrobë kushton më shumë se katërqind dërhëm, tha Ebu Hanifja.

- A mos po tallesh me mua, i thotë gruaja.
- Sille një tregtar me përvojë që ta caktojë çmimin.

Shkoi dhe e solli një tregtar. Tregtari thotë se çmimi standard i kësaj robe është pesëqind dërhëm.

Kështu që Ebu Hanifja e blen rrobën me atë çmim.

Gruaja i merr të hollat dhe kthehet e lumtur dhe e kënaqur me tregtinë e saj dhe e falënderon Ebu Hanifen për vërtetësinë dhe besnikërinë e tij.

## DHURATA

Pejgamberi s.a.v.s. dërgoi një njeri te fisi Beni Selimë që ta tubojë zekatin. Pasi që e tuboi zekatin, kthehet në Medine, shkon te Pejgamberi s.a.v.s dhe e takon ulur me shokët e tij. Pasi i jep salam, dorëzon zekatin e tubuar, ndërsa një pjesë tjetër e ndal. Pejgamberi s.a.v.s e pyet: “Po pse po e ndalë pasurinë tjetër?” Ai i përgjigjet se këtë ia kanë dhënë dhuratë. Pejgamberi s.a.v.s. ia sqaron se çfarë do të thotë emaneti dhe se atë pasuri ia kishin dhënë dhuratë pasi që e kanë ditur se ishte dërguar prej Pejgamberit s.a.v.s. Prandaj, po të mos ishte në këtë detyrë apo në këtë post, nuk do t’i kishin dhuruar. Pra, të tërën duhet dorëzuar në bankën e muslimanëve.

Pejgamberi s.a.v.s. na ka udhëzuar që ne si musliman të jemi besnik ndaj pasurisë së vëllezërve musliman, dhe nuk duhet të bëhemi tradhtar, sepse Zoti i Lartmadhëruar na dënon në Ditën e Kijametit.

## EBU UBEJDETE BIN XHERRAHI

Muhamedi s.a.v.s ka thënë:

*“Secili popull e ka besnikun e vet, e besniku i këtij populli është Ebu Ubejde.”*

Ebu Ubejde bin Xharrah është njëri prej dhjetë personave, të cilët janë paralajmëruar se do të hyjnë në xhenet. Ai e donte Allahun dhe të Dërguarin e Tij, por edhe Pejgamberi s.a.v.s. e donte shumë. Kur është pyetur Aisha r.a. se cilin prej sahabëve Pejgamberi s.a.v.s. e donte më së shumti, ajo është përgjigjur: - Më së shumti e donte Ebu Bekrin. - Po pastaj? - Omerin. Po pastaj? - Ebu Abidete bin Xherrarin, është përgjigjur ajo.

Për Ebu Ubejdete bin Xherrahin ka zbritur ajeti kur'anor:

*“Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit, e ta dojë atë që e kundërshton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë që në zemrat e tyre (Ai) ka skalitur besimin dhe e ka forcuar me shpirt nga ana e Tij dhe ata do t'i shpjerë në xhennete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Aty janë përgjithmonë. All-llahu ua ka pëlqyer punën e tyre dhe ata janë të kënaqur me shpërblimin e Tij. Të tillët janë palë (grup, parti) e All-llahut, ta dini pra, se ithtarët e All-llahut janë ata të shpëtuarit.”*

*(El-Muxhadele, 22)*

Shkak i zbritjes së këtij ajeti ka qenë se në luftën e Bedrit baba i Ubejdes kishte shkuar në luftë vetëm për ta mbytur të birin e tij, vetëm pse është bërë musliman. Gjatë betejës, Ebu Ubejde largohej nga baba i tij dhe kalonte në turmën tjetër, mirëpo babai i tij nuk e linte të qetë dhe vazhdimisht i shkonte pas, deri sa Ebu Ubejde e vret babën e tij.

Ebu Ubejde, edhe në luftën e Uhudit, deri sa pabesimtarët e sulmonin Muhamedin s.a.v.s, ishte vendosur mburojë e hekurt e trupit të Muhamedit s.a.v.s.

Pas betejës, Pejgamberit s.a.v.s. i ishte lënduar balli, ndërsa dy hallkat e parzmës së tij i kishin hyrë nën mollëzat e syrit. Ai me dhëmbët e tij i kafshon ato dhe me tërë fuqinë e dhëmbëve të përparmë të tij ia tërheq, edhe pse dhëmbët i bien ai nuk brengosej, vetëm e vetëm që Pejgamberi s.a.v.s të mos ndiej dhembje gjatë heqjes së hallkave nga mollëzat e syrit.

Ebu Bekri Sidiki ka thënë: - Ebu Ubejde është prej njerëzve më të pashëm pa dhëmbët e përparmë.

Ebu Ubejdete ishte besnik ndaj Allahut, besnik ndaj Pejgamberit dhe ishte besnik i umetit.

## **DËNIMI I TRADHTISË**

Tradhtia e shpie njeriun në pabesim, sepse Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Kush prej nesh na tradhton, ai nuk është i mesit tonë. Në Ditën e Kijametit tradhtari do ta ketë një shenjë dhe për të do të thuhet: - Ky është tradhtar.”

- Prej tradhtarit njerëzit largohen dhe nuk i afrohen atij.

## **ÇKA PËRFITJËMË NGA KY LIBËR**

Nga ky libër përfitojmë se:

- Emaneti është cilësi e besimtarëve.
- Rrena, mashtrimi dhe tradhtia janë cilësi të hipokritëve.
- Dënimi i tradhtisë është zjarri i xhehenemit.
- Shpërblimi i besnikërisë është xheneti.
- Emaneti sjell lumturi në jetë dhe të shpëton prej fatkeqësive.

## PËRFUNDIM

Të përkujtojmë ajetin: *“Vërtet Allahu ju urdhëron që ta dorëzoni emanitn te pronaret e tyre”*. Ndërsa përkujtimi është për ata që kanë zemër, përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën.

Ndoshta kjo çka është shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

# **TURPI**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

**16**



## TURPI

Muslimani është i turpëruar dhe e do turpin. Turpi është edukatë islame. Njeriun e turpëruar e do Allahu, po ashtu e duan edhe njerëzit. Turpi është e kundërta e imoralitetit.

Çdo fe e ka edukatën e vet, edukata e islamit është turpi. Turpi është të përmbajturit e rrugës së vlerave dhe edukatës islame.

Turpi ka vend të posaçëm tek Allahu. Për këtë arsye Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Turpi është prej Imanit.”*

Imani dhe turpi janë dy shokë që shkojnë së bashku dhe nuk ndahen asnjëherë. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Turpi dhe Imani janë dy çështje të përbashkëta dhe të pandashme, nëse njëra humb, humb edhe tjetra.”*

*(Hakimi)*

Turpi është çështje e rëndësishme dhe me vlerë. Turpi sjell mirësi dhe i largon të këqijat. Turpi sjell begati, dobi dhe vlera. Për këtë arsye Pejgamberi s.a.v.s ka thënë:

*“Turpi sjell vetëm të mira” (Mutefekun alejhi).*

Po ashtu ka thënë:

*“Turpi në tërësi është mirësi.” (Muslimi)*

Turpi është cilësi e Allahut, po ashtu është cilësi e pejgamberëve dhe e njerëzve të devotshëm. Për këtë arsye i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

*“Vërtet Allahu është i turpshëm dhe i fshehtë, dhe e do turpin dhe të fshehtën.” (Ahmedi)*

Një dijetar thotë: “Turpi është një rrobë, e cila nuk ka asnjë të metë.”

Muslimani turpërohet nga Zoti për të mira, e turpërohet që Allahu ta shoh në mëkate, po ashtu turpërohet para njerëzve, e ulë shikimin, flet me vëmendje, nuk përdor fjalë të këqija, nuk nënçmon të tjerët, gjithmonë është i ëmbël me fjalë, i sjellshëm me vepra, i pastër me zemër dhe i çiltër me shpirt.

Ai, i cili nuk turpërohet prej njerëzve, ai e ka humbur burrërinë e tij.

Turpi duhet të jetë shkëndija, e cila e ruan muslimanin që ta ruajë dritën e besimit.

## TURPI NË KUR'AN

Fjala turp në Kur'an është përmendur katër herë në tre ajete.  
Në suren Bekare, ajeti 26:

*“All-llahu nuk turpërohet (nuk ngurron) që të marrë çfarëdo shembulli, qoftë mushkonjë a diçka edhe më e imët se ajo. Për sa u përket atyre që besuan, ata e dinë se ai (shembulli) është i vërtetë nga Zoti i tyre, ndërsa ata të cilët mohuan do të thonë: “Ç’deshi All-llahu me këtë si shembull?” Ai me të humb shumë, e po me të udhëzon në rrugën e drejtë shumë, po me përjashtim të atyre që janë jashtë rrugës, Ai me të nuk humb tjetër.”*

*(El-Bekare, 26)*

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti është se, kur Zoti i Madhëruar ka sjell shembuj në Kur'an, duke përmendur mushkonjën e mizën, atëherë idhujtarët dhe hipokritët thoshin: “Çfarë është kjo, mushkonja e miza? Allahu duhet të sjell shembuj të tjerë, e jo kështu shembuj.” Atëherë ka zbritur ky ajet që përmendëm më lart.

Rasti i dytë është në suretën Ahzab, ajeti 53:

*“O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit ndryshe vetëm nëse u lejohej për ndonjë ngrënie e duke mos pritur përgatitjen e saj, por kur të thirreni, atëherë hyni, e kur të jeni ushqyer, atëherë shpërndahuni, duke mos hyrë në bisedë me njëri-tjetrin, vërtet këto (pritja, qëndrimi, biseda) e mendojnë Pejgamberin, por ai turpërohet prej jush; All-llahu nuk i turpërohet realitetit. E kur kërkon prej tyre (grave të Pejgamberit) ndonjë send, atë kërkojeni pas perdes, kjo është më pastër për zemrat tuaja dhe të tyre. Juve nuk u takon ta mundoni të dërguarin e All-llahut, e as të martoheni kurrë me gratë e tij, pas (vdekjes së) tij. Këto janë tek All-llahu mëkat i madh.”*

*(El-Ahzab, 53)*

Ndërsa, rasti i tretë është, kur njëra prej bijave të Shuajbit a.s. shkon te Musa a.s. për ta ftuar e për të shkuar te prindi i saj, pasi që Musa a.s. u kishte ndihmuar që bagëtia të pinte ujë.

*“E njëra prej tyre erdhi te ai, ecte e turpërueshme, e tha: “Babai im të thërret që të paguajë ty shpërblimin për atë që na u dhe (bagëtisë) ujë!” E kur shkoi (Musai) tek ai dhe ia tregoi atij ngjarjen, ai tha: “Mos ki frikë, paske shpëtuar nga populli zullumqar!”*

*(El-Kasas, 25)*

## TURPI NË SUNET

Muhamedi s.a.v.s. vazhdimisht i nxiste muslimanët që të jenë të turpshëm. Ka shumë hadithe, të cilat flasin për turpin. Ne do ti përmendim disa prej tyre:

*“Imani (besimi) është gjashtëdhjetë e disa apo shtatëdhjetë e disa degë: Më e vlefshme është fjala: “La ilahe il-lall-llah” (nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut), kurse më e ulëta është të larguarit nga rruga e asaj që i mundon kalimtarët. Edhe turpi është një degë e imanit”.*

*(Mutefekun Alejhi)*

*“Ajo çka e kanë kuptuar njerëzit prej fjalëve të para të pejgamberëve ka qenë: Nëse nuk turpëroresh, vepro ç’të duash.”*

*(Mutefekun Alejhi)*

Po ashtu hadithi:

*“Çdo fe ka moralin e vet e morali i islamit është turpi.” (Maliku)*

Allahu e do njeriun, i cili turpërohet. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Vërtet Allahu e do të turpëruarin të ndërgjegjshëm.” (Bejhekiu)*

*“Turpi është prej imanit, e imani shpie në xhenet.”*

*“Turpi sjell gjithmonë të mira.”*

*“Turpin ë tërësi është mirësi.”*

## TURPI PREJ ALLAHUT

Grada më e lartë e turpit është turpi ndaj Allahut. Muhamedi s.a.v.s na ka këshilluar:

*“Turpërohuni nga Allahu me turpërim të pashoq.”*

*(Tirmidhiu)*

Frika ndaj Allahut është bazë kryesore ndaj Tij. Një njeri shkon te Ibrahim bin Et’hemi dhe i thotë:

- Dua të pendohem, por pasi pendohem frikohem se prapë do të kthehem në mëkate. A më tregon si të mbrohem nga mëkatet?

Ibrahimi i thotë: - Nëse dëshiron të bësh mëkat, mos e bën në tokën e Allahut.

Ai i thotë: - Po e gjithë toka është e Allahut!

Ibrahimi i thotë: - Pasi që e di se e gjithë toka është e Allahut, atëherë mos bën mëkate në tokën e Tij.

Pastaj Ibrahimi i thotë: - Nëse dëshiron të bësh mëkat, mos ha prej furnizimit të Allahut.

Ai i thotë: - Po si të jetoj, çdo gjë është furnizim prej Allahut!?

Ibrahimi thotë: - Mirë pra, a nuk të vjen turp që ti të shfrytëzosh të gjitha begatitë dhe të mirat e Allahut dhe të bësh mëkate ndaj Tij!?

Pastaj Ibrahimi i thotë: - Nëse dëshiron të bësh mëkat, bëje në një vend ku nuk të sheh Allahu.

Ai i thotë: - Po ku ta gjej atë vend, kur dihet se Allahu të sheh në çdo kohë dhe çdo vend?!

## TURPI PREJ KUR'ANIT

Një hajdut plaçkiste shtëpitë natën. Ai gjithçka që ishte e vlefshme e merrte nga shtëpitë e huaja. Një ditë hajni studio mirë e mirë një shtëpi, mësoi hyrjen dhe daljen, caktoi kohën e hyrjes në atë shtëpi dhe programoi mënyrën e vjedhjes. Pas mesnate dhe para sabahut hyri në shtëpi, ai hipi në kulm të shtëpisë, dhe nga lart zbriti brenda, nëpërmjet shkallëve ndihmëse. Kur hyri në një dhomë dëgjoi këndimin e Kur'anit nga dhoma tjetër, derisa pronari i shtëpisë falej dhe lexonte ajetin kur'anor:

*“A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e All-llahut dhe me atë të vërtetën që zbriti (me Kur'an), e të mos bëhen si ata, të cilëve u është dhënë libri më parë e zgjati koha dhe zemrat e tyre u shtangën e shumë prej tyre janë jashtë rrugës.”*

*(El-Hadidë, 16)*

Në atë moment hajni u ndal dhe filloi të mendojë. Atij i vinte turp ta plaçkiste këtë shtëpi, në të cilën lexohej Kur'ani. Por, e ngriti kokën lart dhe me zemër të pastër tha: “Po, tani ka ardhur koha, o Zoti im! Tani është koha të më zbutet zemra të të kujtoj Ty dhe të frikësohem nga Ti. Pastaj hajni u ngrit shkallëve përpjetë, hipi në kulm dhe nga aty zbriti në rrugë, dhe vazhdoi rrugën duke kujtuar Allahun e Lartmadhëruar, derisa afrohet afër derës së një xhamie dhe në atë moment thërret ezani i sabahut. Hyri në xhami, fali sabahun dhe u pendua sinqerisht. Më vonë ky njeri u bë prej njerëzve më të devotshëm dhe kjo nga shkaku se u turpërua nga fjala e Allahut të Lartmadhëruar.

## TURPËRIMI I PEJGAMBERIT S.A.V.S

Kur Pejgamberi s.a.v.s është martuar me Zejnebe bin Xhahshin r.a. ka përgatitë ushqim për dasmorët. Kur shkojnë dasmorët në dasmë ushqehen, qëndrojnë një kohë dhe shkojnë. Mirëpo, tre prej tyre nuk shkojnë, por vazhdojnë të qëndrojnë. Zejnebja në një kënd të shtëpisë qëndronte dhe priste të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. Kur Muhamedi s.a.v.s. hyn në dhomë përderisa ata bisedonin, i vjen turp dhe del nga ajo dhomë. Pas një kohe prapë shkon në dhomë, kur i sheh duke biseduar prapë del, kjo i ndodhë disa herë. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. shkon te Aijsha r.a. dhe ulet te ajo. Kur përfundojnë bisedën dhe shkojnë, atëherë Muhamedi s.a.v.s. shkon te Zejnebja r.a. Për këtë arsye Zoti i Madhëruar ka zbritur ajetin Kur'anor, për t'ua treguar muslimanëve se si duhet të sillen me Pejgamberin s.a.v.s.

Zoti i Lartmadhëruar, për këtë rast, zbriti ajetin:

***“O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit ndryshe vetëm nëse u lejohet për ndonjë ngrënie e duke mos pritur përgatitjen e saj, por kur të thirreni, atëherë hyni, e kur të jeni ushqyer, atëherë shpërndahuni, duke mos hyrë në bisedë me njëri-tjetrin, vërtet këto (pritja, qëndrimi, biseda) e mundojnë Pejgamberin, por ai turpërohet prej jush; All-llahu nuk i turpërohet realitetit. E kur kërkonit prej tyre (grave të Pejgamberit) ndonjë send, atë kërkojeni pas perdes, kjo është më pastër për zemrat tuaja dhe të tyre. Juve nuk u takon ta mundoni të Dërguarin e All-llahut, e as të martoheni kurrë me gratë e tij, pas (vdekjes së) tij. Këto janë tek All-llahu mëkat i madh.”***

*(Suretul – Ahzab, 53)*

## **TURPI I MUSA A.S.**

Kur laheshin beni Israilët, laheshin lakuriq, duke e shikuar njëri tjetrin dhe nuk turpëroheshin për këtë. Musa a.s. kishte turp dhe turpi nuk e lejonte të bënte një veprim të tillë, por ai lahej i vetmuar dhe larg njerëzve.

Njerëzit thoshin se Musa a.s. lahet i vetmuar, sepse ka të meta në trupin e tij. Zoti i Lartmadhëruar ka dashur që ta vërtetojë pastërtinë e Musa a.s.

Kështu Musa.a.s. një ditë shkon për t'u larë, i afrohet një shkëmbi, zhvishet dhe i vendos rrobat mbi një gur. Pasi pastrohet, shkon t'i vesh rrobat. Guri përmbysset dhe bie në ujë dhe së bashku me rrobat shkon teposhtë ujit. Musa a.s e merr një shkop dhe shkon pas rrobave duke thënë:

- Rrobat e mia i morri guri, derisa arrin pranë një turme të beni Israilëve. E ata e panë lakuriq, mirëpo e vërtetuan se në trupin e tij nuk kishte kurrfarë të mete, por përkundrazi trupi i tij ishte i përsosur.

Kështu e vërtetuan beni Israilët se Musa a.s. lahej i vetmuar dhe duke u fshehur, vetëm nga shkakut se turpërohej shumë.

## OTHMANI R.A

Othmani r.a është halifeja e tretë e muslimanëve pas Ebu Bekri Sidikit dhe Omerit r.a. Ai kishte mësuar shkrimin dhe leximin, ishte i njohur për moral dhe karakter, kishte besnikëri, fisnikëri, por mbi të gjitha ai ishte i njohur për cilësinë e turpit. Për të Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, melaqet turpërohen nga Othmani, ashtu siç turpërohen nga Allahu dhe i Dërguari i Tij.”*

*(Taberaniju)*

Për këtë arsye, çdo herë kur përmendet fjala turp, na kujtohet Othmani r.a., dhe çdo herë kur përmendet Othmani r.a, përmendet fjala turp.

Othmani r.a. është prej pesë të parëve, të cilët kanë pranuar Islamin. Është martuar me Rukijën, vajzën e Pejgamberit s.a.v.s. Së bashku me të ka emigruar në Abisini, pastaj është kthyer në Meke dhe prapë ka emigruar në Medine. Në Medine Rukija vdes. Pejgamberi s.a.v.s. e marton me vajzën e dytë, Umi Kulthumin. Për këtë arsye edhe quhet pronari i dy dritave, sepse është martuar me dy vajzat e Pejgamberit s.a.v.s.

Kur ka vdekur Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë i kënaqur me të.

Në kohën kur ka qenë Halife e ka tubuar Kur'anin në Mus-haf. Për këtë arsye edhe shkrimi dhe faqosja e Mus-hafit quhet *Shkrimi dhe Mus-hafi sipas Othmanit r.a.*

## LOJA E PAHIJSHME

Abdullah bin Harithi r.a. ishte shok i Pejgamberit s.a.v.s. Një ditë ai me një shok dalin nga shtëpia për çështje të tyre. Duke kaluar pranë një vendi, shohin një grup të fisit kurejsh, të cilit ishin zhveshur dhe i kishin lidhur si litarë dhe bënë njëri-tjetrin me rroba, loznin, qeshnin, dëfreheshin dhe nuk brengoseshin se ishin lakuriq, në ambient të hapur. Kur Abdullahu dhe shoku i tij kalojnë pranë tyre, ata vazhdojnë lojën e tyre dhe nuk turpëroreshin fare.

Më vonë pranë tyre kalon Pejgamberi s.a.v.s., kur e shohin, shpërndahen secili duke vrapuar që ta gjejë ndonjë vend që të fshihet, që mos ta shohë Pejgamberi s.a.v.s.

Pejgamberi s.a.v.s. hidhërohet dhe hynë në shtëpinë e tij dhe thotë:

*“Subhanallah, ata as prej Allahut nuk turpërohen e as prej të Dërguarit të Tij nuk mbulohen.”*

Umu Ejmen, kur e sheh Pejgamberin s.a.v.s. i thotë: - O i dërguar i Allahut, kërko falje për ta. Muhamedi s.a.v.s., për shkak se ata ishin të paturpshëm, nuk ka dashur të kërkojë falje, por përderisa Umi Ejmen vazhdimisht insistonte, ia plotësoi dëshirën dhe kërkoi falje për ta.

## TURPI I SEHABIJATES

Sehabija e njohur, me emrin Umi Halad r.a., kur morri vesh se djali i saj ishte vrarë në betejë, shkon te Pejgamberi s.a.v.s. për ta konfirmuar lajmin për birin e saj. Umi Halad r.a. ishte me mbulesë.

Kur njerëzit e tjerë e shohin, habiten se si ajo nuk e kishte zbuluar kokën e saj, se si nuk e kishte gërvishtur fytyrën e saj dhe pse nuk vepronte siç vepronin gratë zakonisht, por përkundrazi kishte ardhur si burrneshë, e mbuluar edhe pse i kishte ndodhur tragjedi.

Njëri e pyeti: - Ke ardhur me mbulesë dhe po pyet për birin tënd?!

Umi Halad r.a. thotë: - *Nëse më ka humbur biri im, nuk më ka humbur turpi im.*

## VAJZA E SHUAJBIT A.S.

Ishte një njeri tepër i moshuar, ai nuk kishte fëmijë djem, por vetëm dy vajza. Kështu vajzat e tij ruanin bagëtinë, ata në mëngjes e lëshonin bagëtinë, ndërsa ktheheshin para mbrëmjes. Një ditë ato u kthyen më herët, para mbrëmjes. Babai i pyet: - Pse sot keni ardhur më herët. Njëra nga vajzat i përgjigjet: - Përderisa ishim duke pritur në një largësi, ndërsa barinjtë e tjerë u jepnin ujë bagëtive, erdhi një njeri dhe na pyeti, dhe ne i treguam se nuk mund t'u japim ujë bagëtive para se të shkojnë barinjtë (meshkujt) nga pusi i ujit.

Ky njeri që i pyeti vajzat ishte Musa a.s. Kur pa ndershmërinë dhe turpin e vajzave të Shuajbit a.s. u ndihmoi atyre dhe u dha ujë bagëtisë:

***“E njëra prej tyre erdhi te ai, ecte e turpërueshme, e tha: “Babai im të thërret që të paguajë ty shpërblimin për atë që na u dhe (bagëtisë) ujë!” E kur shkoi (Musai) tek ai dhe ia tregoi atij ngjarjen, ai tha: “Mos ki frikë, paske shpëtuar nga populli zullumqar!”***

(Kasas, 25)

Pra, Kur'ani tregon se vajza, e cila turpërohet ka vlerë të madhe. Pastaj Musa a.s shkon te babai i saj dhe i tregon për Egjiptin. Pejgamberi Shuajb kërkoi nga Musa që të martohet me njëren prej vajzave të tij, që t'i shërbejë tetë apo dhjetë vite. Pas këtyre viteve Musa a.s. prapë është kthyer në vendlindjen e tij.

## PEMA E MIRË

Një ditë, përderisa Pejgamberi s.a.v.s ishte ulur me shokët e tij i pyeti:

*“Është një pemë, të cilës nuk i bien gjethet, ajo pemë është sikur muslimani. A po më tregoni cila është ajo pemë?”*

Abdullah bin Umeri ishte ulur. Ai ishte më i riu për nga vitet. Ai e dinte se ajo pemë ishte hurma. Mirëpo, kur e sheh Ebu Bekri Sidikin duke heshtur, po ashtu edhe Omerin r.a., i erdhi turp që të jepte përgjigjen.

Të tjerët, të cilët ishin ulur, i përmendnin llojet e ndryshme të pemëve. Ndërsa, Muhamedi s.a.v.s u thoshte: *“Jo.”* Pastaj ata i thanë: - O i Dërguar i Allahut, na trego ti, se ne nuk po e dimë?

Muhamedi s.a.v.s u thotë: *“Ajo pemë është hurma.”*

Kur përfundoi kuvendimi dhe sahabët u shpërndanë, Abdullahu i thotë babës së tij: - E kam ditur se është hurma. Baba i thotë: - Po përse heshte, e nuk e dhe përgjigjen e saktë. Djali i thotë: Më erdhi turp, pasi që ju nuk përgjigjeshit. Atëherë baba i thotë: - Po të kishe folur dhe përgjigjur, kjo do të ishte për mua më e dashur se një deve e shtrenjtë të ma kishe dhuruar. E vërtetë është. Në dituri nuk ka turp.

## URDHËRIMI NË PUNË TË MIRA DHE TURPI

Aishja, gruaja e Pejgamberit s.a.v.s ka thënë:

*“Lumë për gratë e Ensarëve, për të cilat nuk ka qenë pengesë turpi që ato të pajisen me dituri të fesë.”*

*(Buhariu dhe të tjerët)*

Nuk është turp të urdhëruarit në punë të mira, sepse Muhamedi s.a.v.s ka thënë:

*“Kush nga ju e sheh një të keqe le ta largojë me dorën e tij; e nëse nuk mundet me dorë, atëherë me gjuhën e tij; e nëse nuk mundet edhe me gjuhë, atëherë me zemrën e tij, por kjo është shkalla më e dobët e besimit.”*

*(Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe)*

## TURPI ËSHTË PREJ IMANI

Një ditë, përderisa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. kalonte nëpër një rrugë të Medinës, e shih njërin prej sahabëve duke e qortuar vëllanë e tij dhe duke mallkuar, pse është tepër i turpshëm. Ai i thoshte: - Mos u turpëro para njerëzve.

Pejgamberi s.a.v.s ka dëshiruar që t'u tregonte ensarëve se turpi nuk është e metë dhe as mangësi e njeriut, por përkundrazi turpi është stoli e besimtarit. Për këtë arsye e thërret sahabiun dhe i thotë:

*- Lëre vëllanë në gjendjen e tij, se nuk ka dyshim se turpi është prej imani.*

## TURPËRIMI I SINQERTË

Ibn Mesudi transmeton se Pejgamberi s.a.v.s ka thënë:

*“Kini kujdes prej Allahut, singerisht.”* Ne e pyetëm (vazhdon të tregoj Ibn Mesudi): - O i dërguar i Allahut po ne turpërohemi prej Allahut. Pejgamberi s.a.v.s tha:

*Turpërimi i sinqertë prej Allahut është:*

- që ta mbrosh kokën dhe atë që përmban,
- barkun dhe atë që përmban,
- ta përkujtosh vdekjen dhe sprovimin,
- ai që e do botën tjetër dhe e lë zbukurimin e kësaj bote, pra i jep përparësi botës tjetër ndaj kësaj bote.

*Andaj kush vepron kështu ai është turpëruar singerisht prej Allahut.”*

*(Transmeton Tirmidhiu)*

Në hadith tjetër Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Turpi është prej besimit, e besimi është në Xhenet, ndërkaq paturpësia është prej arrogancës, e arroganca është në zjarr.”*

*(Transmeton Ahmedi)*

## TURPI DHE SHKATËRRIMI I NJERIUT

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Allahu i Lartmadhëruar kur dëshiron ta mposhtë ndonjë njeri ia largon atij turpin, e kur t’i largohet turpi, atëherë ai bëhet i paturpshëm dhe i urryer; e kur bëhet i urryer, prej tij largohet besnikëria; e kur largohet besnikëria, ai bëhet tradhtar; e kur të bëhet tradhtar, prej tij largohet mëshira; e kur t’i largohet mëshira, ai bëhet i izoluar dhe i mallkuar; e kur të bëhet i mallkuar, ai do të dalë prej lidhjes së fesë.”*

*(Transmeton Ibn Maxhe)*

Pra, kjo është renditje e sëmundjes së shpirtit, të cilat shkaktojnë problemet e tjera. Pra, duke kaluar prej një të keqe, në të keqen tjetër më të madhe.

Tregohet se një kohë kishin kaluar së bashku: dituria, pasuria dhe turpi. Pastaj ato vendosin që të ndahen dhe ia kërkojnë njëra-tjetrës adresën, që të takohen përsëri.

**Dituria tha:** - Adresa ime është shkolla. Çdo herë kur dëshironi të më takoni, do të më gjeni atje.

**Pasuria tha:** - Adresa ime është kështjella. Çdo herë kur dëshironi të më takoni, do të më gjeni atje.

**Turpi** e uli kokën dhe nuk foli. Kur i thanë: - përse nuk po flet? Ajo u përgjigj: - *Nëse unë largohem, atëherë kurrë nuk do të më gjeni!?*

## VAJZA E TURPËRUAR

Omeri r.a. ka qenë halifeja e dytë i muslimanëve. Një natë së bashku me shërbëtorin e tij, Eslemin, del për një inspektim në qytet për të parë nevojat e qytetarëve. Pas një udhëtimi ndalojnë që të pushojnë në një kënd të qytetit. Aty dëgjon një zë të një gruaje të moshuar duke e urdhëruar bijën e saj që ta përziepte qumështin me ujë. Mirëpo, vajza refuzonte që ta përziepte qumështin me ujë, duke i thënë: - Oj nënë, ti e di se Omeri r.a. e ka ndaluar që të përziehet qumështi me ujë dhe të shitet, sepse kështu tradhtohen njerëzit. Nëna i thotë: - Po edhe nëse është ashtu, ku është Omeri tani, Ai nuk na sheh.

Vajza besnike i thotë: - Pse a duhet ta dëgjojmë halifen e muslimanëve - Omerin para njerëzve, ndërsa fshehtë jo?!

Kjo thënie e gëzoi Omerin r.a. dhe e mahniti besimi i saj dhe besnikëria e saj.

Të nesërmen në mëngjes pyeti për atë vajzë dhe u njoftua se ishte Umi Amaretu bin Sufjan bin Abdullah Eth-Thekafij. Kur e kuptoi se ajo vajza ishte e pamartuar, atëherë kërkoi që ajo të martohej me djalin e tij Asimin. Pasi u martuan, Zoti e bekoi këtë martesë dhe pas tyre trashëguan halifen e drejtë, Omer bin Abdul Azizin.

## SI TË PAJISEMI ME TURP

Në shkollë shkonin së bashku e mësonin Emineja e Seadetja, mirëpo ato ndryshonin nga morali. Emineja kishte turp të flas me djem. Nëse ndonjëri prej shokëve të saj i fliste, ajo skuqej nga turpi dhe e ulte zërin kur fliste. Ndërsa Seadetja nuk turpërohej fare, fliste me zë të lartë, gjerë e gjatë dhe çka i binte në kokë. Këtë çështje e kishte kuptuar mësuesja dhe e këshilloi Seadeten që të sillej sikurse shoqja e saj, Emineja. Seadetja thoshte se ajo veç ishte mësuar të sillej ashtu, edhe pse kishte dëshirë që të ishte si Emineja, e turpëruar. Mësuesja kërkoi nga ajo që një ditë, ajo së bashku me Eminën, të shkonin te shtëpia e saj, që të bisedonin. Ashtu edhe ndodhi.

Mësuesja sqaroi për rëndësinë e turpit, posaçërisht sa i takon vajzave dhe si të jetë vajza e turpëruar, dhe në mes tjerash thotë: - Që të jetë njeriu i turpëruar, ai në rend të parë duhet të dijë se çdo fjalë e çdo vepër, dhe në çdo gjendje, pa marrë parasysh fshehtazi apo haptazi, Allahu e sheh. Sepse, Allahu i di të gjitha çështjet tona.

**Emineja** thotë: - Po e nderuara mësuese, përpos që duhet ta dimë se Allahu na përcjell në çdo veprim, ne duhet të edukohemi sipas edukatës së Pejgamberit s.a.v.s. dhe të pasojmë Sunetin e tij, në fjalë dhe në vepër. Seadetja me habi thotë: - Mirëpo të tjerët thonë, se ajo, e cila është e turpshme, është me personalitet të dobët dhe humb meritën në mesin e njerëzve.

**Mësuesja:** - Ky botëkuptim është i gabuar, këto mendime nuk i takojnë besimtarëve, por janë mendime të mëkatarëve dhe kriminelëve, të cilët dëshirojnë të jetojnë të shfrenuar, të përzihen djem dhe vajza. A nuk është ashtu Emine?

**Emineja:** - Po, ashtu është. Ai, i cili lexon për gratë e ndershme e kupton këtë. Kur është pyetur Fatimja - bija e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. për atë se çka është me e vlefshme për femrën, është përgjigjur: *“Që të mos i shikojë meshkujt dhe mos ta shohin ata atë.”*

**Mësuesja:** - Ta dish oj Seadete se turpi ka vlerë të madhe, ndërsa imoraliteti është mëkat i madh. Nëse dëshiron të jesh me vlerë dhe e suksesshme bëhu e turpshme .

**Sahadetja:** - Cila është vlera e turpit?

**Mësuesja:** - Sqaroja ti oj Emine.

**Emineja:** - Ta dish oj Seadete se turpi është rrugë e imanit dhe cilësi prej cilësive, të cilat i do Zoti. Dhe ashtu siç e do Zoti njeriun e turpëruar, e shpie në Xhenet dhe do të jetë i kënaqur me të në Ditën e Kijametit.

**Mësuesja:** - Ndërsa imoraliteti dhe paturpësia kanë pasoja të paparashikuara. Për këtë arsye Pejgamberi s.a.v.s. na ka tërhequr vërejtjen dhe na ka ndaluar të jemi të pa turpëruara.

**Seadetja** tha: - Ju premtoj, mësuesja ime dhe shoqja Emine se, që nga sot, do të jem shëmbëlltyrë për turp dhe nuk do të flas me meshkuj pa nevojë, vetëm nëse është ë domosdoshme, dhe kur të flas do të flas me ndërgjegje.

## **LLOJET E TURPIT:**

Llojet e turpit janë:

Turpi i begative është falënderimi.

Turpi i profesionit është durimi.

Turpi i gjykimit është drejtësia.

Turpi i prindërve është sjellja e mirë ndaj tyre.

Turpi ndaj të dobëtëve është mëshira ndaj tyre.

Turpi i femrës është ruajtja e nderit të saj.

## **ÇKA PËRFITJMË NGA KY LIBËR**

Nga ky libër përfitojmë se:

- Edukata e Islamit është turpi.
- Muhamedi a.s i nxiste shokët vazhdimisht jenë të turpëruar.
- Grada më lart e turp-it është turpi ndaj Allahut.
- Në dituri nuk ka turp.
- Të urdhëruarit në punë të mira nuk është turp.
- Turpi është prej imani.
- Kush nuk turpërohet shkatërrohet.

## PËRFUNDIM

Të kujtojmë hadithin “*Turpi është prej Imanit*”. Ndërsa, kujtimi është për ata që kanë zemër, që përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën.

Ndoshta kjo çka është e shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe e dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

# **MORALI I MIRË**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

**17**



## MORALI

Morali është përmbledhja e rregullave mbi sjelljet e mira. Të jesh i moralshëm do të thotë t'i përmbahesh atyre rregullave dhe normave morale, ndërsa i pamoralshëm do të thotë t'i shkelësh ato rregulla.

Burimet e moralit Islam janë Kur'ani dhe Hadithi.

Dispozitat mbi moralin Islam ndahen në tri grupe:

1. Detyrat ndaj Allahut;
2. Detyrat ndaj njerëzve dhe krijesave;
3. Detyrat ndaj vetvetes.

Morali i mirë është shprehje që ka për qëllim rregullimin shpirtëror, i cili është i rrënjosur thellë në njeriun. Morali është shkenca e gjendjes shpirtërore të njeriut të karakterit të tij dhe të sjelljes së tij; është shkenca, e cila sqaron në çka mbështetet e mira dhe në çka mbështetet e keqja, me fjalë të tjera: Cilat vepra konsiderohen të mira, e cilat të këqija.

Morali i bukur do të peshojë rëndë në Ditën e Gjykimit. Ai që e ka moralin e bukur, e ka imanin e plotë. Ai që e ka moralin e bukur është fetar i vërtetë dhe musliman i mirë.

Shkelja e urdhrave të Allahut është shkelje e normave të moralit Islam. Të vepruarit e ndalesave të Allahut është shkelje e normave të moralit Islam dhe quhen mëkat.

Morali i keq është helm vdekjeprurës. Qëllimi i çdo ibadeti në Islam është pastrimi i moralit.

Prej Ademit a.s. e deri më sot, njëra prej çështjeve kryesore, me të cilat ballafaqohet lloji njeri është morali. Shumë popuj kanë dështuar, por edhe janë zhdukur, për shkak të moralit të keq, e jo për shkak të paditurisë apo varfërisë. Për këtë arsye të gjithë peygamberët e kanë pasur për detyrë edhe përsosjen e moralit.

Morali është sjellja e mirë, gjuha e ëmbël dhe veprimi i drejtë.

Vetëm me moral të lartë e fisnik mund t'i ndihmohet fesë, atdheut dhe popullit.

Morali i mirë, personalitetin e njeriut e ngritë lartë dhe e bën njeriun të përsosur.

Morali kërkon praktikën, kjo do të thotë se nuk duhet të jemi prej atyre që vetëm flasin, e asgjë nuk bëjnë.

Kur lind njeriu, lind i vogël dhe i dobët, e me kalimin e kohës, duke u ushqyer forcohet. Kështu është edhe me shpirtin, duke u ushqyer me dashuri, me bamirësi, durim, ndjeshmëri bëhet i fortë moralisht.

Në fund lusim Zotin e Lartmadhëruar të na përsosë moralisht dhe që ta kemi moralin e bukur.

## **MJETET E MORALIT**

Mjetet e moralit të mirë janë:

- Njohja e moralit të mirë dhe pasimi i tij;
- Njohja e moralit të keq dhe largimi prej tij;
- Burimi i moralit të mirë është Kur’ani dhe Hadithi;
- Besimi (imani) është bazë themelore e moralit;
- Kryerja e obligimeve ndaj Allahut bëjnë që të kesh moral të mirë;
- Largimi prej veseve të këqija;
- Shoqërimi me njerëz të mirë;
- Largimi prej vendtubimeve të këqija;
- Pranimi i këshillave të sinqerta;
- Jeta e Muhamedit a.s. të jetë shëmbëlltyrë e jetës tënde, sepse ai ka qenë Kur’ani, i cili ka ecuar nëpër tokë.

## MORALI NË KUR'AN

Zoti i Lartmadhëruar e ka dërguar Pejgamberin s.a.v.s. dhe ka thënë:

***“Vërtet ti (o Muhamed) je në shkallë të lartë të moralit.”***

Në ajetet e para të suretul Muëminun (Besimtarët) Zoti i Lartmadhëruar i përshkruan cilësitë që duhet t'i kenë besimtarët, e ato cilësi janë cilësi të moralit të bukur:

- “Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët,*
- të cilët janë të përrulur në namazin e tyre,*
  - të cilët shmangen nga fjalët (dhe veprat) e kota,*
  - të cilët e ruajnë nderin e tyre, përveçse me gratë e tyre ose me robëreshat e tyre, ata nuk janë të qortuar. E, kush kërkon (kënaqësi), përpos këtyre, të atillët me të vërtetë janë kalimtarë të kufijve. (Të shpëtuar janë) edhe ata që i ruajnë emanetet, dhe që kryejnë premtimet. Edhe ata që e ruajnë namazin e tyre. Ata janë trashëgimtarë të mëdhenj, të cilët do ta trashëgojnë (Xhenetin) Firdevsin. Ata do të jenë të përhershëm në të.”*

*(El-Muëminunë, 1-11)*

## MORALI NË HADITHË

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Në Ditën e Kijametit nuk ka asgjë që rëndon peshoren e punëve të mira më shumë se sa morali i mirë.”*

Muhamedi s.a.v.s. në hadithë, po ashtu, ka thënë:

*“Besimtarët, të cilët e kanë më të përsosur Imanin janë ata, të cilët e kanë moralin më të mirë.”*

Shkojnë disa njerëz te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e pyesin se cili njeri është më i dashur tek Allahu. Ai u përgjigjet: *“Njeriu që e ka moralin më të mirë.”*

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Më i dashuri dhe më i afërti tek unë në Ditën e Kijametit është ai, i cili e ka moralin më të mirë nga ju, ndërsa më i urryeri dhe më i largëti tek unë në Ditën e Kijametit është ai, i cili e ka moralin më të keq.”*

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Vërtet Allahu e ngritë moralin e mirë në gradën e agjëruesit të ditës dhe falësit të natës.”*

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Morali i mirë shkrinë mëkatet, ashtu siç e shkrinë borën dielli.”*

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Fatmirësia e birit të Ademit (njeriut) është morali i mirë, ndërsa fatkeqësia e birit të Ademit (njeriut) është morali i keq.”*

Ndërsa, Muhamedi s.a.v.s. për veten e tij ka thënë:

*“Vërtet jam dërguar të përsosi moralin.”*

## MORALI I MUHAMEDIT S.A.V.S.

Nëse tubohen të gjitha cilësitë e mira të moralit të të gjithë njerëzve, atëherë ato do t'i gjenim te Pejgamberi s.a.v.s.

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Më ka edukuar Zoti im, dhe e ka përsosur edukatën time. Kështu që Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:*

***“Nuk ka dyshim se ti je në shkallën më të lartë të moralit.”***

Pejgamberi s.a.v.s. ishte i matur, i durueshëm, i turpshëm, bujar, modest. E përkujtonte Allahun vazhdimisht, nuk merrej me gjëra të kota. I donte të mjerët, i vizitonte të sëmurët, i nderonte dhe nuk i poshtëronte të varfrit, dhe nuk i frikësohej asnjë mbreti për shkak të mbretërisë. Buzëqeshte dhe sillej mirë me të tjerët. E pranonte arsyen e të arsyetuarit.

Pejgamberi s.a.v.s. nuk zemërohej, nuk hakmerrej, nuk e ka përbuzur ushqimin asnjëherë, nuk ndalohej nga e lejuara.

Morali i tij ka qenë Kur'ani. Zemërohej kur zemërohej Kur'ani dhe kënaqej kur kënaqej Kur'ani.

## EDUKATA ME ALLAHUN

Allahu i Lartmadhëruar na ka krijuar, përpos kësaj të gjitha të mirat na i ka dhuruar. Nëse mundohemi t'i llogarisim të mirat që na ka dhënë Allahu, kurrë nuk do të mund t'i numëronim. Allahu na dëgjon, na sheh, e di atë që veprojmë haptazi dhe fshehurazi. Për këtë arsye çdo adhurim që e bëjmë duhet të jetë i pastër si loti dhe i bardhë si qumështi, dhe të bëhet vetëm për Allahun.

Ne kemi obligim që ta adhurojmë Allahun sinqerisht, ta falënderojmë, ta madhërojmë dhe të shpresojmë në mëshirën e Tij. Adhurimi në Allahun nuk duhet të ketë asnjë njollë. Allahun e Lartmadhëruar duhet ta falënderojmë, duhet ta dëgjojmë, duhet t'i nënshtrohemi urdhrave të Tij dhe të largohemi prej ndalesave të Tij.

Nëse e bëjmë ndonjë lëshim apo mëkat, duhet të pendohemi sinqerisht. Atij duhet t'i mbështetemi dhe shpresën vetëm te Ai duhet ta kemi. Atij duhet t'i frikësohemi. Prej Allahut duhet të turpërohemi që të mos bëjmë mëkat. Duhet ta fitojmë kënaqësinë e Tij, që të na mëshirojë dhe të na shpërblejë me Xhenet.

Në përgjithësi, kjo është edukata jonë ndaj Allahut të Lartmadhëruar.

Edukata me Allahun arrihet nëpërmjet tri gjërave:

**E para:** Ta ruash zemrën që të mos adhurojë dhe të mos i bindet askujt tjetër, përpos Allahut;

**E dyta:** Të mos veprosh gjëra që nuk i do Allahu

**E treta:** Të kesh mendime të mira për Allahun edhe nëse ndodh ndonjë fatkeqësi.

Nëse i ke këto tri cilësi, Allahu do të të dojë në Ditën e kiametit, por edhe në këtë botë do të të shpërblejë me të mira.

## EDUKATA ME TË DËRGUARIN E ALLAHUT

Muslimani beson se Muhamedi s.a.v.s. është Pejgamber i Zotit, të cilit i ka zbritur Kur’ani dhe është vula e të gjithë pejgamberëve.

Muslimani e do Muhamedin s.a.v.s. Muslimani i kryen urdhrat e Pejgamberit s.a.v.s. dhe nuk i kundërshton. Muslimani edukohet me moralin e Pejgamberit s.a.v.s. Atë e merr si shëmbëlltyrë në jetë, atë e merr shëmbëlltyrë se si duhet dashur Allahun, atë e merr shëmbëlltyrë se si duhet adhuruar Allahun.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur’an thotë:

***“Ju, pa dyshim se, Pejgamberin e Allahut e keni shembull të mrekullueshëm, për atë që i druan Allahut dhe Ditës së Kijametit dhe i cili e përmend shpesh Allahun.” (El-Ahzabë, 21)***

Kur Muslimani edukohet me edukatën e të Dërguarit s.a.v.s., e meriton shefaatin e tij dhe do të jetë së bashku me të në Xhenet.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Të gjithë pjesëtarët e mi do të hynë në Xhenet, përpos refuzuesve.” Kur e pyesin se kush janë refuzuesit. Pejgamberi s.a.v.s. është përgjigjur kështu: “Kush më dëgjon mua do të hyjë në Xhenet, e kush nuk më dëgjon mua, më ka refuzuar.” (Buhariu)*

## DETYRAT NDAJ ALLAHUT XH.SH.

Detyrat tona ndaj Allahut janë:

- Ta duam Allahun e Lartmadhëruar;
- Ta falënderojmë për begatitë që na ka dhënë;
- Që t'i bëjmë ibadet, ashtu siç na ka mësuar Pejgamberi s.a.v.s.;
- Të jemi të singertë në veprat tona dhe ta ndiejmë në shpirt se Allahu është Ai, i Cili na mjafton për gjithçka;
- Të turpërohem i ndaj Allahut, çdo herë kur mendojmë të bëjmë ndonjë mëkat: “Ai (Allahu), me të vërtetë, di çdo gjë që shprehni (apo veproni) haptazi dhe atë që e fshihni.” (El-Eala, 7);
- Të frikohemi nga ndëshkimi i Allahut: *“Me të vërtetë ndëshkimi i Zotit tënd është i ashpër.”* (El-Buruxhë, 12);
- Të kemi mendim të mirë ndaj Allahut dhe mos të humbim shpresën në mëshirën e Tij: *“Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetvetes, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut. Allahu, me të vërtetë, i falë të gjitha mëkatet, Ai me të vërtetë është Falës dhe Mëshirues.”* (Ez-Zumer, 53)
- Që t'i lutemi Allahut dhe të kemi shpresë në pranimin e lutjes sonë: *“Zoti i juaj ka thënë: Lutmëni Mua, Unë ju përgjigjem. Me të vërtetë ata që bëhen mendjemëdhenj e nuk duan të më adhurojnë do të hynë të poshtëruar në Xhehenem.”* (El-Muëminunë, 60)
- Që të kemi mbështetje të fortë në Allahun: *“E përse të mos mbështetemi në Allahun, kur Ai na ka treguar rrugën e drejtë në të cilën po ecim? Ne, me të vërtetë, do të durojmë në atë që na mundon ju, e ata që mbështeten, le të shpresojnë vetëm në Allahun.”* (Ibrahim, 12)
- Që të pendohemi, nëse bëjmë ndonjë mëkat.

## DETYRAT NDAJ TË DËRGUARIT TË ALLAHUT S.A.V.S.

Detyrat ndaj të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. janë:

1. Ta duam, ta nderojmë dhe t'i dërgojmë salavate çdo herë kur përmendet emri i tij. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë: ***“Nuk ka dyshim se Allahu mëshiron dhe melekët e Tij dërgojnë salavate për Pejgamberin. O ju besimtarë, dërgoni salavate për të dhe përshëndeteni me paqe dhe përkushtim të plotë.”*** (El-Ahzabë, 56)
2. Ta duam më shumë se veten dhe familjen tonë.
3. Të veprojmë sipas Sunetit dhe rrugës së tij.  
Zoti i Lartmadhëruar në Kuran thotë: ***“Thuaj(O Muhamed) nëse dëshironi ta doni Allahun më pasoni mua, e Allahu do të ju donë dhe do të ju falë gabimet”*** (Ali Imran, 31)
4. Ta mësojmë jetën e tij dhe jeta e tij të jetë mostër për jetën tonë.  
***“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun.”***  
(El-Ahzabë, 21)
5. T'i mësojmë dhe t'i ruajmë hadithet e tij.

## NËSE PRONARI NUK MË SHEH, ALLAHU MË SHEH

Një ditë prej ditëve Abdullah bin Omeri me shokët e tij dalin për t'u shëtitur në periferi të Medinës. Atë ditë bënte vapë e madhe. Ata ndalen nën një hije që të pushojnë dhe të hanë ushqim. Deri sa ishin ulur, aty pari kalon një bari dhe i përshëndet me selam. Ibn Omeri e fton që t'i bashkëngjitet në ushqim, mirëpo bariu i thotë se është agjërueshëm.

Ibni Omer habitet dhe e pyet: “Po përse po agjëron në këtë vapë të madhe?!”

Bariu i thotë: “Unë dëshiroj që në këtë botë të bëj sa më shumë punë të mira, që të më bëjnë dobi në botën tjetër.”

Ibni Omeri i thotë: “A po ma shet një dele?”

Bariu i thotë: “Po delet janë të pronarit tim.”

Ibni Omeri i thotë: “Thuaji pronarit se e ka ngrënë ujku.”

Bariu i thotë: “Kjo është në rregull, mund ta gënjejë pronarin tim, por Allahu më sheh, e si do të dalë atëherë para Tij në Ditën e Kijametit?”

Ibni Omeri u impresionua aq shumë nga fjala e bariut dhe filloi të qajë nga edukata e bariut ndaj Allahut. Kështu që shkon Ibni Omeri në Medinë, e takon pronarin e deleve, i blen prej tij delet dhe bariun, i cili ishte rob, pastaj bariun e liron për Allahun dhe të gjitha delet i jep dhuratë (sadaka për Allahun).

*(Bejhekiu)*

## MORALI DHE BESIMI

Në Islam, morali dhe besimi janë si dy bashkudhëtarë dhe se rënia e moralit tregon rënien e besimit, dhe anasjelltas - ngritja e moralit tregon forcimin e besimit.

Një ditë, përderisa Pejgamberi s.a.v.s. u tha shokëve:

*“Për Zotin nuk beson, për Zotin nuk beson, për Zotin nuk beson!”*  
*Kur e pyetën shokët: “Kush, o i Dërguar i Allahut?” Pejgamberi s.a.v.s. tha: “Ai që fqinjët e tij nuk ndihen të sigurt prej tij.”*

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Nuk ka besim ai, të cilit nuk i besohet; nuk ka islam ai, i cili nuk e mban premtimin.”*

Po ashtu Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Imani ka shtatëdhjetë e ca degë, e para prej tyre është dëshmia se nuk ka Zot tjetër, pos Allahut, dhe e fundit është largimi i pengesave nga rruga. Dhe turpi është pjesë e Imanit.”*

Siç shihet, të gjitha degët e imanit janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me moralin, që do të thotë se besimi i muslimanit e ngritë atë në shkallë të lartë të moralit.

## MORALI DHE DITURIA

Sikurse bimët kanë nevojë për ujë dhe nëse nuk ujiten thahen, ashtu edhe njeriu ka nevojë për moral, po nuk u edukua njeriu që në fëmijëri thahet moralisht dhe nuk mund t'i shihet asnjë fryt e dobi për njerëzimin.

Malik Ibn Enesi i ka thënë një djaloshi: “O vëllai im, mëso edukatën përpara se të mësosh dijen.”

Ruejm Ibn Ahmed El-Bagdadij ka thënë: “Puna e paktë, por me shumë edukatë është më e mirë sesa puna e shumë, por e pa shoqëruar me edukatë.”

El Bushengiju ka thënë: “ Kush dëshiron të marr dije pa marrë edukatë, ka kaluar në gënjeshtër ndaj Allahut dhe të Dërguarit të tij.”

Mevlana Xhelaludin Rumi ka thënë: “Njeriut të arsimuar, por të paedukuar, mendja i shërben siç i shërben hajdutit qiriu për t'i bërë dritë në kohën derisa vjedh.”

## MORALI DHE NAMAZI

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Fale namazin, vërtet namazi të largon nga të shëmtuarat dhe të këqijat.”***

*(El-Ankebutë, 45)*

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Një njeri, të cilin nuk e ndalon namazi nga veprat e liga, nuk ka namaz.”*

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Veç ka shpëtuar ai që pastrohet (moralisht dhe fizikisht) dhe që e përmend emrin e Zotit të vet dhe fal namaz.”***

*(El-Ea'la, 14-15)*

Në Hadithë Kudësij Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

*“Nuk ka dyshim se Unë e pranoj namazin prej atij që është modest ndaj Madhështisë Sime, që nuk i dëmton krijesat e mia, nuk është këmbëngulës në mëkate, që ndan kohë për të Më përkujtuar Mua dhe që mëshiron të varfrit.”*

Nga hadithi kuptohet se kushti i parë i pranimi të namazit është: përlulja dhe modestia. Pastaj, kushti i dytë: mosdëmtimi i krijesave. Kushti i tretë: përkujtimi i Allahut. Kushti i katërt: të ruajturit prej mëkateve. Kushti i pestë: mëshira ndaj të varfërve.

Dihet se njeriu gabon me sy duke shikuar haram; me veshë duke dëgjuar fshehtësitë e muslimanëve; me gjuhë duke përgojuar, nënçmuar dhe ofenduar të tjerët; me zemër duke i urreyer të tjerët; gabon me barkun e tij duke u ushqyer me vjedhje, kamatë dhe korrupsion. Ndërsa, namazi është obliguar për t'u larguar nga të gjitha këto gabime, e largimi prej këtyre gabimeve e përsos njeriun moralisht. Kështu mund të vijmë në përfundim se kushtet e namazit janë si vijojnë:

Kushti i parë: Edukativ;

Kushti i dytë: Shoqëror;

Kushti i tretë: Shpirtëror;

Kushti i katërt: I besimit, dhe

Kushti i pestë: I humanizmit.

Nëse ti falesh dhe nuk ke edukatë, nuk sillesh mirë me njerëzit dhe nuk je i mëshirshëm, është sikur nuk je falur fare.

## MORALI DHE ZEKATI

Zekati është shtyllë e Islamit. Zekat do të thotë shtim i pasurisë, pastrim i shpirtit dhe përsosje e moralit. Zoti i Lartmadhëruar në librin e tij fisnik ka thënë:

***“Merr nga pasuria e tyre zekatin (sadikanë), e cila i pastron (pasurinë e tyre) dhe i pastron ata (shpirtërisht dhe i përsos moralisht).”***

Zoti i Lartmadhëruar ka ndërlidhur ibadeitn (shtyllat e Islamit) me moralin. Adhurimi dhe morali janë pjesë të pandara në mes vete. Duke dhënë zekat dhe sadaka mëshirohen të varfrit, formohet bujaria dhe fisnikëria, dhe hiqet mendjemadhësia prej njerëzve.

Muhamedi a.s. na ka treguar se sadakaja nuk jepet vetëm me pasuri, por edhe me virtyte të moralit. Ja çka thotë Pejgamberi s.a.v.s.:

***“Buzëqeshja jote ndaj vëllait është sadaka, të urdhërosh në punë të mira dhe të largosh nga të këqijat është sadaka, të mbushësh enën (me ushqim) e vëllait nga ena jote është sadaka, të ndihmosh një njeri të verbër është sadaka, dhe sadakaja më e madhe është kafshata që vendos në gojën e bashkëshortes tënde.”***

Në islam zekati dhe sadakaja, përpos që është me të holla, ajo jepet edhe me sadaka morali.”

## MORALI DHE AGJËRIMI

Shtylla e tretë prej shtyllave të Islamit është agjërimi.

Agjërimi e përsos moralin. Njeriu gjatë tërë ditës nuk i afrohet ushqimit dhe pijes vetëm nga frika prej Zotit dhe për t'iu afruar Zotit. Kjo është një stërvitje për durim dhe qëndresë. Kjo është fuqi shpirtërore, që i mund epshet personale. Muaji i ramazanit është muaji, i cili i tubon muslimanët në një gjendje shpirtërore, pastërtie e besimi, dashurinë për zbatimin e urdhrave të Allahut, për veprimin e punëve të mira dhe përhapjen e moralit të mirë.

Zoti Lartmadhëruar në Kuran ka thënë: *“O ju te cilët keni besuar ju është be obligim agjërimi juve ashtu siç iu është bërë obligim atyre para jush që te jeni të devotshëm”*. (El-Bekare, 183)

Pra qëllimi i agjerimit është pastërtia devotshmëria dhe përsosja e moralit. Për këtë arsye Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Agjëruesi nuk bën të urrejë dhe të fyejë. E nëse dikush e ofendon atë, le të thotë: “Unë jam duke agjëruar.”*

*(Muslimi dhe Ibni Maxhe)*

*“O i Dërguar i Allahut, filanja agjëron ditën dhe falet natën, mirëpo ajo ka moral të keq: i ofendon, i shan dhe i nënçmon fqinjët e saj me gjuhë.” I Dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë:*

*“Nuk ka dobi në të, ajo është prej banorëve të Xhehenemit.”*

## MORALI DHE HAXHI

Shehadeti pastron gjuhën dhe zemrën e njeriut; namazi përsos moralin; zekati pastron pasurinë dhe ngritë vetëdijen e njeriut në shkallë të lartë, që të jetë i mëshirshëm ndaj të tjerëve; agjërimi, gjithashtu, përsos moralin, ndërsa morali i besimtarit e arrin kulmin kur ai e kryen haxhin.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

***“Haxhi është në muajt e caktuar, e kush e kryen haxhin në këta muaj, nuk duhet afruar gruas, nuk bën të mëkatojë, e as të polemizojë e të shkaktojë grindje gjatë haxhit.”***

*(El-Bekare, 197)*

Pejgamberi s.a.v.s. në hadithë thotë:

*“Kush e kryen haxhin, duke u larguar nga fjalët e kota dhe grindjet, kthehet në shtëpi (i pastër prej gabimeve) si në ditën që e ka lindur nëna.”*

## EDUKATA NË RRUGË

***“E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: “Paqe!”***

*(Furkan, 63)*

Llukmani a.s. e ka këshilluar birin e tij kështu:

***“O biri im, nëse ajo (vepra që e bën) është e rëndë qoftë sa një kokërr e vogël hardeli (bimë), e ajo vepër të jetë në shkëmb ose në qiej ose në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh atë. Me të vërtetë Allahu është i butë dhe njohës.”***

*(Lukman, 16)*

Edukata në rrugë është që të largosh mbeturinat nga rruga, ashtu siç është edhe të mos i hedhësh mbeturinat në rrugë.

I Dashuri ynë, Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

***“... E para degë është dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij. Kurse e fundit është heqja e mbeturinave nga rruga...”***

## **ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR**

Nga ky libër përfitojmë se:

- Morali i mirë do të peshojë rëndë në Ditën e Kijametit;
- Shkelja e normave të moralit është shkelje e urdhrave të Allahut;
- Çdo ibadet në Islam ka për qëllim pastrimin e moralit;
- Duhet t'i kryejmë detyrat ndaj Allahut, ndaj të Dërguarit të Tij dhe ndaj vetvetes;
- Allahu përcejell çdo veprim që e bëjmë;
- Përsosmëria e imanit varet prej përsosmërisë së moralit.

## PËRFUNDIM

Të kujtojmë hadithin, në të cilin Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Në Ditën e Kijametit nuk ka asgjë që rëndon peshoren e punëve të mira më shumë se sa morali i mirë.”*

Ndërsa, kujtimi është për ata që kanë zemër, që përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën.

Ndoshta kjo çka është e shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe e dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

# **DURIMI DHE FALËNDERIMI**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

**18**



## DURIMI

Durimi sjell qetësi në zemër dhe fortësi në shpirt. Durimi është pjesë e imanit, zbukurim i njeriut, rrugë e fisnikërisë. Durimi është shumë i rëndësishëm në jetën e muslimanit.

Durim do të thotë “pengim”; të pengosh veten nga hidhërimi i tepërt, të pengosh veten nga gjërat e ulëta.

Durimi është i domosdoshëm, si në jetën individuale, ashtu edhe në atë shoqërore. Çdo vlerë që e fiton njeriu e fiton prej durimit, çdo përbuzje që e meriton ajo është për shkak të mosdurimit të tij. E kundërta e durimit është dëshpërimi.

Prej cilësive të Zotit është cilësia “Durimtar”. Në Kuran *durimi* është përmendur më shumë se çdo kund tjetër. Muhamedi s.a.v.s për durimin ka thënë: “*Durimi është gjysma e imanit*”

Për këtë arsye, të gjithë pejgamberët kanë qenë durimtarë, e në krye të durimtareve ka qenë Pejgamberi s.a.v.s., të cilit Zoti i Madhëruar i ka thënë:

***“Ti (Muhammed) duro, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur dhe mos kërko ngutjen e dënimit për ta ...”.***

*(El-Ahkaf, 35)*

Rrugën e Pejgamberit s.a.v.s. e kanë vazhduar halifët e drejtë dhe shokët fisnik të Muhamedit s.a.v.s, të njëjtën rrugë duhet ta vazhdojmë edhe ne.

Durimi është arma e nxënësit për të arritur suksesin e shkëlqyer në shkollë.

Durimi është përkrahësi i tregtarit për të fituar në tregti. Durimi është mjeti i bujkut për të korrë frytet e bujqësisë. Durimi është mjeti i industrialit për të prodhuar makineri.

Durimi prej epshit është devotshmëri, durimi në luftë është trimëri, durimi prej të padrejtëve është urtësi, durimi i mbajtjes së sekretit është besnikëri.

Besimi i ngjan një trupi, ndërsa koka e atij trupi është durimi, dijetarët thonë se durimi është gjyma e imanit. Kjo, nga shkaku se adhurimi ndaj Allahut është dy llojesh:

- Adhurimi i fshehtë, e kjo është që kur Allahu na jep të mira, ne falënderojmë dhe
- Adhurimi jo i fshehtë, kur Zoti na sprovon e ne durojmë.

Besimi është veprimi i punëve të mira dhe largimi nga punët e këqija, po ashtu edhe durimi është veprimi i punëve të mira dhe largimi nga të këqijat. Jeta jonë përbehet prej mirësive dhe fatkeqësive. Për mirësi falënderojmë Zotin, ndërsa për fatkeqësi durojmë. Për këtë arsye Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Është interesant çështja e besimtarit. Çdo gjë është në të mirë të tij dhe kjo nuk është për askënd tjetër, përpos për besimtarin. Nëse e godet ndonjë fatkeqësi, duron, e kjo është mirë për të; e nëse i jepet një mirësi, ai falënderon dhe po ashtu edhe kjo është mirë për të.”*

Prej durimit ka dobi të shumta, si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Prej tyre, se Zoti është me durimtarët. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“O ju që keni besuar, kërkon ndihmë me durim e me të falur, se vërtet All-llahu është me durimtarët.”***

*(El-Bekare, 153)*

Durimi është tri llojesh:

1. Durimi në dëgjueshmëri ndaj urdhrave të Allahut;
2. Durimi në largim prej mëkateve;
3. Durimi në sprovat prej Allahut.

Që të tri llojet e durimit kanë qenë të Jusufi a.s.

## DURIMI NE KUR'AN

Allahu është me durimtarët.

***“Dhe respektojeni All-llahun e të dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete, e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake). Të jeni të durueshëm se All-llahu është me të durueshmit.”***

*(Enfal, 46)*

Allahu i do durimtarët.

***“E sa pejgamberë pati që së bashku me të luftuan turma të mëdha besimtarësh dhe për atë që i goditi në rrugën e All-llahut, ata nuk u dobësuan dhe as nuk u përulën. All-llahu i do durimtarët.”***

*(Ali Imran, 146)*

Besimtari nuk është në humbje përderisa këshillon për të drejtën dhe për durimin.

***Pasha kohën!***

***Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt.***

***Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.***

*(El-Asr, 1-3)*

Për durim Zoti i Lartmadhëruar shpërblen pa masë:

***Thuaj: “O robërit e Mi që keni besuar, kini frikë ndaj Zotit tuaj. Ata që bënë mirë në këtë jetë, kanë të mirë të madhe, e Toka e All-llahut është e gjerë, ndërsa të durueshmive u jepet shpërblimi i tyre pa masë!”***

*(Zumer, 10)*

## DURIMI NË SUNET

Nga Ebu Jahja Suhejb Ibn Sinan r.a. është transmetuar se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Çështja e besimtarit është e çuditshme; çdo gjë për të është e çuditshme dhe askush tjetër nuk e ka këtë mirësi, përpos besimtarit. Nëse i vjen ndonjë lehtësim dhe gëzim, ai falënderon (Allahun), e kjo i sjellë dobi, por edhe nëse e godet ndonjë e keqe, duron, dhe prapë ka dobi.”*

*(Muslimi)*

Transmetohet nga Eneri r.a. se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Allahu xh.sh. thotë: “Nëse robin tim e sprovtoj me dy të dashurit e tij (humbjen e syve) dhe ai bën durim, do t’ia kompensoj me Xhenet.”*

*(Buhariu)*

## DURIMI I EJUBIT A.S.

Ejubi a.s. ka qenë peygamber. Cilësi e veçantë e tij ka qene durimi. Për këtë arsye edhe Zoti i Madhëruar e ka lavdëruar ku thotë:

***“Me të vërtet ne e gjetëm atë shumë te durueshëm. Sa rob i mirë ishte ai.”***

Ja si ka qene biografia e Ejubit a.s.

Ne fillim te jetës se tij, Ejubi kishe fëmijë shëndet dhe pasuri. Pas tetëdhjetë vitesh sëmuret me një lloj sëmundjeje të rrezikshme, ashtu që mishi në trup i kalbej dhe i binte. Nga frika se mos është sëmundje ngjitëse, iu larguan te gjithë njerëzit, përpos gruas se tij. Pas tetëmbëdhjetë vjetësh, gruaja thotë: “Përse nuk e lute Zotin qe të të shërojë?”. Ejubi a.s. i thotë: *“Jetuam tetëdhjetë vjet me të mirat e Zotit, do të bëhem i durueshëm tetëdhjetë vjet në sëmundje.”* Kur kaluan tetëdhjetë vjet në gjendje të vështirë ekonomike, pa fëmijë, i sëmur, Ejubi a.s. e lut Zotin:

***“O Zoti im me ka kapluar gjendja jashtëzakonisht e vështirë, por prapë se prapë Ti je me Mëshiruesi i Mëshiruesve.***

*(El-Enbija, 83)*

Atëherë Zoti ia pranon lutjen, e shëron, ia kthen pasurin dhe i dhuron 28 fëmijë tjerë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Ne iu përgjigjëm atij nga mëshira Jonë, ia hoqëm ato vështirësi që i kishte, i dhamë familjen e tij dhe aq sa ishin ata, dhe e bëmë përkujtim për të devotshmit.”***

*(El-Enbija, 84)*

## DURIMI I TË VARFËRVE

Muslimanët kanë emigruar prej Mekës në Medine. Ata janë detyruar t'i lëshojnë shtëpitë e tyre dhe ta lënë pasurin e tyre. Migrimi i tyre nuk ka qene për të fituar pasuri, por për shkak se kanë qene besimtarë, e kanë dashur Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Disa prej këtyre muhaxhirëve kanë qenë të dobët dhe nuk kanë mundur të punojnë. Ata nuk kanë pasur shtëpi banimi as vendstrehim. Për këtë arsye ata flinin në xhaminë e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. me të varfrit muslimanë. E përballonin urinë dhe angazhoheshin në adhurim ndaj Allahut të Lartmadhëruar. I Dërguari i Allahut urdhëronte që vazhdimisht të qëndrohej pranë tyre dhe të mos i linin të vetmuar.

Një ditë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. hyri në xhami dhe i gjeti aty të varfrit muslimanë, deri sa njëri prej tyre lexonte apo këndonte Kur'an, ndërsa të tjerët e dëgjonin. Kur u afrua pranë tyre, lexuesi i Kur'anit e ndali leximin. I Dërguari i Allahut s.a.v.s i pyeti: *“Çka jeni duke bërë?”* Ata iu përgjigjën: *“O Dërguar i Allahut, ky këndonte Kur'an, ndërsa ne e dëgjonim.”*

Pejgamberi s.a.v.s. tha: *“Falënderoj Allahun që më ka bërë prej një populli që duroj së bashku me ta.”* Pastaj u ul pranë tyre dhe u tha: *“Ju përgëzoj, o ju të varfër, për dritën e përsosur në Ditën e Kijametit. Ju do te hyni ne xhenet para pasanikëve për gjysme dite, e kjo do të thotë 500 vjet.”*

## DURIMTARËT SHKOJNË NË XHENET PA DHËNË LLOGARI

Transmetohet se kur Zoti i Lartmadhëruar i tubon njerëzit për të dhënë llogari në Ditën e Kijametit, thërret një thirrës dhe thotë: “Ku janë durimtarët, ata do të hyjnë në xhenet pa dhënë llogari.”

Një pjesë e turmës së njerëzve paraqitet, ata i takojnë melekët dhe u thonë: - O bijtë e Ademit, po ku po shkoni?!

- Ata përgjigjen: - Ne xhenet.

Melekët thonë: - Po ende nuk keni dhënë llogari?

Ata përgjigjen: - Po.

- Melekët pyesin: - Po kush jeni ju?

Ata përgjigjen: Ne jemi durimtarët. Melekët i pyesin: - Po në çka keni duruar? Ata përgjigjen: - Kemi duruar për të kryer urdhrat e Allahut dhe kemi duruar që të mos biem në mëkate.

Melekët thonë: - Ju jeni ata, për të cilët është thënë: *“Hyni në xhenet, se nuk ka shpërblim më të mirë për vepruesit e tillë.”*

Këtë e argumenton ajeti kur'anor:

***“Vërtetë durimtarët kanë për t’u shpërblyer pa llogari.”***

## DURIMI DHE FALËNDERIMI

Transmeton Ebu Dardai r.a se e ka dëgjuar Ebu Kasimin (Muhamedin s.a.v.s) duke thënë:

“Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë Isa a.s.:

- *O Isa, pas teje do të dërgoj një popull, i cili nëse u ndodh çka dëshirojnë e falënderojnë Allahun, e nëse u ndodh çka nuk e dëshirojnë bëhen të qëndrueshëm dhe durojnë edhe pse nuk kanë dije e urtësi.*

Isa a.s. pyet: - O Zoti im, po si mund të jetë kjo?

Zoti thotë: - *Do t'i pajisi me butësinë dhe diturinë Time (e ata do të durojnë).*”

Në një rast Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“*Kush ka të mira e falënderon, sprovohet e duron, i behet padrejtësi e falë, bën padrejtësi, por menjëherë pendohet; dhe pas kësaj ka heshtur.*” I kanë thënë sahabët: “Po kush janë ata o i Dërguari i Allahut dhe çka do të kenë ata!” Ka thënë: “*Ata janë të udhëzuar të sigurvear dhe të lumtur.*”

Suhejb Rumiju r.a. transmeton hadithin e Muhamedit s.a.v.s.:

“*Është interesant jeta e besimtarit. Tërë jeta e tij është e dobishme. Këtë nuk mund ta ketë askush, pos besimtarit. Nëse i jepen të mirat falënderon, e kjo është e dobishme për të. Nëse e kaplon fatkeqësia duron, e kjo është prapë e dobishme për të.*”

(Transmeton Muslimi)

## **URVET BIN ZUBEJRI, BABA I DURIMTARËVE**

Një djalë ishte hipur mbi një kalë, dhe kali i bie në trup e ai vdes. Kur i vjen lajmi thotë: “O Zoti im, përderisa i kisha dy këmbë e dy duar, të cilat bëjnë katër, - një këmbë ma ke marrë, ndërsa m’i ke lënë tri pjesët tjera, për këtë te falënderoj. Po ashtu i kisha katër fëmijë, - një fëmijë ma ke marrë, ndërsa m’i ke lënë tre, për këtë të falënderoj.

Urvetes i ka ndodhur fatkeqësia në trup dhe ka duruar, në fëmijë dhe ka duruar. Por, mos të harrojmë se për durimtarët Zoti i Madhëruar ka thënë:

“Për ata është lutja e Allahut mbi ta dhe mëshira e Tij. Ata janë të udhëzuarit.”

Pra, për durim fiton lutjen e Allahut, mëshirën e Allahut dhe udhëzimin prej Allahut.

## NËNA DURIMTARE

Ishin bërë të gjithë përgatitjet për betejën e Kadisijes. Një nënë besimtare e urtë, durimtare, i kishte katër fëmijët. Kjo nënë quhej Hunesa bint Amr. I thërret fëmijët e saj dhe u thotë:

*“O fëmijët e mi! Ju e keni pranuar islamin me dëshirë dhe me vullnet. Ju dhe hixhretin e keni bërë me dëshirë dhe me vullnet. Për Zotin Një që përpos tij nuk ka Zot tjetër, ju jeni të një nëne dhe të një babe, e kam ruajtur fisin e juaj, nderin e familjes. Ju e dini se çka ka përgatitur Allahu në botën tjetër. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:*

***“O ju besimtarë, duroni dhe bëhuni të durueshëm, përforcohuni mes vete dhe frikësojuni vetëm Allahut, ndoshta do te shpëtoni.”***

Fëmijët e dëgjuan këshillën e nënës së tyre dhe shkuan në betejë dhe secili shpresonte të bie dëshmor në rrugën e Allahut. Luftuan me trimëri dhe që të gjithë ranë dëshmor.

Kur nena Hunesa dëgjoji për vrasjen e fëmijëve të saj tha: *“Falënderoj Allahun që më ka graduar me dëshmorinë e bijve të mi. Shpresoj se Zoti im i ka bashkuar dhe i ka pranuar me mëshirën e tij.”*

## DURO DHE LLOGARIT

Zejd ibn Erkam ka qenë njëri prej shokëve të Muhamedit s.a.v.s. Si çdo shok që viziton shokun e tij të sëmure, ashtu edhe i dashuri ynë, Pejgamberi s.a.v.s. shkon ta vizitojë Zejdin. Kur shkon në vizitë, mes tjerash, i thotë: - *Do të shërohesh, se nuk qenke i sëmure rëndë. Por, si do të qëndrosh përball sëmundjes, nëse jeton pas meje dhe verbërohesh?* Zejdi i thotë: - *Do të duroj dhe do të llogaris për shpërblim për shkak të asaj sëmundjeje.* Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: - *Atëherë do te hysh ne xhenet pa dhënë llogari.*

Pas vdekjes së Pejgamberit s.a.v.s. vërtet Zejdi u verbua, mirëpo ka duruar dhe ka llogaritur në shpërblim, dhe pas një kohe Allahu e shëron, pra ia rikthen shikimin.

Kështu Zoti i Lartmadhëruar ata, të cilët i frikohen atij dhe durojnë, i përfshin me mëshirën e Tij edhe në këtë botë edhe ne botën tjetër.

Zoti I Lartmadhëruar ne Kur'an thotë:

***“Dhe vërtet, ai, i cili është i devotshëm dhe duron, gjithsesi Allahu nuk ia hup shpërblimin punëmirëve.”***

Po ashtu thotë:

***“Dhe në çoftë se ju duroni ajo është më e mirë për durimtarët. Duro dhe durimi yt të jetë vetëm për Allahun.”***

## DURIMI DHE URTËSIA

Ebi Talha ka qenë njëri nga sababët e Muhamedit s.a.v.s., prej ensarëve. Gruaja e tij ka qene Umi Selim r.a. Ata kishin një fëmijë.

Një ditë prej ditësh fëmija i vogël i tyre sëmuret. Por, deri sa Talha ishte jashtë shtëpisë, fëmija vdes, ndërsa gruaja e tij, Umi Selim e përgatit dhe nuk e lajmëron askënd.

Në mbrëmje, kur kthehet Ebu Talha në shtëpi e pyet gruan e tij se si është djali. Gruaja i thotë: - Ka heshtur dhe është qetësuar. Pastaj Ebu Talha dhe Umi Selimi e kalojnë natën ashtu si është më së miri.

Të nesërmen, në mëngjes, Umi Selimi i thotë Ebu Talhas: - Çfarë thua, sikur ndonjë njeri të kishte dhënë diçka në huazim, e pastaj e kërkon atë send, a do t'ia kishe dhënë, apo jo? I thotë: - Po do t'ia kisha dhënë, sepse sendi i huazuar kthehet te huadhënësi. Umi Selim i thotë: - Kështu është puna edhe me fëmijën tënd, llogarite edhe fëmijën tënd ashtu.

Ebu Talha shkon te Pejgamberi s.a.v.s. dhe ia tregon ngjarjen. Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: - *Ndoshta Allahu do t'ju bekojë me fëmijë tjetër.* Dhe kjo lutje e Pejgamberit s.a.v.s. u pranua, kështu që Umi Selimi lindi një fëmijë tjetër. Pejgamberi s.a.v.s. shkoi te fëmija dhe ëmbëlsirën e hurmës ia shijoi fëmijës në gojë, e pagëzoi *Abdullah* dhe u lut që Allahu i Lartmadhëruar ta bekojë. Nga ky fëmijë kanë lindur edhe nëntë fëmijë të tjerë dhe që të gjithë janë bërë dijetarë dhe hafiza të Kur'anit.

## NË TRONDITJEN E PARË

Muhamedi s.a.v.s. i vizitonte varret dhe i këshillonte shokët e tij t'i vizitojnë. Po ashtu ua mësonte rregullat e vizitës së varreve. Kur shkonte në varreza thoshte:

“ES-SELAMU ALEJKUM EJJUHED DIJAR MINEL MUËMININE VEL MUSLIMINE, VE IN-NA IN SHA ALLAHU BIKUM LAHIKUN, NES ELULLAHE LENA VE LEKUM AFIJE.”

Ne gjuhën shqipe do të thotë:

*“Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ju, o ju shtëpi të besimtarëve dhe muslimanëve. Nëse do Allahu edhe ne do të vijmë këtu pas jush, por lusim Allahun që të na falë edhe ne, edhe ju.”*

*(Muslimi)*

Një ditë duke kaluar pranë varreve e sheh një grua duke qarë me zë të lartë, i afrohet Pejgamberi s.a.v.s. dhe i thotë:

*- Kujdes dhe frikësoju Zotit, bëhu e devotshme dhe bëhu durimtare.*

Gruaja nuk e njihte Pejgamberin s.a.v.s. dhe i thotë: - Largohu nga unë, sepse ty nuk të ka ndodhur ajo çka me ka ndodhur mua! Pejgamberi s.a.v.s. me hapa të lehtë dhe i qetë largohet prej saj.

Shkojnë të tjerët dhe i thonë se ai ishte Pejgamberi s.a.v.s.

Gruaja me të shpejtë shkon te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i kërkon falje për sjelljen e saj dhe i thotë se nuk të kam njohur.

Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

*- Durimi duhet të jetë që nga tronditja (goditja) e parë.*

*(Mutefekun Alejhi)*

## DURIMI DHE MËSHIRA

I dashuri ynë, Pejgamberi s.a.v.s. i ka dashur shumë fëmijët. Muhamedi s.a.v.s. i ka pasur 7 fëmijë: tre djem e katër vajza. Djemtë e Muhamedit s.a.v.s. kanë qenë: Kasimi, Tahiri dhe Ibrahim, ndërsa vajzat e Pejgamberit s.a.v.s. kanë qene: Fatimeja, Zejnebeja, Umi Kulthumi dhe Rukija.

Një ditë Muhamedi s.a.v.s. me shokët e tij hyjnë në shtëpi dhe e sheh se djali i tij dy vjeçar, Ibrahim kishte vdekur. Muhamedi s.a.v.s. i pikojnë lotët. Sahabët menduan se Muhamedi s.a.v.s. nuk është duke mundur të durojë dhe Abdurrahman bin Aufi i thotë: Edhe ti o i Dërguar, nuk po mund të durosh?! Pejgamberi s.a.v.s. i tregon:

*- O Abdurrahman, vërtet kjo është mëshira për të, vërtet syri po loton, zemra po pikëllohet, por ne nuk themi asgjë tjetër, pos asaj me çka është i pajtuar dhe i kënaqur Zoti ynë. Vërtet me ndarjen tende o Ibrahim jemi te pikëlluar.*

Një vajzë e Pejgamberit s.a.v.s. i dërgon lajmin Pejgamberit s.a.v.s. se fëmija i saj kishte vdekur. Muhamedi s.a.v.s. i dërgon selam dhe i thotë: Vërtet Allahu e ka dhënë (atë fëmijë) dhe ai e ka marrë, dhe çdo gjë e ka të caktuar vdekjen në momentin definitiv, ndërsa ti duro dhe llogarit për shpërblim.

Vajza e Pejgamberit s.a.v.s. ka duruar për vdekjen e fëmijës së saj deri sa Pejgamberi s.a.v.s. ka shkuar me shokët e tij Muadh bin Xhebelin, Ubeje bin Keabin, Zejd Ibn Thabitin në shtëpinë e saj. Kur ka hyrë Pejgamberi s.a.v.s. dhe e ka parë fëmijën e vdekur ka qarë, i janë mbushur sytë me lot. Seadi i thotë: - O i Dërguar i Allahut, ç'është kjo me ty? Ndërsa Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: - Kjo është mëshira, të cilën e ka vendosur Allahu në zemrat e robërve të Tij. Nuk ka dyshim se Zoti i Lartmadhëruar i mëshiron mëshiruesit dhe ata që janë të mëshirshëm.

Thuhet se Isaut a.s. i ka thënë Allahu: - Pas teje do të dërgoj një popull nëse u ndodhe ndonjë e mirë falënderojnë Allahun; nëse u ndodh diçka çka nuk e dëshirojnë, durojnë, këtë e bëjnë, sepse u jap atyre urtësi dhe dituri.

## SI TË BËHEMI DURIMTARË

Një haxhi me emrin Muhamed një ditë hyri në xhami, aty sheh një njeri të mërzhitur, i afrohet, kur e sheh se vetullat iu kishin lëshuar teposhtë, thuaja se mërzhitë e të gjithë botës kishin rënë në kokën e tij.

I thotë: - *Çfarë ke, pse je kaq i pikëlluar?* Njeriu i thotë: - Largohu, se ti nuk i ke hallet e mija! Ah, sikur të kisha vdekur dhe të isha liruar nga vështirësitë dhe barra e kësaj jete!

Haxhiu Muhamed thotë: - *Mos e kërko vdekjen. Po a nuk e ke dëgjuar hadithin e Muhamedit s.a.v.s. ku thotë:*

*“Askush mos ta kërkojë vdekjen, për shkak të ndonjë fatkeqësie që e godet. Po nëse është patjetër të veprojë diçka, le të thotë: “O Zoti ime ma bën jetën, e cila do të jetë një jetë e lumtur dhe e dobishme për mua, dhe ma bën vdekjen, e cila është e dobishme për mua.”*

*(Mutefukun Alejhi)*

Djaloshi i thotë: - Po ta dije çfarë tragjedie më ka ndodhur, do ta arsyetoje dhe do të pajtoheshe me atë që them unë. Haxhiu Muhamed thotë: - Po cila është ajo tragjedi? Djaloshi i thotë: - Ne shtëpinë time ka shpërthyer ambumba e gazit natyror dhe e ka djeg nënën dhe bashkëshorten time, dhe që të dyja tani janë në spital, kështu që nuk kanë mjete financiare për mjekimin e tyre, andaj më duhet të kërkoj lëmoshë prej të tjerëve. Ne atë moment i mbushen sytë me lot dhe filloi të qajë. Haxhiu Muhamed e rroki për krahu dhe i thotë: - Behu i durueshëm, nëse do Allahu, duke duruar do të tejkalosh të gjitha vështirësitë. Djaloshi i thotë: - Më është shterur durimi im, tani jam duarthatë. Haxhiu Muhamed i thotë: - O djalosh, ti ke shëmbëlltyrën më të mirë Ejubin a.s. dhe shumë e shumë durimtarë para teje, që me durimin e tyre i kanë përballuar shumë vështirësi dhe në fund kanë dalë fitimtarë. Eja që së bashku të shkojmë në spital. Pastaj shkojnë së bashku në spital. Kur arrijnë atje shohin se mjeket sa kishin kryer mjekimin. Haxhiu shkon tek arkëtari, kur sheh se atij i kishin bërë një zbritje te madhe nga shuma e paraparë. Haxhiu Muhamed ulet përballë djaloshit dhe i thotë: - A e sheh se si Zoti ta ka lehtësuar brengën? Djaloshi i thotë: - Zoti të shpërbleftë ty dhe mjekët për këtë mirësi. E falënderoj Allahun Zotin e të gjithë botëve. Haxhiu Muhamed i thotë: - O djali im, po durimi është shkalla e parë e imanit, patjetër duhet të jesh durimtar gjithmonë. Kur të ndodhë diçka e padurueshme, kujtoje Allahun, se ndoshta Allahu ta dëshiron të mirën. Kujt ia dëshiron Zoti të mirën, atëherë e sprovon. Djaloshi i thotë:

- Dëshiroj të bëhem gjithmonë i durueshëm. Po cilat janë çështjet, të cilat më ndihmojnë për këtë. Haxhiu Muhamed i thotë: - Çështja e parë, e cila të ndihmon për durim është që të kesh bindje të thellë se çdo gjë që ndodh, ndodh me dijen e Allahut, dhe ajo çka të ka ndodhur, nuk ka mund të dështojë, dhe çka të dështojë nuk ka mund të ndodhë. Pastaj duhet të jesh i përgatitur që durimi duhet të jetë në tronditjen e parë. Djaloshi i thotë: - Në tronditjen e parë, po si?!

Haxhiu i thotë: Po, në tronditjen e parë. Ka ndodhur që Pejgamberi s.a.v.s. ka shkuar pranë varrezave dhe aty sheh një grua duke qarë. I thotë: “Frikësoju Allahut dhe duro.” Ajo i thotë: - Hiqmëni sysh, sepse ty nuk të ka ndodhur ajo që më ka ndodhur mua. Pejgamberi s.a.v.s. largohet, mirëpo gruaja nuk e njihte. Njerëzit i thanë gruas: - Po, ai ishte Pejgamberi s.a.v.s. Ajo shpejtoi dhe shkoi te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i kërkon falje, duke ë thënë se nuk të kam njohur. Muhamedi s.a.v.s. i thotë: *“Durimi është qe nga tronditja e parë.”*

Djaloshi i thotë: - Kështu ndodhi në xhami me mua, kur më ke pyetur. Haxhiu i thotë: - Po. Për këtë arsye po të tregoj këtë hadith, që të mësoh si të bëhesh i durueshëm në rastet e vështira.

Djaloshi i thotë: Po tjetër, çfarë ndihmon për durim? Haxhiu i thotë: - Duke pasur heronjtë durimtarë, posaçërisht si kanë duruar Pejgamberët e Zotit.

## DIJETARI DHE LUANI NË BURG

Ibn Tulun është njëri prej udhëheqësve të Egjiptit të sotëm. Ai ishte udhëheqës i padrejtë që do të thotë i bënte padrejtësi popullit të tij. Njëri prej dijetarëve të atij vendi shkon te udhëheqësi - Ibn Tulun dhe i thotë: Frikësoju Zotit dhe mos bën padrejtësi. Prej hidhërimit ky udhëheqës i padrejtë e merr dijetarin dhe e burgos pa kurrfarë faji. Siç ka ndodhur edhe burgosja e Jusufit a.s., pa kurrfarë faji. Pasi që e burgos, Ibn Tuluni e kishte një luan, i thotë parisë së tij që mos t'i japin luanit ushqim tri ditë, deri sa të uritet shumë, e pastaj ta dërgojnë në Qelinë e dijetarit, Ebu Hasanit. Kur e dërgojnë luanin në qeli, te dijetari, duke ia mbyllur derën, ata menduan se luani e ka ngrënë të terin. Mirëpo, ndodh e kundërta, kur shkojnë në burg, shohin se si dijetari falej, ndërsa luani e ruante. Dijetari ka duruar, për durimin e tij, Zoti e ka shpërblyer, e ka dashur dhe është përkujdesur për të, sa që luani edhe pse ka qenë i uritur nuk e ka ngrënë. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

*“Dhe duro, për gjykimin e Zotit tënd, se vërtet ti je në përkujdesjen tonë.”*

# FALËNDERIMI

Besimtari gjithmonë e falënderon Allahun. Gjithmonë falënderon prindërit. Ai falënderon çdo njërin, i cili i bën mirë atij. Besimtari e di se ai, i cili nuk falënderon njerëzit, ai nuk e falënderon as Allahun.

Falënderimi është prej specifikave madhështore të Islamit, cilësi, të cilën shumë pak njerëz e kanë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Dhe shumë pak prej robërve janë falënderues.”***

Falënderim do të thotë të shprehurit dhe paraqitja e begative në tavolinë me gjuhë të pastër, dhe pranimi i atyre të mirave me zemër.

Kemi falënderim me *gjuhë*,  
falënderim me *zemër* dhe  
falënderim me *gjymtyrë*.

Falënderimi me gjymtyrë është me gjithëpërfshirës se falënderimi me gjuhë, sepse kur është pyetur një dijetar:

Cili është falënderimi i syve?

Është përgjigjur: - Nëse e sheh të keqen dhe e fsheh.

Cili është falënderimi i veshëve?

Është përgjigjur: - Nëse e dëgjon të mirën e ruan, e nëse e dëgjon të keqen e largon.

Cili është falënderimi i duarve?

- Që të mos marrësh me duar atë çka nuk është e jotja dhe të pengosh atë çka nuk është e drejtë.

Cili është falënderimi i barkut?

- Që fundi i tij të jetë ushqimi, e kryet dhe maja e tij dituria.

Cili është falënderimi i këmbëve?

- Që të shkosh në rrugën e drejtë të Allahut dhe në atë që ka lejuar Allahu, dhe te mos shkosh në rrugë, të cilën e ka ndaluar Allahu.

Po ç’është puna e atij i cili falënderon vetëm me gjuhë?

Është përgjigjur: - Kjo ngjason sikurse një njeri e vesh një rrobe, mirëpo ajo e mbulon vetëm një pjesë të trupit të tij, ndërsa pjesa tjetër i mbetet jashtë dhe nuk mund ta mbrojë trupin as nga të nxehtit, as nga dëbora, as nga shiu, e as nga të ftohtit.

Pra, falënderimi është i ndërlidhur me gjuhën, me zemrën dhe me gjymtyrët.

## FALËNDERIMI NË KUR`AN

Zoti i Lartmadhëruar “falënderimin” në Kur`an e ka përmendur në shumë vende. Ne do t’i përmendim disa prej tyre:

***“E ju (besimtarë), hani pra nga të mirat që ua dha All-llahu, të lejuara e të pastra, jini mirënjohës për dhuntitë e All-llahut, nëse jeni të singertë në adhurim vetëm ndaj Tij.”***

*(En-Nahl, 114)*

Ky është falënderimi për të mirat që na ka dhuruar Zoti.

Pastaj Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Me kujtoni Mua, Ju kujtoj. Më falënderoni Mua, e mos u bëni pabesimtarë.”***

*(El-Bekare, 152)*

Ky është ajeti ku Zoti i Lartmadhëruar na tregon se çdo kujtim dhe falënderim ndaj Zotit, Ai na kujton dhe na falënderon.

Për falënderimin Zoti shpërblen dhe shton të mirat. Ne suretu Ali Imran Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Dhe Zoti do t’i shpërblejë falënderuesit.”*** *(Ali Imran, 145)*

Ne ajet tjetër:

***“Dhe nëse falënderoni ju, do t’ju shtoj (të mirat) juve.”***

Zotin e Lartmadhëruar duhet ta falënderojmë për ajrin, për ujin, për ushqimin, për të mirat në trup, për gjithësinë, për gjithçka. Zoti i Lartmadhëruar për ujin thotë:

***“Sikur Ne të dëshirojmë, e bëjmë atë të njelmët, përse nuk falënderoni?”***

*(El-Vakia, 70)*

Zotin e Lartmadhëruar duhet ta falënderojmë që të fitojmë kënaqësinë e Tij në të kundërtën do ta fitojmë hidhërimin e Tij:

***“Nëse ju nuk besoni, All-llahu nuk është nevojtar për ju; megjithatë, Ai nuk është i kënaqur me mosbesimin e robërve të Vet, e nëse jeni mirënjohës ndaj Tij, Ai e pëlqen atë për ju. Ndërkaq, nuk do ta bartë asnjë mëkatar barrën e tjetrit. Pastaj, e ardhmja juaj është vetëm te Zoti juaj, e Ai do t’ju njoftojë me atë që keni vepruar. Vërtet, Ai e di shumë mirë se çka mbajnë zemrat.”***

*(El-Zumer, 7)*

## FALËNDERIMI NË SUNET

Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë falënderues shembullor i njerëzimit. Ai e ka falënderuar Allahun, ka urdhëruar të falënderohet Allahu.

Prej haditheve të Muhamedit s.a.v.s. do të përmendim.

*“Kush nuk falënderon për të paktën, nuk falënderon për të shumtën. Kush nuk falënderon njerëzit, nuk falënderon Allahun. Të folurit për të mirat e Allahut është falënderim, të fshehurit e të mirave të Allahut është mosmirënjohje. Bashkësia është mëshirë, ndarja është dënim.”*

(Ahmedi)

## FALËNDERIMI PËR BEGATITË E ALLAHUT XH. SH.

Të mirat e Allahut nuk mund t'i numërojë askush.

Allahu xh.sh. na ka krijuar në formë të bukur.

Allahu xh.sh. na ka dhënë këmbë për të ecur, duar për të punuar dhe fituar.

Allahu xh.sh. e ka bërë gjuhën për të folur.

Allahu xh.sh. e ka bërë tokën shtrat për ne, për të jetuar.

Allahu xh.sh. e ka nënshtruar Diellin për të ngrohur dhe ndriçuar.

Allahu xh.sh. lëshon shiun për të sjellë ujë të freskët për pije dhe për të na furnizuar.

Allahu xh.sh. na ka dhënë ajër për të jetuar.

Allahu xh.sh. na ka bërë ditën për të punuar, ndërsa natën për të pushuar.

Për të gjitha këto Allahun duhet falënderuar.

## FALËNDERIMI I MUHAMEDIT S.A.V.S.

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi s.a.v.s. falej deri sa edhe këmbët i dridheshin. Kur i kanë thënë: “O I Dërguar i Allahut, ti po vepron kështu, ndërsa Allahu për ty ka thënë: **“ty të janë falur mëkatet e mëhershme dhe i ke të falura edhe mëkatet e mëvonshme!?”** Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Po pse mos të jem rob falënderues.”*

Kur ka lindur Pejgamberi s.a.v.s. nëna e tij, Eminja, e ka dëgjuar një zë duke i thënë: “Emëroje Muhamed, emëroje Muhamed”. Kur këtë zë e dëgjon, atëherë e emëron birin e saj Muhamed. Mirëpo fjala Muhamed është në kohën e kaluar, ndërsa fjala Ahmed është për kohën e ardhshme. Për këtë arsye Isa a.s. u ka thënë Havarijunëve:

***“Dhe, kur Isai, biri i Merjemes tha: “O beni israilë, unë jam i dërguar i All-llahut te ju, jam vërtetues i Tevratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!” E kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: “Kjo është magji e hapët.” (Saf, 6)***

Pra, Isa a.s. ka thënë do të vjen një pejgamber, i cili do të jetë lavdërues dhe falënderues. Mirëpo, pasi që ka lindur Pejgamberi s.a.v.s. atëherë ai është i Lavdëruar dhe i Falënderuar deri në Ditën e Kijametit. Përpos kësaj, Muhamedi s.a.v.s. e ka lavdëruar, e ka falënderuar Allahun dhe na ka mësuar ne, se si ta lavdërojmë dhe ta falënderojmë Allahun.

## FALËNDERIMI I SULEJMANIT A.S.

Të gjithë Pejgamberët kanë qenë falënderues, mirëpo Kur`ani i ka përmendur disa prej tyre. Sulejmani a.s. ka qenë falënderues, të cilin Zoti i Lartmadhëruar e ka përmendur në mënyrë të veçantë. Sulejmani a.s. e ka ditur gjuhën e kafshëve, shpezëve dhe të insekteve. Një ditë, deri sa ishte në marshim me ushtrinë e tij, dëgjon një buburrec duke u thënë buburrecave të tjerë: *“O ju buburreca, hyni nëpër vendbanimet e juaja, që të mos u shkel ju Sulejmani me ushtrinë e tij, duke mos ju vërejtur. Kur Sulejmani i dëgjoi e bëri një lutje: “O Zoti im, më bën që të të falënderoj për të mirat e Tua, me të cilat më ke begatuar mua dhe prindërit e mi, e po ashtu më bën që të veproj punë të mira, të cilat të kënaqin ty, dhe me mëshirën tënde më vendos te robërit e Tu të mirë.”*

Pulëbardha e quajtur Hud-hud, një ditë vjen te Sulejmani a.s. dhe e lajmëron se është një popull në një vend të quajtur Sebe, të cilët e adhurojnë diellin dhe hënën në vend të Allahut. Sulejmani a.s. ua dërgon një letër dhe i thërret që ta adhurojnë vetëm Allahun. Pastaj Sulejmani a.s. i thotë atij, të cilit i është dhënë dituri, që t’ia sjellë frontin e mbretëreshës sa qel e mbyll sytë. Kur e sheh frontin e mbretëreshës menjëherë, ai pa hamendje e falënderon Allahun. Zoti i Lartmadhëruar e përshkruan thënien e tij në Kur`an:

***“Kjo është begati, të cilën ma ka dhënë Zoti im, që të më testojë se a jam falënderues apo jomirënjohës. Dhe kush falënderon, falënderon për veten e tij, e kush mohon, Allahu prapë është i pasur fisnik.”***

## LLUKMANI A.S

***“Ne i patëm dhënë Llukmanit mençuri të përsosur (e i thamë): Të falënderosh All-llahun, e kush falënderon, e mira e atij falënderimi i takon atij, e kush refuzon (edhe ai e ka për vete), në të vërtetë, All-llahu nuk ka nevojë (për falënderimin e tij) pse Ai vetë është i lavdishëm.”***

*(Llukman, 12)*

Llukmani ka qenë peygamber, i dashur, i urtë. Ai e dallonte të drejtën ndaj të padrejtës, besimin ndaj pabesimit, falënderimin ndaj jofalënderimit.

Bazë e lidhjes së ngushtë të njeriut me Allahun është falënderimi.

## FALËNDERIMI I PRINDIT

Një njeri shkon te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i thotë: “E kam bartur nënën time mbi kraharorin tim, në nxehtësi të madhe të shkretëtirës, një kohë të gjatë, sa që edhe këmbët më digjeshin nga nxehtësia e rërës së shkretëtirës. Andaj, o i Dërguar i Allahut, a e kam kryer falënderimin ndaj saj?”

Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: *“Ndoshta mos ka qenë vetëm një falënderim i vogël, vetëm për një mundim prej mundimeve të lindjes sate.”*

Ai, i cili nuk i falënderon prindërit, nuk e ka falënderuar as Zotin. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

***“Ne e kemi porositur njeriun që të sillet mirë me prindërit, se nena e tij e ka bartur atë me vështirësi pas vështirësie, dhe i ka dhënë gjithë dy vite, për këtë arsye më falëndero Mua dhe prindërit, sepse tek unë do ta keni kthimin.”***

## FALËNDERIMI DHE LARGIMI I THERËS

Një njeri, besimtar i mirë, kalonte pranë një rruge. Në mes të rrugës e sheh një therë. Ai menjëherë mendoi se ajo therë mund ta dëmtojë ndonjë kalimtar. Besimtari e do të mirën, për këtë arsye e mori theren dhe e largoi nga rruga. Për këtë vepër të mirë, të cilën e beri, e falënderoi Allahun e Lartmadhëruar. Allahu i Lartmadhëruar për këtë vepër të mirë e shpërbleu, duke ia falur mëkatet dhe duke e shpjer në xhenet. Për këtë ngjarje na ka treguar i dashuri ynë, Muhamedi s.a.v.s., i cili ka thënë:

*“Përderisa një njeri kalonte nëpër një rrugë, e sheh një therë në mes të rrugës dhe e largoi, e falënderoi Allahun. Kështu që Allahu ia fali mëkatet e tij.”*

Ky veprim është i mirë. Për këso vepra të mira na nxit feja jonë e pastër, dhe na urdhëron për largimin e sendeve nga rruga që të mos pësojnë njerëzit.

Muhamedi s.a.v.s. po ashtu ka thënë se largimi i mbeturinave nga rruga është sadaka.

## FALËNDERON PËR TË PAKTËN SHPËRBLEHESH SHUMË

Një varfanjak shkoi te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i kërkoi lëmoshë. Muhamedi s.a.v.s. urdhëroi që t'i jepet atij një hurmë. Varfanjaku shikoi hurmën, e pa se është pak, prandaj refuzoi ta merrte dhe u largua.

Pas një kohe erdhi një lypës tjetër. Muhamedi s.a.v.s. urdhëroi që t'i jepet atij një hurmë. Ai e mori dhe u gëzua pa mase, dhe tha: E lavdëroj Allahun. Kjo është hurme e të Dërguarit të Allahut.

Pastaj i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e thërret shërbëtorin dhe i thotë që të shkojë te gruaja e tij. Nëna e besimtarëve, Umi Selmete r.a., që t'ia jepte këtij lypësi 40 dërhëmët e tij, të cilat i kishte te ajo.

Ky njeri ishte falënderues për pak e u shpërblye me shumë dhe i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ishte i kënaqur me të.

*(Bejhekiu)*

## QENI I URITUR

Pejgamberi s.a.v.s. vazhdimisht i mësonte shokët që të sillen mirë me njerëzit, që të sillen mirë me ambientin ku jetonin, që të sillen mirë edhe me kafshët. Një ditë ua tregon atyre këtë ngjarje:

*“Përderisa një njeri kalonte nëpër një rrugë, etet shumë. Pastaj e sheh një bunar të thellë, zbret në bunar dhe pi ujë, pastaj del nga aty. Kur del nga bunari sheh një qen, i cili gërvishte rërën e lagur nga etja. Ai mendoi në vete: “Ky qen është i etur ashtu siç isha unë më parë.” Zbret në bunar, e mbush këpucën e tij me ujë, pastaj e mban me gojën e tij, deri sa ngritet lart mbi bunar, dhe i jep qenit të pijë ujë. Për këtë të mirë, që e bëri ndaj qenit e falënderoi Allahun, kurse Allahu ia fali gabimet e tij.”*

Pastaj e pyesin të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: “A për çdo të mirë, që ua bëjmë kafshëve kemi shpërblim?!” Muhamedi s.a.v.s. iu përgjigj atyre:

*“Për çdo kafshë keni shpërblim.”*

## SEXHDE FALËNDERIMI

Besimtari bie ne sexhde kur falet, bie ne sexhde kur lexon në Kur'an ajetin e sexhdes. Ai po ashtu bie ne sexhde kur i ndodhe ndonjë e mirë apo i vjen ndonjë lajm i mirë dhe e falënderon Zotin për atë të mirë.

Një ditë Abdurrahman bin Aufi r.a. shkon në xhami. Aty e sheh se Pejgamberi s.a.v.s. ishte kthyer në drejtim të Kibles dhe kishte ra në sexhde. Abdurrahmani e pret deri sa ta ngrit ballin nga sexhdeja. Kaloi një kohë e gjatë, ndërsa Pejgamberi s.a.v.s. qëndronte në sexhde. Atëherë Abdurrahmani filloi të frikësohej se ndoshta Pejgamberi s.a.v.s. ka vdekur.

Shkoi dhe iu afrua shumë afër. Ne atë moment u ngrit i Dërguari i Allahut s.a.v.s. nga sexhdeja dhe u ul. Abdurrahmani r.a. u gëzua shumë dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut aq shumë qëndrove në sexhde, sa që mendova mos ke vdekur!” Muhamedi s.a.v.s. i tregon:

*“Me erdhi Xhibrili s.a.v.s. dhe më tha: “Kush dërgon për ty salavate, Allahu i dërgon atij salavate; kush të përshëndet ty, Zoti do ta përshëndes atë. Për këtë arsye i bëra Zotit sexhde falënderimi.”*

## MOS U ANKO

Një njeri i varfër shkon te një dijetar dhe ankohet se është i varfër.

Dijetari i thotë: - A do të kishe dashur që t'i kishe 10.000 dërhëm, por të kishe qene i verbër, pa sy? Ai i thotë: - Jo!

Dijetari i thotë: - A do të kishe dashur që t'i kishe 10.000 dërhëm, e të kishe qenë pa veshë? Ai i thotë: - Jo!

Dijetari i thotë: - A do të kishe dashur që t'i kishe 10.000 dërhëm, e të kishe qenë pa duar? Ai i thotë: - Jo!

Dijetari i thotë: - A do të kishe dashur që t'i kishe 10.000 dërhëm, e të kishe qenë pa këmbë? Ai i thotë: - Jo!

Dijetari i thotë: - A do të kishe dashur që t'i kishe 10.000 dërhëm, e të kishe qenë pa mend? Ai i thotë: - Jo!

Atëherë dijetari i thotë: - A nuk po të vjen turp që të ankohesh te Allahu, kur ti ke begati në trup që vlejnë më shumë se 50.000 dërhëm?!

Atëherë njeriu shkoi duke e falënderuar Allahun për të gjitha të mirat që ia ka dhënë, dhe e harroi varfërinë e tij.

## USHQIMI DHE FALËNDERIMI

Zoti i Lartmadhëruar ka ngritur qiellin e lartë, e tokën e ka bërë të shtrirë, e zbret shiun, i ngjall bimët, i rrit kafshët. Të gjitha këto begati i ka krijuar për të mirën e njeriut.

Njeriu qëllimin kryesor të jetës së tij duhet ta këtë takimin me Allahun, ndërsa kjo nuk mund të arrihet vetëm se me dituri, punë dhe trup të shëndoshë, ndërsa trupi i shëndosh arrihet me ushqim të mirë dhe të pastër, kohë pas kohe dhe sipas nevojës.

Sikurse çdo gjë që ka rregullat e saja, ashtu edhe ushqimi e ka rregulloren e vet. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

***“Hani prej të mirave që ju kemi furnizuar dhe falënderojeni Allahun.”***

Pra, kur të fillohet ushqimi fillohet me *“Bismil-lahirrrahmanirr-rrahim”*. (Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm Mëshiruesit). Ndërsa, kur përfundohet bëhet falënderimi me *“Elhamdulilah”* (Falënderoj Allahun, i Cili na bëri të ushqehemi, të pimë ujë dhe na bëri musliman”).

## VENDI I SEBEIT

Ka qenë një vend i quajtur Sebe. Mbi atë vend buronte ujë dhe tubohej në mes dy kodrave, kështu që banorët e ngritën një pendë. Pastaj ujin e tubuar e shfrytëzonin për pije dhe ujitje të pemëve dhe perimeve. Pemët dhe perimet ishin aq shumë të mira, sa që nuk mund të përshkruhen. Kur rriteshin pemët dhe perimet, atyre nuk u binte asnjë krimb, asnjë mushkonjë, asnjë mizë, asgjë që t'i dëmtonte. Në livadhe nuk kishte asnjë akrep dhe asnjë gjarpër.

Gruaja e merrte torbën e vendoste mbi kokë dhe ecte, duke ecur pema i binte në të pa u lodhur fare.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Populli Sebe pati një begati në vendbanimin e vet: kishin nga të dy anët kopshte, nga ana e djathtë (e luginës) dhe nga ana e majtë. Hani (u thamë) nga begatitë e Zotit tuaj dhe falënderonju Atij. Qytet i mirë dhe Zot mëkatfalës. Po ata i kthyen shpinën, e Ne e lëshuam kundër tyre rrjedhën e pendës dhe dy kopshtet e tyre i shndërruam në dy kopshte me fruta të idhët, drunj të thatë dhe diçka pak bari të egër. Atë dënim ua dhamë atyre për shkak se nuk besuan, e Ne nuk dënojmë, përveç mohuesit.”***

*(Sebe, 15-17)*

Pra, Zoti i Lartmadhëruar nuk ka kërkuar asgjë prej tyre vetëm se falënderimin. Mirëpo ai popull ushqej dhe nuk e falënderonte Zotin, por ia kthyen shpinën Zotit. Për këtë arsye Zoti dërgoi një shi rrebesh, e përcjellë me frymë të fortë, dhe bahçet më të mira i shndërroi në bahçe me pemë të hidhëta, e këtë si dënim se nuk ishim falënderues.

Mosmirënjohësit dhe jofalënderuesit ndëshkohen me dënim të ashpër.

Pejgamberi s.a.v.s. na ka mësuar të bëjmë këtë lutje:

***“O Zoti im, më bën që të të përkujtoj e të të falënderoj, më bën që të jem adhures i mirë ndaj Teje.”***

Falënderim i syve është që e mira të shihet, ndërsa e keqja jo.

Falënderimi i veshëve është që e mira të dëgjohet, ndërsa e keqja jo.

Falënderimi i duarve është që e mira të pranohet, ndërsa e keqja jo.

Falënderimi i barkut është të ushqyerit me ushqim të lejuar dhe hallall.

Falënderimi i këmbëve është të shkuarit në rrugë të drejtë dhe largimi nga rruga e keqe.

Ai, i cili falënderon me gjuhë, ndërsa me pjesët e tjera të trupit jo, atëherë ajo është sikur një njeri lakuriq, të cilin lakuriqësia nuk e mbron, as nga shiu, as nga bora, as nga të ftohtit dhe as nga të nxehtit.

## ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR

Nga ky libër përfitojmë se:

- Durimi është i domosdoshëm në jetë për ti realizuar qëllimet;
- Durimtarët shkojnë në xhenet pa dhënë llogari;
- Durimi duhet të jetë që në tronditjen e parë;
- Besimtari nuk humb përderisa këshillon për të drejtën dhe për durim;
- Besimtari duhet të jetë falënderues ndaj Allahut për te mirat;
- Falënderimi ndaj Allahut i shton të mirat;
- Të mirat e Allahut janë të pakufishme;
- Mosmirënjohësit dhe jofalënderuesit ndëshkohen me dënim të ashpër.

## PËRFUNDIM

Të përkujtojmë ajetin: *“Vërtet durimtarët kanë për tu shpërblyer pa llogari.”*

Ndërsa përkujtimi është për ata që kanë zemër, përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën. Ndoshta kjo çka është shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

Ndoshta kjo çka është shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

# **BAMIRËSIA**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

**19**



## BAMIRËSIA

Islami kërkon prej njeriut të gjitha cilësitë e mira morale.

Mirësi do të thotë që kur të veprosh një punë ta bësh si është më së miri. Po ashtu mirësi do të thotë çdo rregull e pëlqyer logjikisht, çdo vepër që e bën njeriun të lumtur fizikisht dhe shpirtërisht.

Morali i bamirësisë është bazë e besimit dhe plotësimit të tij.

Mirësia ka dy kuptime:

- Mirësinë që bën njeriu ndaj Zotit të tij dhe të tjerëve;
- Mirësinë që ka kuptimin e kryerjes së obligimit si është më së miri, pra përsosmërinë e veprimit. Kjo do të thotë: Kryerjen e veprimit si është më së miri, duke qenë i bindur thellë se Allahu e përcjell, duke iu frikësuar Zotit, fshehurazi dhe haptazi.

Emër i Allahut është “I MIRË”. Po ashtu, Allahu dëshiron që kur të punoni diçka, që atë ta plotësoni në mënyrën më të përsosur. Nëse dëshiron të fitosh dashurinë e Allahut, sjelljet e tua plotësoji dhe kryeji në mënyrën më të bukur.

Bamirësia është një nga veprat e pëlqyera të Allahut.

Të gjitha obligimet hyjnë nën sferën e mirësisë. Jeta në fe është jeta në bamirësi, kurse Zoti për këtë jetë shpërblen shumëfish:

*“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë. Do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”*

*(En-Nahl, 97)*

## BAMIRËSIA NË KUR'AN

*“Nuk është bamirësi të kthyerit e fytyrës suaj kah lindja dhe perëndimi, por mirësi është kur (njeriu) beson në Allahun, Ditën e Kijametit, melekët, librin, peygamberët dhe të cilit me dashurinë e vet u japin nga pasuria të dashurve të tyre, të afërmyve, jetimëve, varfanjakëve, udhëtarëve (që kanë mbetur pa mjete udhëtimi), lypësve dhe të robëruarve (për t'i liruar nga robëria); e (mirësi) është po ashtu falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e obligimeve premtuese kur premtojnë; e (mirësi) është durimi i durimtarëve në kohëra të vështira të skamjes e të sëmundjes dhe durim i tyre në kohëra të luftës. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe të singertë. Këta janë të devotshmit.”*

*(El-Bekare, 177)*

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“Ata, të cilët japin në kushte të lira dhe në kushte të vështira, (po ashtu edhe të cilët) frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit.”*

*(Ali Imran, 134)*

Fjala “i do bamirësit (Allahu)” në Kur'an përmenden në pesë vende. E kjo dëshmon se sa janë të dashur tek Allahu bamirësit.

## BAMIRËSIA NË SUNET

*“Bamirësia është ta adhurosh Allahun sikur kur e sheh, e në çoftë se ti nuk e sheh, Ai padyshim të sheh ty.”*

(Buhariu dhe Muslimi)

Pejgamberi s.a.v.s. është lutur:

*“O Zoti im! Më bën që të bëjë punë të mira, të cilat më ofrojnë pran Teje.”*

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Jini të vërtetë, sepse vërtetësia të dërgon në bamirësi, e bamirësia të dërgon në Xhenet.”*

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Çdo vepër e mirë konsiderohet sadaka, kurse ai që udhëzon kah një emirë është sikur ai që e bën atë të mirë.”*

(Buhariu dhe Muslimi)

## DYERT E BAMIRËSISË

Dyert e bamirësisë janë të shumta, prej tyre do t'i përmendim disa:

- Adhurimi dhe madhërimi i Allahut;
- Këshillimi për vepra të mira;
- Këshillimi për largim nga veprat e këqija;
- Ndihma e të verbërve;
- Ndihma ndaj nevojtarëve (të dobëtëve);
- Heqja e gurëve dhe pengesave nga rruga;
- Të drejtuarit në rrugë të mbarë atë që ka devijuar rrugën;
- Të vizituarit e të sëmurëve.

## BAMIRËSIA NË ADHURIM

Xhibrili e pyeti Pejgamberin s.a.v.s.:

*“Ç’është bamirësia?”*

Muhamedi s.a.v.s. iu përgjigj:

*“Bamirësia është ta adhurosh Allahun sikur e sheh, sepse, edhe pse ti nuk e sheh (gjatë adhurimit), pa dyshim se Ai të sheh ty.”*

*(Buhariu dhe Muslimi)*

## URDHËRESA PËR BAMIRËSI TË PËRGJITHSHME

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ

*“Vërtet Allahu urdhëron drejtësi, mirësi, ndihmë të afërmve, kurse ndalon nga imoraliteti nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon, ashtu që të merrni mësim.”*

*(En-Nahl, 90)*

Bamirësia është fjalë që përfshin të gjitha veprimet, duke filluar nga gjërat e vogla, e deri te gjërat më të mëdha.

Bamirësia fillon nga vetvetja, kjo do të thotë që secili duhet t'i bëjë mirë vetes, duke e larguar veten nga punët e këqija, si p.sh.: alkooli, bixhozi, prostitucioni dhe veset e këqija; e duke e angazhuar veten në përkujtim ndaj Allahut, i Cili e qetëson shpirtin e njeriut, në ibadet ndaj Allahut dhe në të gjitha veprat e mira; duke u ndihmuar të dobëtëve, të varfërve, jetimëve; duke bërë lidhjen farefisnore; duke i pajtuar besimtarët mes vete; duke qenë i sjellshëm në shoqëri, në ndërtimin e urës, e cila i sjell lumturi njerëzimit.

## MIRËBËRËSI

Mirëbërësi është Allahu, i Cili me bamirësinë e Tij ka përfshirë të gjitha krijesat. Allahu gjithnjë është bamirës. Çdo njeri ka nevojë për bamirësinë e Allahut, në çdo çast.

Bamirësia e Tij është dy llojesh: E përgjithshme dhe e veçantë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“Dhe çdo të mirë që e keni, ajo është prej Allahut.” (En-Nahl, 53)*

Sa i përket bamirësisë së përgjithshme, ajo përfshinë të gjithë banorët e qiejve dhe të tokës. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“E mëshira Ime ka përfshirë çdo send.” (El-Earafë, 156)*

Ndërsa, sa i përket bamirësisë së veçantë, ajo është mëshira, të cilën e kanë kërkuar peygamberët, të cilët e kërkojnë njerëzit e mirë. Përpos që është mëshirë për në botën tjetër, është mëshirë edhe për këtë botë, për të korrur sukses në besim, në dituri, në punë dhe lumturi në jetë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“Dhe çdo të mirë që e keni ajo është prej Allahut.” (En-Nahl, 53)*

Lusim Zotin e Lartmadhëruar që të na shtie në mesin e robërve të mirë.

## BAMIRËSIA ME PRINDËR

Bamirësia ndaj prindërve është prej punëve më të dashura tek Allahu, është shkak i pranimit të lutjes në këtë botë dhe shkak për të fituar Xhenetin.

Sa herë që shtohet mirësia ndaj prindërve, shtohet afërsia ndaj Allahut të Lartmadhëruar.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'anin fisnik thotë:

*“Ka urdhëruar Zoti yt që të mos adhuroni tjetër, pos Tij dhe që ndaj prindërve të silleni me mirësi. E, nëse njërin prej tyre ose që të dy i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of”, mos iu bërtit atyre, po thuaju atyre vetëm fjalë të bukura dhe të mira. Dhe në shenjë mëshire shtriye pranë tyre krahun përulës dhe thuaj: “Zoti im! Mëshiroji ata dy, siç janë përkujdesur për mua në vegjëli.”*

Në një hadith, Pejgamberi s.a.v.s. tregon për tre persona se si për shkak të shiut janë strehuar në një shpellë, mirëpo dridhet toka dhe hyrja e shpellës bllokohet. Të tre personat luten për shkak të punëve të mira të tyre që hyrja e shpellës të lirohet. Njëri prej tyre lutet:

*“O Zoti im! I kam pasur prindërit pleq dhe asnjëherë para tyre nuk ju kam dhënë të hanë e as të pinë fëmijëve, e as punëtorëve të tjerë. Një ditë më hutoi kërkimi i kullosës për kopenë time, e nuk ju erdha me kohë dhe ata kishin fjetur. Unë tubova qumështin në enë dhe e dërgova tek ata, por ata veç kishin fjetur. Më edhi keq t'i trazoj, por nuk desha që para tyre t'i ushqej të tjerët, andaj i kam pritur me enë në dorë duke shikuar se kur po zgjohen, e kjo pritje ka zgjatur deri në agim. Fëmijët e mi aty te këmbët e mia kërkonin (qumësht), të cilëve u kam dhënë qumësht, vetëm pasi që prindërit janë zgjuar dhe kanë pirë qumështin, të cilin ua kam sjell.*

*O Zoti im! Nëse këtë e kam bërë vetëm për Ty, e për askënd tjetër, atëherë na e largo këtë shkëmb nga hyrja e kësaj shpelle, në të cilën gjendemi.” Allahu ua lëvizi shkëmbin aq sa të shohin qiellin ...”.*

(Buhariu)

## BAMIRËSIA NDAJ PRINDIT TË SJELLË TË MIRA NË JETË

Një djalosh i ri punonte me zell, ai kujdesej shumë për të atin e tij. Me një fjalë, ishte bamirës ndaj babait të tij. Të hollat, të cilat i fitonte, i vinte turp t'ia jepte babait në dorë, sepse duhej që babai ta zgjaste dorën dhe t'i merrte të hollat nga ai. Kështu që i vendoste të hollat në tavolinë. Babai çdo herë kur i merrte këto të holla lutej për këtë djalosh:

*“O Zoti im, furnizoje birin tim me dituri të Kur'anit dhe bëje pasues të tij.”*

Pas disa vitesh, ky djalosh takohet me një dijetar, i cili e pyet:

- Çfarë po bëni?
- Punoj për të fituar bukën.
- A ke mundësi që të vish tek unë që të ta mësoj Kur'anin?

Djali pa u hamendur pranoi. Me kalimin e kohës ky djalosh arrin shkallë të lartë të diturisë, sa që edhe e mbron temën e doktoraturës në shkencën e tefsirit.

Ky djalosh, përpos që kishte arritur shkallën më të lartë të diturisë në shkencën e tefsirit, ishte i devotshëm, i sjellshëm dhe bamirës, por ishte edhe i dhimbshëm ndaj të tjerëve. Kështu që, pasi e mbrojti temën e doktoraturës filloi të qajë. Kur e pyesin për shkakun e të qarit, ai përgjigjet: “Qaj, se unë jam fryt i duasë së babait tim, i cili është lutur për mua: *“O Zoti im, furnizoje birin tim me dituri të Kur'anit dhe bëje pasues të tij!”*

Kjo dua i është pranuar babait, pasi që djali i tij ishte bamirës ndaj tij.

## SHEHADETI

Prindërve u takon bamirësia ideale, për këtë arsye duhet pasur kujdes që të bëhemi të sjellshëm dhe bamirës ndaj tyre. Duhet t'i respektojmë, t'i nderojmë dhe të bëjmë dua për ta, e asnjëherë mos t'i hidhërojmë, sepse hidhërimi ndaj prindërve mund të jetë shkak që të mos mundim ta shqiptojmë edhe shehadetin.

Në Medine, në kohën e Muhamedit s.a.v.s., ka ndodh një ngjarje interesante:

Ishte një sahab, ai quhej Alkame, ishte sëmurë aq rënd, sa që nuk mund ta thoshte as shehadetin. Duke pasur parasysh se ai falej, agjëronte, jepte zekatin, të afërmit habiteshin për shkakun që ai nuk mund ta thoshte shehadetin. Për këtë arsye shkojnë te Muhamedi s.a.v.s. dhe i lajmërojnë për gjendjen e tij. Muhamedi s.a.v.s. menjëherë i pyet: “A ka Alkame prindër?” Ata i përgjigjen: “I ati i tij ka vdekur, e nënën e ka të moshuar.” Muhamedi s.a.v.s. shkon te nëna e tij dhe e pyet: “Si kanë qenë raportet dhe sjelljet e tij ndaj teje?” Nëna e Alkames përgjigjet: “E ka çmuar dhe i ka dhënë përparësi gruas së tij ndaj meje. Për këtë arsye, unë jam e hidhëruar me të.”

Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. i thotë Bilallit: “*Shko e sillni disa dru, ta ndezi një zjarr dhe ta djeg Alkamen.*” Kur dëgjoi këtë, nëna tha: “O i Dërguar i Allahut, a dëshiron ta djegësh birin tim, lulen e zemrës sime, në praninë time?!” “Si mund ta bartë këtë zemra ime?” Pejgamberi s.a.v.s. i shkon buza në gaz, pasi që dëshironte që nëna e Alkames t'ia falte gabimin birit të saj, dhe i thotë: “Nëse dëshiron që Zoti të jetë i kënaqur dhe ta shpëtojë birin tënd, falja gabimin, pajtohu dhe bëhu e kënaqur ndaj tij.” Atëherë nëna e Alkames thotë: “Unë ia fala gabimin dhe jam e kënaqur me të.”

Pas kësaj, kur shkoi Bilalli r.a. te dera e Alkames, dëgjoi Alkamen duke thënë: “Eshhedu en la ilahe il-lall-llah ve eshhedu enne Muhameden abduhu ve resuluhu”. Bilalli u kthye dhe e lajmëroi Pejgamberin s.a.v.s. se Alkame e ka thënë shehadetin.

Kështu pra, nëse nuk sillemi me bamirësi ndaj prindërve, mund të ndikojë në pamundësinë e shqiptimit të shehadetit.

## BAMIRËSIA ME FËMIJË

Në hadith Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Çdo njeri që ka dy vajza ose motra dhe ju bën mirë atyre do të hyjë në Xhenet. “*

*(Ibni Maxhe)*

Shembullin më të mirë të bamirësisë ndaj fëmijëve femra e kemi te Pejgamberi s.a.v.s. Ai sa herë që Fatimja r.a. hynte në dhomat ku ishte Pejgamberi s.a.v.s. ngihej dhe e puthe atë në ballë. Kur Fatimja është martuar për Aliun r.a. ata banonin larg nga shtëpia e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. I Dërguari a.s. i thotë një sahabiu, i cili e kishte shtëpinë afër tij: *“Nuk po mund ta përballoj largësinë e bijës sime, Fatimes, andaj shitma këtë shtëpi”*. Sahabiu i thotë: *“O i Dërguar i Allahut, edhe unë edhe shtëpia ime janë në shërbim të Allahut dhe të Dërguarit të Tij.”*

Kështu pra, i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dëshironte të jetë pranë shtëpisë së fëmijëve.

Edhe ne duhet ta marrim Muhamedin s.a.v.s. shëmbëlltyrë në mirësi ndaj fëmijëve.

## BAMIRËSIA NË TË FOLUR DHE DIALOG

Gjithmonë kur kemi të bëjmë me të folurit, gjithmonë duhet pasur parasysh kur i ftojmë të tjerët në Islam.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“E Kush ka fjalë më të mirë, se sa fjala e atij që fton për tek Allahu, bën punë të mira dhe thotë: “Unë me të vërtetë jam prej muslimanëve.”*

Në ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“Fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe mençuri dhe me këshilla të bukura, e kur të bësh dialog, dialogo me ata në mënyrën më të mirë.”*

*(En-Nahl, 125)*

Ja si e ka këshilluar Llukmani djalin e tij për mirësjellje:

*“O Djali i m, nëse (vepra e punuar) është që peshon sa një kokërr hardeli (lloj kokrre, bime e imët) e ajo të jetë në shkëmb, ose në qiej ose në tokë, Allahu do ta nxjerr në shesh atë. Vërtet Allahu është i Butë dhe Njohës i të gjitha fshehtësive. O Djali im, fale namazin, urdhëro me të mirë për mirësi dhe mënjano nga të këqijat, dhe duro prej fatkeqësive që të kaplojnë, vërtet, kjo është prej çështjeve vendosëse. Mos e shmang fytyrën tënde nga njerëzit dhe mos ec nëpër tokë mburracak. Ke kujdes në ecje dhe ec me modesti, e fol me zë të ulët, se zëri më i urryer është zëri (pallja) e gomarit. “*

*(Lukman, 17-19)*

## BAMIRËSIA NË DHËNIE TË PASURISË

Për ata, të cilët bëjnë mirë dhe shpenzojnë pasuri, për t'u bërë mirë të tjerëve, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut janë si shembulli i atij që mbjell kokërr, nga e cila dalin shtatë kallinj, dhe në çdo kallinj nga njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon (shpërblimin) edhe më tepër atij që do, se Allahu është i Gjithëdijsëm dhe Bamirës i madh.”*

*(El-Bekare, 261)*

Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar në një ajet tjetër thotë:

*Ata, të cilët shpenzojnë (japin) kur janë në kushte të mira (të shlrirë) dhe kur janë në kushte të vështira dhe që frenojnë mllëfin, që u falin (gabimin) njerëzve, e Allahu i do bamirësit.”*

*(Ali Imran, 134)*

Një dijetar i njohur, Es-Sektîu thotë:

“Bëj mirësi kur të kesh mundësi, sepse në çdo kohë nuk ke mundësi të bësh mirësi.”

Një poet thotë kështu:

“Nxito me të mirën kur të kesh mundësi, që t'i përgatitësh veprat e bamirësve, e nëse ke mundësi nxito te bamirësia, se mund të ndodhë që do të kesh dëshirë të bësh mirësi, por nuk do të kesh mundësi.”

## BËN MIRË ME ATË QË TA KA DHËNË ALLAHU

Në kohën e Pejgamberit Musa a.s. ishte një pasanik, Karuni, sa që pasuria e tij ishte aq e shumtë, sa që një grup i madh i njerëzve nuk mund t'i bartnin vetëm çelësat e depove të tij. Mirëpo, ai nuk e falënderonte Zotin, përkundrazi i pengonte të tjerët të bënin mirë.

Besimtarët kur e panë se Karuni i provokonte njerëzit me pasuri, vendosën që ta këshillojnë. Shkojnë te Karuni dhe i thonë:

*“... mos u kreno aq fort, padyshim se Allahu nuk i do të shfrenuarit! Dhe me atë që ta ka dhënë Allahu kërko botën tjetër, por edhe mos lë mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë mirë Allahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit.”*

*(El-Kasas, 76-77)*

Por, Karuni nuk e pranoi këshillën e besimtarëve. Ai nuk bënte mirë, kështu që Zoti e dënoi atë në atë mënyrë, sa që ai vet dhe e tërë pasuria e tij u fundosën nën dhé.

Pra, ky është dënimi dhe përfundimi i atyre që nuk u bëjnë mirë të tjerëve.

## BAMIRËSIA NDAJ TË VARFËRVE

Ebu Nasr Es-Sajad ishte një njeri shumë i varfër. Një herë kaluan disa orë pa ngrënë asgjë, as ai, as familja e tij. Pa ditur se ç'bënte del nga shtëpia dhe shkon te një dijetar, të cilit ia qan hallin. Dijetari thotë: “Më ndiç nga pas”. E merr rrjetën dhe shkojnë në bregdet. Fal dy rekate namaz. Pasi falet dijetari i thotë: “Thuaj: Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim dhe hidhe rrjetën në det.” Pasi e thotë këtë dijetari largohet. Ebu Nasri e la pak kohë rrjetën në det dhe filloi ta tërheqë atë, kur pa se një peshk të madh ka kapur rrjeta. E mori peshkun, shkon në treg, e shet dhe me ato të holla blen bukë dhe ushqime.

Duke shkuar në shtëpi, i del para një grua me fëmijën e saj, të cilët mezi ecnin nga uria. Kur e panë Ebu Nasrin, sytë e tyre u ndalën në çantën ku mbante bukën dhe ushqimet. I hutuar nga ajo që po shikonte, ua jep të gjitha ato që kishte në çantë. Gruas i rrjedhën lotët nga gëzimi dhe fëmija filloi të buzëqeshë.

Ebu Sajadi vazhdon udhëtimin i mërzhitur, dhe ashtu siç ishte i mërzhitur dëgjon një zë që thërriste: “Kush e njeh Ebu Nasr Es-Sajadin?!” Vrapon drejt tij dhe i thotë: “Unë jam ai që e kërkon. Çfarë doni?” Ai i thotë: “Ka njëzet vjet që i kam marrë borxh babait tënd, një borxh prej 30 000 dërrhemësh. Këtë borxh ia kam marrë dhe kam shkuar në kurbet dhe tani jam kthyer, e më thanë që babai yt ka vdekur dhe e ka lënë një djalë, me emrin Ebu Nasr Es-Sajad, kështu urdhëro borxhin që i kisha babait tënd.”

Pas kësaj më nuk jam bërë i varfër, por u bëra i pasur, e tëra kjo për shkak të bamirësisë ndaj asaj gruaje. Fillova të jepja sadaka vazhdimisht.

Një natë pashë ëndërr sikur ishte bërë Kijameti dhe ishte vendosur peshoja e veprave. Kur më erdhi radha e peshojës mua, pashë se të këqijat peshonin më shumë se të mirat!

- Po ku janë paratë, të cilat i dhashë lëmoshë? - pyeta.

U vendosën, por peshorja nuk lëvizti fare.

Njëri nga melekët tha: “A ka mbetur gjë tjetër pa u vendosur në peshore?” “Po”, u përgjigj meleku tjetër, - “janë lotët e gruas së cilës i ka dhënë bukë dhe ushqimet.” U vendosën lotët në peshore dhe peshorja ra në ekuilibër dhe u barazuan veprat e mira. Meleku thirri: “A ka edhe diç tjetër?” “Po”, u përgjigj, - “është buzëqeshja e fëmijës.” Kur u vendos edhe buzëqeshja e fëmijës, atëherë meleku thirri i gëzuar: “*Shpëtoi, shpëtoi ...!*”

## BAMIRËSIA NDAJ GJALLESAVE

Abdullah Ibnu Abasi r.a. është një nga dhjetë të përgëzuarit me Xhenet. Ai çdo ditë i mbledhte thërrmijat e bukës dhe ua jepte milingonave, të cilat ishin në një fole pranë shtëpisë së tij.

Kur dikush e pyeti se përse e bënte këtë. Ai i tha: “Ata janë fqinjët e mi.”

Këtë cilësi të moralit Abdullah Ibn Abasi e kishte fituar nga Muhamedi s.a.v.s. pasi që kishte urdhëruar: *“Silluni mirë me fqinjët.”*

Pejgamberi s.a.v.s. na ka treguar edhe një ngjarje tjetër, ku një njeriu i janë falur gabimet për shkak të bamirësisë së tij ndaj një qeni.

Ja si e tregon ngjarjen Muhamedi s.a.v.s.:

I dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: *“Deri sa një njeri po kalonte përgjatë një rruge, e kaplon një etje e madhe. E sheh një bunarë, zbret në thellësi të tij, piu ujë dhe doli nga aty. Pasi që doli, e sheh një qen duke lehur dhe duke lëpirë lëmyshqe nga etjes. Thotë me vete: “Ky qen është i etur, ashtu siç isha unë më parë”. Kështu që zbret përsëri në bunar, e mbush këpucën e tij dhe e mbante me gojë deri sa u ngrit lart dhe i dha të pijë ujë qenit. Për këtë mirësi që e bëri e falënderoi Allahu, e ia fali atij”.*

*(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)*

Në një transmetim të dy koleksioneve sahihë thuhet: *“Përderisa qeni sillej rreth e rrotull bunarit, dhe ishte duke ngordhur nga etja, kur një məkatar prej məkatarëve beni Israil e sheh, e heq këpucën e tij, e mbush me ujë dhe i jep të pijë. Për këtë iu falën məkatat”.*

## PËRFUNDIMI I BAMIRËSVE

Bamirësia përshinë të gjitha llojet e mirësive. Ndër to: të bërit mirë të tjerëve, respektimi dhe nderimi i të tjerëve, besimi dhe dëgjueshmëria, devotshmëria dhe modestia, durimi, sinqeriteti, drejtësia, butësia etj.etj.

Bamirësia mund të jetë edhe me fjalë edhe me vepra.

Të mirë janë besimtarët, të cilët janë të cilësuar me të gjitha vetitë e mira. Ata angazhohen për të mbisunduar paqja, qetësia dhe lumturia në këtë botë. Ndërsa për në botën tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“Me të vërtetë, të mirët do të jenë në Xhenet, e nga kanapetë-divanet do të shikojnë, në fytyrat e tyre do të njohësh shkëlqimin dhe freskinë e begative, atyre do t’u jepet të pinë nga enët e mbyllura dhe të ruajtura, përfundimi i tyre është misk (parfum) dhe për këtë le të garojnë garuesit.”*

*(El-Mutaffifinë, 22-26)*

## ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR

Nga ky libër përfitojmë se:

- Islami kërkon të gjitha cilësitë e mira morale;
- Morali i bamirësisë është bazë e besimit;
- Bamirësitë të mbrojnë nga fatkeqësitë;
- Bamirësia ndaj prindërve është shkak i pranimit të lutjeve;
- Bamirësia ndaj prindërve të sjellë të mira dhe lumturi në jetë;
- Bamirësia ndaj vajzave është shkak për të fituar Xhenetin;
- Fjala më e mira është thirrja n rrugë të Allahut;
- Përfundimi i bamirësve është Xheneti;
- Allahu ka urdhëruar për bamirësi;
- Bamirësia ndaj të varfërve peshon dhe ka vlerë të madhe;
- Muslimani duhet të jetë bamirës edhe ndaj gjallesave;
- Të bërit keq bën që të shkatërrohesh.

## PËRFUNDIM

Të kujtojmë ajetin, në të cilin Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: *“Thuaj: “Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t’i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata.”*

*(Junus, 58)*

Ndërsa, kujtimi është për ata që kanë zemër, që përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën.

Ndoshta kjo çka është e shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe e dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

# **MËSHIRA**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

**20**



## MËSHIRA

Mëshira është cilësi fisnike islame.

Mëshira është moral, i cili tregon ngritjen e lartë shpirtërore dhe pastërtinë e zemrës. Sa më shumë rritet mëshira te njeriu, aq më shumë ngritet personaliteti i tij.

Cilësi e Zotit është cilësia *“i Mëshirshëm”*. Mëshira e Zotit përfshinë çdo gjë.

Të gjitha gjallesat jetojnë prej mëshirës së Allahut. Zoti i Lartmadhëruar ia ka bërë detyrë Vetes mëshirën.

Njeri i mëshirshëm është ai, i cili ka zemrën e butë, i cili gjithmonë bën vepra të mira.

Mëshira tregon pjekurinë e njeriut dhe pastërtinë e shpirtit.

Morali i mëshirës është morali që do të bëjë dobi në Ditën e Kijametit.

Të gjitha suret në Kur'an fillojnë me fjalën *“mëshirë”*, me *bismilahi rrahmani rrahim*.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

*“Allahu ka caktuar për Veten e Tij 100 pjesë të mëshirës, prej tyre vetëm një pjesë e ka lënë në tokë, e prej asaj pjese mëshirohen të gjitha gjallesat, sa që edhe kafsha e bën vrimën për të voglin e saj, nga frika se mos i ndodhë diçka.”*

Mëshira është cilësi e të gjithë peygamberëve. Të gjithë peygamberët kanë qenë të urdhëruar për mëshirë.

Peygamberi s.a.v.s. është dërguar mëshirë për të gjithë botët. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

***“Ty (o Muhamed) nuk të kemi dërguar për diçka tjetër, përpos mëshirë për të gjithë botët.”*** (El-Enbija, 107)

Zoti i Lartmadhëruar e ka pajisur zemrën e Muhamedit s.a.v.s. me dituri, urtësi, mirësi, butësi, fisnikëri, sa që e bëri njeriun më të mëshirshëm. Ja çka thotë Zoti i Lartmadhëruar:

***“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje.”***

(Ali Imran, 159)

Po mos ta kishte Muhamedi s.a.v.s. cilësinë e mëshirës, njerëzit nuk do të tuboheshin rreth tij.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

***“Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.”***

*(Et-Tevbe, 128)*

Pas Muhamedit s.a.v.s. edhe sahabët janë pajisur me këtë cilësi, e edhe ne duhet të vazhdojmë rrugën e tyre, e të jemi të mëshirshëm.

Mëshira është ndjenjë e posaçme dhe zemërbutësi, dhe nuk është ngurosim i zemrës, as ashpërsi.

Nuk ka më mirë se të stolisemi me këtë cilësi fisnike.

## MËSHIRA E ALLAHUT

***“E kur të vijnë ty ata që i besojnë ajetet tona, thuaju: “Selamun alejkum, Zoti juaj ia ngjeshi vetes mëshirën. Kush bën prej jush ndonjë të keqe pa dije, e mandej pas asaj (të keqe) pendohet dhe përmirësohet, s’ka dyshim se All-llahu është që falë shumë dhe është Mëshirues.”***

*(El-En’am, 54)*

Mëshira është cilësi e përhershme e Allahut:

***“Dhe cakto për ne (jetë) të mirë në Dunja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtet jemi kthyer kah Ti. Ai (Zoti) tha: “Dënimi im është ai me të cilin e godas cilin dua, e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët u ruhen (mëkateve), e japin zeqatin dhe për ata që i besojnë argumentet tona.”***

*(El-Ea’rafë, 156)*

Nga mëshira e Allahut, buron mëshira e prindërve ndaj fëmijëve, mëshira e familjarëve ndaj familjarëve, mëshira ndaj bashkëshortëve. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”***

*(Err-Rrum, 21)*

***“Zoti juaj (që meriton adhurim) është Një, All-llahu, nuk ka zot pos Atij që është mëshirëplotë, gjithnjë mëshiron.”***

*(El-Bekare, 163)*

Në hadithin Kudsij Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Mëshira Ime dominon mbi hidhërimin Tim.”***

Ajeti i parë i suretul Fatiha është: بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ – Në emër të Allahut Mëshirëbërësit Mëshiruesit.

***“Ai (Jakubi) tha: “A t’ju besoj për këtë, vetëm sikurse u besova më parë për vëllain e tij (Jusufin), po All-llahu është mbrojtësi më i mirë dhe Ai është mëshirues i mëshiruesve.” (Jusuf, 64)***

Mëshira e fundit do të jetë hyrja në Xhenet. Zoti i Lartmadhëruar i drejtohet Xhenetit dhe i thotë:

***“Ti (xhenet) je mëshira Ime me të cilën mëshiroj kë të dua nga robërit e Mi.”***

## MËSHIRA NË KUR'AN

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

*“Dhe cakto për ne (jetë) të mirë në Dunja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtet jemi kthyer kah Ti. Ai (Zoti) tha: “Dënimi im është ai me të cilin e godas cilin dua, e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata, të cilët u ruhen (mëkateve), e japin zeqatin dhe për ata që i besojnë argumentet tona.”*

*(El-Ea'rafë, 156)*

*“E ti thuaj: “O Zoti im, më fal e më mëshiro, se Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!”*

*(El-Muëminunë, 118)*

*“E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë (për ndihmë).”*

*(El-Beled, 17)*

## MËSHIRA NË SUNET

Muhamedi a.s. ka thënë:

*“Zoti mëshiron, nga robërit e Tij, ata që janë të mëshirshëm.”*

*“Ata që janë të mëshirshëm i mëshiron Mëshiruesi. Mëshironi ata që janë mbi tokë, t’ju mëshirojë Ai që është në qiell. “Mëshira është litar prej të Gjithëmëshirshmit. Kush e lidh atë, Allahu do të ndërlidhet me të, e kush e ndërpret, Allahu ndërpret lidhjet me të.”*

*(Tirmidhiu)*

*“Kush nuk është i mëshirshëm ndaj njerëzve, Allahu nuk është i mëshirshëm ndaj tij.”*

*(Transmeton Buhariu, Muslimi,  
Tirmidhiu dhe Ahmed)*

*“Nuk do të besoni përderisa nuk mëshironi.”*

*“Shembulli i muslimanëve në dashuri të ndërsjellët mes vete, në harmoni mes vete dhe në mëshirë mes vete është njësoj si shembulli i trupit, që kur të rënkton një organ i trupit, atëherë tërë trupi ndien dhembje dhe rënkton.”*

## MËSHIRA E PEJGAMBERIT s.a.v.s.

Emër i Pejgamberit s.a.v.s. është “Mëshirë”.

Një ditë, një burrë i thotë Pejgamberit s.a.v.s.: “O i Dërguar i Allahut, lute Zotin që t’i shkatërrojë idhujtarët.” Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

*“Vërtet, Zoti nuk më ka dërguar për të mallkuar, por për të mëshiruar.”*

***Ka prej tyre që e ofendojnë Pejgamberin, e thonë: “Ai është bërë vesh (beson çka dëgjon)”. Thuaj: “Ai është vesh i të mirës suaj (dëgjon të mirën dhe vepron, e jo të keqen), ai beson All-llahun (çka i thotë), u zë besë besimtarëve dhe është mëshirues për ata që besuan nga mesi juaj, e ata që nuk e lënë të qetë të dërguarin e All-llahun, ata kanë dënim të dhembshëm.***

*(Et-Tevbe, 61)*

Pejgamberi s.a.v.s. është pejgamber i mëshirës, mëshirues i udhëzimit, mëshirues i umetit të tij, dhe mëshirues i të gjithë botëve.

## MËSHIRA E PEJGAMBERIT S.A.V.S. NDAJ FËMIJËVE

Muhamedi s.a.v.s. e ka pasur një vajzë, e cila quhej Zejnebe. Pasi që Zejnebeja ishte martuar e kishte një djalë, mirëpo djali i saj sëmuret dhe ishte pranë vdekjes. Zejnebeja e lajmëron Pejgamberin s.a.v.s. Kur shkon Pejgamberi s.a.v.s. dhe e sheh foshnjën duke rënkuar nga dhimbjet dhe po vdiste, Pejgamberi s.a.v.s. filloi të qajë. Sead bin Muadhi i habitur i thotë: “A po qanë o Pejgamber i Allahut?!” Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: *“Po, o Sead, kjo është mëshirë që Zoti e vendos në zemrat e robërve të Vet.”*

## IBRAHIMI A.S. ME ZJARRPUTISTIN

Në Kur'an janë përmendur 28 pejgamberë. Prej tyre nga “Ulul Azmi” (Elitës së pejgamberëve) është Ibrahim a.s. Ai i donte udhëtarët, musafirët, dhe çdo herë kur shihte ndonjë kalimtar i jepte ushqim.

Një ditë e takon një kalimtar që ishte zjarrputist. Kur Ibrahim a.s. e nder zjarrin, i moshuari i përulet zjarrit duke e adhuruar. Kur e kuptoi Ibrahim a.s. se ai ishte adhurues i zjarrit, me të shpejtë i bërtet dhe e dëbon nga vendbanimi i vet duke i thënë: “Po si ushqehesh me të mirat e Zoti dhe adhuron zjarrin?! Ti nuk e meriton të ushqehesh me ushqimet që na ka dhënë Zoti.” Pasi i moshuari del jashtë, shkon Xhibrili te Ibrahim a.s. dhe i thotë se Zoti të thotë: “Unë e kam duruar atë për 60 vjet, kurse ti nuk e durove vetëm për një orë?!” Atëherë Ibrahim a.s. del duke e kërkuar plakun dhe e takon. Pasi e përshëndet, e fton të hante darkë tek ai. Plaku i thotë: “Më parë më dëbove, e si është e mundur, tani po më fton përsëri?” Ibrahim a.s. i thotë se Zoti më ka qortuar me sjelljen time ndaj teje.

Kur plaku e kuptoi, i thotë: “Një Zot i tillë e meriton të adhurohet”, dhe beson në Zotin.

## ISLAMI FE E MËSHIRËS

Udhëheqësi i muslimanëve, Salahudin Ejubi qëndronte në shatorin e tij. Një grua jomyslimane dëshironte të hynte aty, mirëpo rojet nuk e lejonin. Ajo filloi të qajë. Salahudin Ejubi e dëgjon zërin e saj duke qarë dhe urdhëron rojet që ta lejonin të hyjë brenda. Ajo kur hyri brenda i thotë: “Burri im është robëruar në luftë, ndërsa hajnat më kanë kidnapuar birin tim të vogël.

Salahudin Ejubi ndjen dhembje, zemra e tij u trondit. Për këtë arsye urdhëroi që burri i saj i robëruar të lirohet, ndërsa ushtarët tjerë i urdhëroi që t’ia gjejnë birin e saj.

Ushtarët pas një hulumtimi e gjejnë djalin e saj dhe ia sjellin. Ajo u gëzua pa masë. Salahudin Ejubi i thotë asaj: *“Morali islam na obligon që të jemi të mëshirshëm për të gjithë njerëzit.”* Gruaja thotë: “Po sa fe e mirë na qenka kjo fe, e cila urdhëron për mëshirë dhe ndihmë ndaj të dobëtëve.” Pastaj ajo dhe burri i saj e pranojnë islamin pasi që e kuptuan se Islami është fe e mëshirës.

## MËSHIRA NDAJ NJERËZVE

Muhamedi s.a.v.s. ka qenë dhe është njeriu më i mëshirshëm në fytyrën e tokës. E ka pasur zemrën e butë, kraharorin e gjerë.

Një ditë, një njeri i thotë Pejgamberit s.a.v.s.: “O i Dërguar i Allahut, lute Zotin që t’i shkatërrojë idhujtarët.” Pejgamberi s.a.v.s. ia ktheu:

*“Zoti nuk më ka dërguar për të mallkuar, por për të mëshiruar.”*

Zoti i Lartmadhëruar në hadith kudsij ka thënë:

*“Unë jam Zoti dhe Unë jam Mëshiruesi, kam krijuar lidhjet e gjakut dhe emrin e saj e kam emëruar nga cilësitë e Mia. Kush i mban afër njerëzit e farefisit, Zoti e mban atë, e kush i largon ata, Zoti e largon atë.”*

## MËSHIRA NDAJ PRINDËRVE

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an na ka urdhëruar që të lutemi për mëshirë ndaj prindërve, ku thotë:

***“Dhe thuaj: Zoti im! Mëshiroji ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël.”***

*(El-Isra, 24)*

Që nga lindja e fëmijës, lind ndjenja e mëshirës së ndërsjellët fëmijë-prindër dhe prindër-fëmijë.

Nënës i qanë zemra kur qanë fëmija, prindi pikëllohet kur fëmija nuk është i lumtur, ata e ndajnë kafshatën e gojës, për fëmijët. Për këtë arsye edhe Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

***“Zoti yt të ka obliguar që të mos adhuronit askënd tjetër përpos Tij, dhe të silleni mirë me prindërit.”***

*(El-Isra, 24)*

Pra, adhurimi ndaj Allahut është i ndërlidhur me respektin dhe mëshirën ndaj prindërve.

## NËNA ME FOSHNJËN E SAJ

Në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. një grua kishte qenë e robëruar. Kur e sheh një fëmijë të vogël në mesin e robërve, e përshkoi ngrohtësia dhe dashuria për të, ndjente mallëngjim dhe dashuri për të, edhe pse nuk e njohte. Pejgamberi s.a.v.s. kur e pa këtë ngjarje i pyeti sahabët:

***“Çka mendoni, a mundet kjo grua të hedhë fëmijën në zjarr?”***

Sahabët i përgjigjen: “Jo!”

Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. u tha:

***“Vërtet Allahu i Madhëruar është më i mëshirshëm ndaj robërve të vet se sa kjo grua ndaj fëmijës.”***

## MËSHIRA NDAJ FËMIJËVE

Njëra prej vajzave të Pejgamberit s.a.v.s. i dërgon të fala Pejgamberit s.a.v.s. dhe i tregon se një fëmijë i saj ka vdekur.

Pejgamberi s.a.v.s. i përcjell selamin dhe i thotë:

*“Vërtet Allahu jep dhe merr. Çdo gjë është e caktuar te Ai për afatin e vdekjes, për këtë arsye duro dhe llogarit në shpërblim.”*

Për së dyti e fton. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. shkon dhe e merr fëmijën e saj në krahavor dhe sytë e tij i mbushen me lot. Sead bin Ubadete r.a. i thotë: “O i Dërguar i Allahut, ç’është kjo, pse po qanë?!” Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

*“Kjo është mëshira, të cilën Allahu e ka caktuar të jetë në zemra të robërve të Tij. Vërtet Allahu prej robërve të Tij i mëshiron të mëshirshmit.”*

Ekrea bin Habisi ka qenë shok i Pejgamberit s.a.v.s. Ai i kishte dhjetë fëmijë dhe asnjërin prej tyre nuk e kishte puthur asnjëherë. Një ditë prej ditëve e sheh Pejgamberin s.a.v.s. duke e puthur nipin e tij, Hasanin r.a. - djalin e Alijut r.a. Në atë çast, Ekrea bin Habisi habitet dhe i habitur e pyet: “A kështu i puthni fëmijët tuaj?! Po ne nuk i puthmi asnjëherë.” Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. befasohet për ashpërsinë dhe ngurtësinë e tij me fëmijët e tij dhe fillon ta qortojë me një qortim të rreptë:

*“Çfarë mund të bëjë atëherë kur Allahu nga zemra jote e ka hequr mëshirën.”*

Muhamedi s.a.v.s. ia tërheq vërejtjen dhe i thotë:

*“Kush nuk mëshiron nuk mëshirohet.”*

## MËSHIRA NDAJ JETIMËVE

Jetimi është pjesëtar i shoqërisë, atij i ka humbur prindi që nga vegjëlja dhe nuk ka udhëzues, kujdestar dhe mbikëqyrës. Nëse ai lihet anash, dëmtohet shoqëria në përgjithësi. Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë Pejgamberit s.a.v.s.:

***“Ndërsa, sa i përket jetimit, mos i bërtit.”*** (Ed-Duha, 9)

Përkujdesjen dhe mirësjelljen ndaj jetimit Zoti i Lartmadhëruar e konsideron cilësi të besimtarëve ku thotë:

***“Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimit) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bënë të zymta dhe është shumë e vështirë. Po Allahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh.”***

(El-Insan, 8-12)

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

***“Unë dhe përkujdesësi i jetimit do të jemi në xhenet së bashku (kështu, duke bërë me shenjë), duke i bashkuar dy gishtat e dorës.”***

Një njeri është ankuar te Pejgamberi s.a.v.s. se është i ngurtë në zemër. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

***“Lëmoje kokën e jetimit dhe ushqej të varfrit.”*** (atëherë do të të zbutet zemra).

***“(Të mendoni) Për këtë botë dhe për botën tjetër. Dhe të pyesin ty për jetimët. Thuaj: “Po t’i ndihmoni në punët e tyre është më mirë, e nëse i përzieni (pasurinë e tyre me tuajën), ata janë vëllezërit tuaj. All-llahu di të dallojë qëllimkeqin nga qëllimmirin. E sikur të dëshironte All-llahu do t’ju rëndojë. All-llahu është më i fuqishmi, më i urti.”***

(El-Bekare, 220)

***“Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë ata hanë atë që mbush barkun e tyre zjarr dhe do të futen në zjarrin e xhehennemit.”***

(En-Nisa, 220)

***“A e ke parë ti (a e sheh) atë, që përgënjeshtroi përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër? Po ai është që e përzë në mënyrë të vrazhdë jetimin.”***

(En-Nisa, 220)

## MËSHIRA DHE KUJDESI NDAJ JETIMËVE

Musa a.s. ka qenë peygamber. Gjatë një udhëtimi është shoqëruar me Hidrin a.s. Në atë udhëtim ka mësuar çështje shumë interesante prej Hidrit pasi që Hidrit a.s. i është dhënë cilësia e mëshirës dhe dituria prej Allahut.

Duke udhëtuar Musa a.s. dhe Hidri arrin në një qytet. Aty kërkojnë ushqim dhe vendstrehim, mirëpo banorët ishin koprrac, ata as nuk u japin ushqim dhe as nuk i vendstrehojnë.

Duke kaluar në anën tjetër të qytetit e shohin një mur të vjetër, i cili ishte duke u rrëzuar, e që rrëzimi i atij muri do t'i dëmtonte kalimtarët dhe do të rrezikonte gjendjen e banorëve. Hidri a.s. i thotë Musaut a.s. që ta riparojnë atë mur. Pasi që e riparojnë Musa a.s. i thotë: “Po pasi e riparuam të kërkojmë kompensim.” Mirëpo Hidri i thotë: “Jo, nuk do të kërkojmë kompensim, sepse murin e kam riparuar për arsye tjetër. Arsyeja është se nën mur ishte vendosur një thesar i dy jetimëve, e rrëzimi i atij muri do të zbulonte thesarin e tyre, e atë do ta merrnin ai popull koprrac. Kështu që pas riparimit, fëmijët jetimë do të rriten, e pasi që të rriten Zoti do t'ua mundësojë atyre dy jetimëve që të arrijnë deri te zbulimi i atij thesari. Për këtë ngjarje Zoti i Lartmadhëruar në Suretu El-Kehf thotë:

“Vazhduan të shkojnë deri sa arritën te banorët e një qyteti që prej tyre kërquan t'u japin ushqim, po ata nuk deshën t'i pranojnë si musafirë (e as t'i ushqejnë), e ata të dy gjetën aty një mur që gati po rrëzohej, e ai e drejtoi atë (murin). (Musai) Tha: “Sikur të kishe dashur do t'u merrje shpërblim për këtë!”

Ai (i dijsihmi) tha: “Tash ka ardhur koha e ndarjes mes meje dhe mes teje, e unë do të tregoj për domethënien e asaj që nuk munde të keshë durim!”

**Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e do të varfërve që veprojnë në det, e unë desha ta bëj atë me të meta, ngase para tyre ishte një sundues që grabiste çdo anije (të aftë - pa të meta).**

**Sa i përket djaloshtit, dy prindërit e tij ishin besimtarë, e u frikësuan se ai do t'i shpie ata të dy në humbje e në mosbesim.**

**Deshëm që Zoti i tyre t'u japë në vend të tij një më të mirë se ai dhe më të afërt në respekt dhe në mëshirë (ndaj prindërve).**

**Përsa i përket murit, ai ishte i dy djelmoshave jetima të atij qyteti, e nën të ata kishin një thesar (ari) dhe babai i tyre ka qenë njeri i mirë, e Zoti yt dëshiroi që ata dy (jetima) ta arrijnë pjekurinë e vet dhe ta nxjerrin ata vetë thesarin e tyre. Kjo ishte mëshirë e Zotit tënd (ndaj tyre). Dhe unë nuk e punova tërë atë sipas bindjes sime (po sipas udhëzimit të Zotit). Ky, pra, është sqarimi i asaj për të cilën nuk munde të kesh durim!”**

*(El-Kehf, 77-82)*

## **DUAJA E JETIMIT**

Një pijanec dehej dhe për çdo dit mëkatonte. Një ditë të ftohtë dimri përderisa kalonte nëpër një rrugicë, aty sheh një fëmijë duke qarë prej urie, e që dridhej. Pasi që bisedon me të e kuptoi se ai ishte jetim. Jetimi e impresionoi kështu që i dha ushqim, e hoqi pallton e tij dhe ia veshi që ta mbrojë nga të ftohtit dhe shkon në shtëpi ku bie në gjumë të thellë.

Në gjumë sheh ëndërr se ka ndodhur Dita e Kijametit, njerëzit jepnin llogari. E Sheh veten e tij se si melekët e tërhiqnin për ta shpjerë në zjarr të Xhehenemit. Mirëpo gjatë rrugës e sheh se si jetimi lutej që atij t'i falen gabimet. Allahu ia pranon lutjen jetimit dhe urdhëron melekët që mos ta dënojnë pasi që ishte sjell mirë me jetimin. Njeriu zgjohet nga gjumi, kur e sheh veten në shtrat kërkon falje nga Allahu dhe e la alkoolin dhe mëkatet dhe vendos që gjithmonë t'u ndihmojë jetimëve.

## **MËSHIRA NDAJ TRUPIT**

Njeriu është i mëshirshëm ndaj trupit të tij kur largohet nga gjërat që e dëmtojnë shëndetin e tij, si alkooli duhani etj, etj.

Si mund të jetë njeriu i mëshirshëm ndaj të tjerëve, kur nuk është i mëshirshëm ndaj vetes së tij?!

## MËSHIRA NDAJ KAFSHËVE

Në një hadith, Pejgamberi s.a.v.s. tregon:

*“Përderisa një njeri udhëtonte, e kap etja, e gjen një pus të thellë, zbret në të dhe pi ujë. Pastaj del nga pusi, kur e sheh një qen duke gulçuar, i cili nga etja hante bimë. Njeriu thotë: “Këtë qen e paska kapluar etja, sikur që më kishte kapluar mua! Andaj zbreti në pus, e mbushi këpucën e vet me ujë, pastaj e kapi për gojë, e ngriti dhe i dha ujë qenit. Këtë veprim Allahu ia pranoi dhe e fali.” Shokët i thanë: “O Pejgamberi i Allahut, a edhe për kafshët shpërblehemi? Pejgamberi s.a.v.s. u thotë: “Për çdo gjallesë ka shpërblim.”*

Përderisa për mëshirën ndaj qenit falen gabimet, atëherë çfarë shpërblimi ka për mëshirën ndaj njerëzve?!

## ZOGU ME ZOGJTË E SAJ

Transmetohet nga Abdullahu r.a. se ka thënë:

*“Përderisa udhëtonim me Pejgamberin s.a.v.s., për një çast Pejgamberi s.a.v.s. u ndal për të kryer një punë të tij. Ndërsa ne duke pritur pamë një zog me dy zogj të vegjël të tij. I morëm zogjtë e vegjël. Kur u kthye zogu dhe nuk i pa të vegjlit e tij, u shqetësua shumë. Në atë moment erdhi edhe Pejgamberi s.a.v.s. dhe pyeti: “Kush i shkaktoi shqetësim këtij zogu, duke ia marrë të vegjlit e saj? Kthejani zogjtë e saj, kthejani zogjtë e saj. Bëhuni të mëshirshëm ndaj saj.”*

Po ashtu Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Kurrë nuk do të besoni, përderisa nuk bëheni të mëshirshëm.”*

## DEVEJA, E CILA KA QARË

Një ditë Pejgamberi s.a.v.s. hyri në kopshtin e një Ensari (shok të tij). Aty i afrohet deveja dhe nga sytë e saj pikonin lot. Pejgamberi s.a.v.s. me duart e tij fisnike fërkon devenë për koke, e ajo pushon së qari dhe qetësohet. Pejgamberi s.a.v.s. kërkon pronarin e devesë. Vjen një djalosh dhe i thotë: “Ajo është e imja, o Pejgamber i Allahut.” Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

*“A nuk i frikësohesh Allahut për shkak të kësaj kafshe, që Allahu ta ka dhënë në pronësi? Ajo po më ankohet se nuk po e ushqen sa duhet dhe se po e lodh për së tepërmi, duke e ngarkuar shumë.”*

## MACJA

Islami nuk lejon zemërgurtësi, qoftë edhe ndaj kafshëve. Islami ua zë për të madhe atyre që nuk kujdesen për dhembjet e tyre, andaj edhe ka sqaruar se njeriu për një të keqe që ia bën kafshës hyn në xhehenem.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Ka hyrë një grua në zjarr të xhehenemit, nga shkak se e ka lidhur një mace dhe as nuk e ka ushqyer, as nuk e ka lënë të lirë që të hajë prej ushqimeve në tokë.”*

*(Buhariu)*

## NË XHENET DO TË HYJMË ME MËSHIRËN E ALLAHUT

Pejgamberi s.a.v.s. na ka treguar se, më herët, derisa ishte Xhibrili më ka thënë:

*“O Muhamed, pasha Atë, i Cili të ka dërguar me të vërtetën dhe për vërtetësi, është një rob prej robërve të Allahut, i cili e ka adhuruar Allahun në një maje të një mali, të një ujdhesë, pesëqind vjet. Ujdhesa ka qenë e vogël tridhjetë pëllëmbë gjatësi dhe tridhjetë pëllëmbë gjerësi, ndërsa deti me gjatësi në secilën anë të ujdhesës 4000 fersah. Allahu i Lartmadhëruar ka mundësuar që në atë ujdhesë të jetë një burim uji sa gishti, i cili buronte ujë të ëmbël, i cili rridhte teposhtë, dhe aty një shegë, e cila për çdo natë jepte nga një frutë të pjekur për t’u ushqyer ditën. Kur bëhej natë zbriste dhe merrte abdest, e merrte shegën dhe e hante, pastaj i falej Zotit të Lartmadhëruar. Pastaj e ka lutur Allahun që t’ia merrte shpirtin në sexhde dhe që trupin e tij mos ta prishte toka, me qëllim që kur të ringjallet, të ringjallet duke bërë sexhde.”*

Pastaj ka vazhduar të tregoj: *“Ashtu edhe ka ndodhur. Dhe përderisa ne ecnim, lart e poshtë, e pamë një shenjë prej ku do të ringjallet në Ditën e Kijametit. Ai do të qëndrojë para Allahut të Lartmadhëruar dhe Zoti do të thotë: “Qojeni robin Tim në Xhenet me mëshirën Time.” Ai thotë: “O Zoti im. Me veprën time.” Zoti thotë: “Qojeni në Xhenet me mëshirën Time.” Ai thotë: “O Zoti im! Me veprën time.” Zoti thotë: “Qojeni në Xhenet me mëshirën Time.” Ai thotë: “O Zoti im! Me veprën time.”*

*Atëherë Zoti u thotë melekëve: “Peshojani begatitë e Mia me veprat e tij.” Kur ia masin në peshojë, shohin se vetëm shqisa e shikimit nivelizohet me adhurimin pesëqindvjeçar. Ndërsa tërë begatia tjetër e trupit të tij ishte shtesë. Dhe Zoti thotë: “Qojeni robin tim në zjarr.” Derisa e zvarritnin për në zjarr, ai thërret: “O Zoti im, me mëshirën Tënde më qo në Xhenet.” Zoti thotë: “Kthejeni.” Pasi që e kthyen qëndron para Zotit, e Zoti i thotë: “O robi Im! Kush të ka krijuar kur nuk ke qenë fare?” Ai përgjigjet: “Ti, o Zot.” Zoti i thotë: “Ti e krijove veten apo të krijova me mëshirën Time?” Zoti i thotë: “Kush të ka forcuar për adhurim pesëqindvjeçar.” Ai thotë: “Ti o Zoti im.”*

## **SI SHPËRBLEHEN TË MËSHIRSHMIT**

- Të mëshirshmit i do Allahu dhe i shpërblen me Xhenet.
- I mëshiron Allahu dhe i afron pranë Tij.
- Të mëshirshmit i donë njerëzit, iu afrohen atyre dhe kanë respekt për ta.
- I mëshirshmi i ngjason Pejgamberit s.a.v.s. në sjellje dhe shokëve të tij.

## ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR

Nga ky libër përfitojmë se:

- Cilësia e mëshirës është cilësi e Zotit të Lartmadhëruar;
- I Dërguari i Allahut ka qenë i butë dhe i mëshirshëm ndaj besimtarëve;
- Mëshira ndaj të vegjëlve e të mëdhenjve është cilësi e besimtarëve;
- Mëshira ndaj kafshëve është cilësi e besimtarëve;
- Xheneti është shpërblimi për të mëshirshmit;
- Xhehenemi është dënim për të pamëshirshmit;
- Ai i cili e ka zemrën e ngurtë nuk hyn në xhenet, sepse Allahu nuk e do zemërgurin;
- Zemërgurin nuk e duan njerëzit dhe largohen prej tij;
- Allahu nuk i mëshiron ata, të cilët nuk i mëshirojnë njerëzit.

## PËRFUNDIM

Të kujtojmë hadithin “*Zoti mëshiron nga robërit e Tij ata që janë të mëshirshëm.*”

Ndërsa, kujtimi është për ata që kanë zemër, që përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën.

Ndoshta kjo çka është e shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe e dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

# **BUJARIA DHE FISNIKËRIA**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

**21**



## BUJARIA

Bujaria është prej cilësive më të lavdëruara tek Zoti i Lartmadhëruar.

Zoti është Bujar dhe Fisnik. Nga Bujaria e Tij furnizohen të gjitha krijesat, nga bujaria e Tij është se i fal mëkatet e robërve të Tij dhe i pranon lutjet e tyre.

Bujaria absolute buron vetëm nga Zoti i Lartmadhëruar.

Bujaria është moral, i cili mbulon të metat, largon fatkeqësitë dhe lehtëson krizat.

Bujari është afër Zotit, afër Xhenetit dhe afër me njerëzit, ndërsa dorështrënguari është larg Zotit, larg Xhenetit dhe larg njerëzve.

Bujaria mund të jetë: bujaria me pasuri dhe bujaria me shpirt.

Çdo cilësi e mirë, nga e cila përfitojnë dhe kanë dobi të tjerët quhet Bujari.

Bujaria e shton respektin e të tjerëve ndaj teje.

Gradë e lartë e bujarisë është fytyra e çelur dhe buzëqeshja.

Njerëzit më bujarë në botë janë ata që dhurojnë dhe japin veten dhe shpirtin e tyre ashtu siç kanë vepruar banorët e Medinës (ensarët) dhe të Mekës (muhaxhirët) kur Muhamedi s.a.v.s. e ka bërë hixhretin.

Të gjithë pejgamberët kanë qenë bujarë, ndërsa bujari më i madh ndër njerëzit është Pejgamberi ynë, Muhamedi s.a.v.s.

Bujaria është shumë llojesh:

- **Bujaria me vetveten.** Këtu kemi të bëjmë atëherë kur njeriu është fisnik me veten e tij, nuk është koprrac, që veten e tij mos ta ushqejë, mos ta veshmbathë dhe mos t'ia plotësojë nevojat vetes së tij.

- **Bujaria me të tjerët.** Këtu kemi të bëjmë me të vepruarit e çdo vepre lavdëruese dhe largimi ndaj çdo vepre të keqe, qoftë me fjalë, qoftë me vepër.

Fisniku i kryen detyrat ndaj Allahut, fal namazin, agjëron ramazanin, jep zekatin, largohet nga të ndaluarat, i vepron ato me të cilat është urdhëruar. Fisniku i kryen edhe detyrat ndaj të tjerëve, p.sh.: i mban lidhjet farefisnore, viziton të sëmurët, e nderon musafirin, e ndihmon të drejtën dhe nuk e përkrah të padrejtën.

## FISNIKËRIA E ALLAHUT

Emër i bukur, prej 99 emrave të bukur të Allahut është emri i Zotit El-Kerim-Fisnik.

Në ajetet e para, të cilat i kanë zbritur Pejgamberit s.a.v.s. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Lexo! Se Zoti yt është më Fisniku!”*** (El-Alek, 3)

Në ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“O njeri, po ç’të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është Fisnik, i Cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi. Të formësoi në formën që Ai dëshiroi!”***

(El Infitar, 6-8)

Emri i Zotit, Bujar, Fisnik është se Ai është formëdhënës i të gjitha krijesave. Bujaria absolute buron vetëm nga Zoti i Lartmadhëruar.

## FISNIKËRIA NË KUR'AN

Në suretu Ibrahim Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën; Ai zbret ujin nga qielli e me të jep frutat për t’u ushqyer ju; dhe ju jep juve që të shfrytëzoni anijet për të lundruar me to nëpër dete, me autorizimin e Tij dhe u jep që të shfrytëzoni lumenjtë.” (Ibrahim, 31)*

Po ashtu në suretul Hadidë:

*“Besoni në Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe shpenzoni nga ato çka Ai ju ka lënë në dispozicion juve, se ata që kanë besuar nga ju dhe kanë shpenzuar, për ta ka shpërblim të madh!” (El-Hadidë, 7)*

Në suretul Bekare Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“Shembulli i atyre që shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugë të Allahut janë si shembulli i atij që mbjell kokërr nga e cila mbijnë shtat kallinj, dhe çdo kalli ka nga njëqind kokrra – Allahu ia shton shpërblimin më tepër atij që do, se Allahu është i Ditur dhe Mirëbërës.” (El-Bekare, 261)*

## FISNIKËRIA NË SUNET

Pejgamberi s.a.v.s. në shumë hadithe ka treguar për fisnikëri. Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë shembull tipik për bujari dhe fisnikëri. Ai jepte dhe shpërndante vazhdimisht. Kur i kërkohej diçka që e kishte gjithmonë e jepte. I donte fisnikët dhe bujarët dhe këshillonte të tjerët për fisnikëri. Prej haditheve të tij po përmendim me sa vijon:

*“O bir i Ademit, jep pasuri (të tjerëve) do të të jepet ty.”*

*(Muttefekun alejhi)*

Kur është pyetur Pejgamberi s.a.v.s. se cilat vepra janë më të mirat. Ai është përgjigjur:

*“Të ndihmosh me ushqim dhe të përshëndetësh me selam atë të cilin e njeh dhe që nuk e njeh.”*

*(Muttefekun alejhi)*

Muhamedi s.a.v.s. e ka konsideruar plotësim të besimit nderimin e musafirit kur ka thënë:

*“Kush beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit le ta nderojë musafirin.”*

*(Muttefekun alejhi)*

Në një hadith tjetër Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Në çdo mëngjes, kur robërit zgjohen, dy melekë zbresin. Njëri thotë: “O Zoti im, ai që jep shtoja pasurinë”. Ndërsa tjetri thotë: “O Zoti im, atij që nuk jep mos ia shto pasurinë.”*

*(Muttefekun alejhi)*

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Bujari është afër Zotit, afër Xhenetit dhe afër me njerëzit. Kurse dorështrënguari është larg Zotit, larg Xhenetit dhe larg njerëzve.”*

## KUR'ANI PËR KOPRRACINË

Koprraci vetëm tubon pasuri, numëron, llogarit, fsheh, nuk tregon, nuk ia jep të drejtën të varfërve, nuk e jep zekatin, ankohet me skamje. Për ta Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Mos të mendojnë se ata që bëjnë koprraci me çfarë u ka dhënë Allahu nga mirësitë e Tij se është në dobi të tyre, përkundrazi është në dëm të tyre. Së shpejti gjërat, për të cilat janë treguar dorështrënguar do t’u lidhen për qafe në Ditën e Kijametit. Allahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka. Allahu e di mirë atë që vepron.”***

*(Ali Imran)*

Koprracia është veti me të cilën nuk kënaqet koprraci vetëm me koprracinë e tij, por dëshiron që edhe të tjerët t’i bëjë koprracë. Për të tillët Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Të cilët vetëm bëjnë koprraci dhe kërkojnë edhe të tjerët të bëjnë koprraci. E kush bëhet koprrac, le ta dijë se Allahu është i Begatshëm, i Lavdishëm.”***

*(El-Hadidë, 24)*

## PRANOJENI ISLAMIN

I Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. ka qenë bujar dhe fisnik. Ai ishte i përgatitur që gjithmonë të ofronte ndihmë dhe të jepte. Disa prej njerëzve e kanë përqaftuar Islamin duke përjetuar fisnikërinë dhe bujarinë e Pejgamberit s.a.v.s., pra pasi që Muhamedi a.s. iu ka dhënë atyre. Mirëpo, më vonë pasi që ata i kanë mbushur zemrat e tyre me dritën e Islamit, atëherë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. është bërë më i dashur te ta se e tërë pasuria e kësaj bote.

Pejgamberi s.a.v.s. kishte një bagëti delesh. Një njeri, i cili jetonte afër atyre dy brigjeve, kur e sheh duke i kullotur delet aty, i pëlqejnë dhe shkon te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe ia kërkon bagëtinë. Pejgamberi s.a.v.s. pa u menduar shumë ia jep.

Ai njeri e merr bagëtinë, gëzohet shumë dhe shkon te populli i tij dhe u thotë atyre: “O populli im! Pranojeni Islamin, se, për Zotin, Pejgamberi s.a.v.s. nuk i frikohet varfërisë, ai është bujar dhe fisnik.

Në lidhje me këtë, Enes bin Maliku ka thënë:

*“Nëse një njeri e pranon Islamin vetëm për të përfituar këtë botë, pasi që të bëhet musliman, atëherë Islami i bëhet më i dashur se e tërë bota dhe gjithë çka ka në të.”*

*(Muslimi)*

## JUSUFI a.s.

Fisnikëria është cilësi, e cila i përmbledh të gjitha llojet e mirësive. Është e kundërta e koprracisë.

Kur është pyetur Pejgamberi s.a.v.s. se kush është njeriu më fisnik, është përgjigjur: *“Ai, i cili është më i devotshmi.”* Por, kur thonë se ne kemi për qëllim se cili është më fisniku konkretisht. Atëherë Muhamedi s.a.v.s. u thotë:

*“Njeriu më fisniku është Jusufi, i dërguari i Allahut, djali i të dërguarit të Allahut, dhe djali i dashamirit të Allahut.”*

*(Buhariu)*

Pejgamberi s.a.v.s. e ka titulluar Jusufin a.s. me titullin “Fisnik” nga shkaku se te ai janë përmbledhur të gjitha virtytet e mira. Pra, prej gradës së pejgamberisë, pastaj diturisë, bukurisë, ndërgjegjes, turpërisë, fisnikërisë, drejtësisë. Ai ka qenë prej atyre që kishte njohuri edhe për këtë botë edhe për botën tjetër. Ka qenë prej lozes së pejgamberëve dhe ka pasur moralin e bukur.

## GARA NË TË MIRA

Sahabët janë edukuar në shkollën e Pejgamberit s.a.v.s. Ata gjithmonë kanë garuar në të mira. Mirëpo Ebu Bekri Sidiki gjithmonë ua kalonte.

Një herë Pejgamberi s.a.v.s. kishte kërkuar që ata të jepnin sadaka. Që të gjithë shpejtojnë që ta kryejnë urdhrin e Pejgamberit s.a.v.s. Omer bin Htabi shkon në shtëpinë e tij dhe e merr gjysmën e pasurisë dhe e sjell para të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. Ai mendon në vetvete se kësaj radhe ia kam kaluar Ebu Bekri Sidikit. Kur e dorëzon, Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: “Sa pasuri ke lënë në shtëpinë tënde, për familjen tënde? Ai i thotë: “Gjysmën tjetër.” Pra, aq sa të kam sjell. Pas pak çastesh vjen Ebu Bekri Sidiki dhe e sjell tërë pasurinë e tij dhe ia dorëzon Pejgamberit s.a.v.s.

Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: “O Ebu Bekër, sa ke lënë pasuri për familjen tënde?” Ebu Bekri thotë: “Ua kam lënë pasuri Allahun dhe të Dërguarin e tij.” Atëherë Omeri thotë: “Për Zotin, këtij nuk mund t’ia kalojë askush për asgjë (duke pasur për qëllim Ebu Bekri Sidikin).

## FISNIKËRIA E OTHMANIT r.a.

Othmanit r.a. është dhëndri i dy bijave të Muhamedit a.s. Ai është halifeja i tretë i drejtë i muslimanëve. Ka qenë tepër bujar dhe fisnik.

Përderisa Muhamedi a.s. ka bërë hixhretin në Medine, atje ishte një pus (burim) me ujë, i cili ishte uji më i miri i Medinës. Pronari i ujit këtë ujë e shiste me të holla. Pejgamberi s.a.v.s. thotë: “Kush mund ta blejë këtë ujë dhe t’u japë muslimanëve falas ujë, që ata të mos blejnë më?” Atëherë shpejton Othmani r.a., e blen ujin i pari dhe e len vakëf për të pirë ujë muslimanët.

Xhamia në Medine, përderisa numri i falësve shtohet, oborrit e kishte të ngushtë. Muhamedi a.s. thotë: “Kush mund ta blejë pronën përreth që të zgjerohet hapësira e oborrit të xhamisë?” Atëherë shpejton Othmani r.a., e blen atë pronë i pari dhe e len vakëf për zgjerimin e oborrit të xhamisë.

Kur Pejgamberi s.a.v.s. nisej për në betejën e Tebukut, muslimanët kishin nevojë për përgatitje luftarake, mirëpo ata ishin të varfër. Muhamedi s.a.v.s. thotë: “*Kush e mobilizon ushtrinë për luftë kur ka nevojë, ai e fiton Xhenetin*”, shpejton Othmani r.a. i pari dhe e mobilizon ushtrinë prej pasurisë së tij.

## TREGTIA PROFITABILE

Abdurrahman bin Avfi r.a. ka qenë tregtar i suksesshëm. Me tregti ai ka fituar shumë pasuri, mirëpo me pasurinë e tij ka bërë tregti me Allahun dhe ka fituar shpërblime, sepse ai vazhdimisht jepte në rrugë të Allahut. Ai nuk dëshironte që vëllezërit e tij të mos kenë strehim dhe që të jenë të uritur.

Transmetohet se në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. gjysmën e pasurisë së tij e ka dhënë sadaka.

Po ashtu transmetohet se një herë tjetër i ka dhënë pesëqind kuaj në rrugë të Allahut. Një herë tjetër Abdurrahman bin Avfi i ka dhënë pesëqind deve në rrugë të Allahut.

## FALJA E BORXHEVE

Kajs bin Seadi r.a. kishte një arë, atë arë ia shet Muavi bin Ebi Sufjanit r.a. për nëntëdhjetë mijë dinarë. Gjysmën e të hollave ua jep si dhuratë njerëzve, ndërsa sa i përket gjysmës tjetër, ai e thërret një banor të Medinës dhe i thotë që të dal nëpër qytet dhe të thërret: “Kush ka nevojë për të holla le të shkoj te Kajs bin Seadi r.a. që të huazojë.” Kajs bin Seadi, çdo njeri që huazonte të holla te ai i regjistronte në një fletëregjistër.

Pas një kohe Seadi sëmuret, mirëpo si i sëmurë nuk e vizitonte asnjë njeri. Atëherë i thotë bashkëshortes së tij: “Përse nuk po më vizitojnë njerëzit?” Ajo i përgjigjet: “Ata kanë turp, pasi që të kanë borxh ty, e ende nuk e kanë larë borxhin.” Atëherë Seadi i merr regjistrat dhe ua dërgon që të gjithëve duke i lajmëruar ata se ua ka falur borxhin.

Të gjithë gëzohen dhe e falënderojnë Seadin për bujarinë dhe fisnikërinë e tij. Nuk kalon një kohë e shkurtë dhe shtëpia e Sead bin Kajsit mbushet me vizitorë.

## FISNIKËRIA NË FSHEHTËSI

Qytetarët e Bagdadit zgjoheshin në mëngjes për të kërkuar punë për t'i ushqyer fëmijët e tyre, mirëpo, posa dilnin nga shtëpitë e tyre, kur shohin se në pragun e shtëpisë së tyre gjendeshin kuleta të mbushura me të holla. Ato kuleta ishin vendosur derisa ata ishin duke fjetur. Ata i merrnin të hollat dhe pyesnin veten me habi se prej nga kanë ardhur këto të holla, kush i ka dërguar këto të holla.

Pas një kohe e kuptojnë se Ministri Abasit, Fadil bin Jahja e kishte urdhëruar nëpunësin e tij që në prag të shtëpisë së secilit të varfër të vendoste kuletë të mbushur me të holla. Këtë ai e kishte bërë fshehurazi, ashtu që kjo vepër të ishte me sinqeritet të plotë, vetëm për Allahun, dhe që mos ta shihte askush.

Fadël bin Jahja ka qenë fisnik, sa që vetëm për një natë ka shpenzuar 100 000 dinarë për nevojtarë. Ai tërë buxhetin e verës e shpenzonte për dimër, dhe tërë buxhetin e dimrit e shpenzonte për verë. Të gjithë e donin se, me të vërtetë, ai ishte bujar dhe fisnik.

## TË HOLLAT DHE SHTËPINË PO JUA DHUROJ

Një njeri i mirë kishte një shtëpi të bukur. Ai me familjen e tij jetonin të lumtur në atë shtëpi. Në atë shtëpi kishte qetësi dhe paqe, secili e nderonte dhe e respektonte njëri-tjetrin. Pas një kohe paraqitet një vështirësi ekonomike, kështu që vendosin ta shesin atë shtëpi. Një blerës lajmërohet për ta blerë atë shtëpi, të cilën e paguan me çmimin e kërkuar.

Blerësi e pranon shtëpinë, vendoset në të. Kur afrohet nata dëgjon një të qarë jashtë shtëpie.

E pyet dikë: “Përse po qanë dikush jashtë?”

I përgjigjet: “Ata janë familja e atij, prej të cilit e ke blerë këtë shtëpi.” “Po përse po qajnë?” Pyeti përsëri.

Ata përgjigjen: “Po ata janë të pikëlluar dhe të mërzhitur për shtëpinë, të cilën e kanë shitur.”

Blerësi kishte qenë njeri shumë bujar dhe fisnik. Ndjen një dhimbje për familjen e shitësit të shtëpisë. Kështu që urdhëron shërbëtorin e tij që të shkojë te ata dhe t’u thotë:

*“Të hollat, me të cilat e kam paguar shtëpinë mbani dhe po ashtu këtë shtëpi po jua dhuroj juve.”*

## FISNIKËRIA DHE TË QAJTURIT

Na ishte njëherë një njeri i pasur, ai ju premonte shokëve të tij ndihma dhe u ndihmonte, dhe çdo i varfër që i kërkonte ndihmë i ndihmonte. Aq shumë jepte pasuri sa që i harxhohet e tëra. Të varfrit e dinin shtëpinë e tij dhe shkonin vazhdimisht te ai. Një ditë prej ditësh në derën e tij troket dikush në derë. Kur e hapë derën e sheh se ishte një shok i vjetër, i cili kishte ardhur t'i kërkonte të holla. Njeriu e pranon, i ofron pritje dhe ia jep pasurinë e fundit, e cila i kishte mbetur. Ai e falënderon dhe shkon. Pasi që shoku i tij shkon, ky kthehet në shtëpi dhe fillon të qajë. Bashkëshortja e tij e pyet: “Përse po qan? Kishë arsye që të mos i jepje asgjë, a po e sheh se nuk kemi asgjë?!” Ai e shikon bashkëshorten e vet dhe i thotë: “Unë nuk po qajë për të hollat që ia dhashë shokut tim të vjetër, por, po qaj se përse nuk i kam dhënë shokut tim para se ai të vjen në këtë gjendje të vështirë, sa që është ngarkuar me borxhe.”

Pas pak kohe dikush troket në derë. Njeriu mendon se ndokush ka ardhur të kërkojë të holla, mirëpo kur e hapi derën e sheh një polic, i cili i kishte sjell një shumë të madhe të hollash dhe i thotë: “Zotëria im t'i ka dërguar këto të holla që ti të kesh, ashtu që mos ta ndërpresësh bujarinë tënde. I pranoi të hollat, falënderoi Allahun dhe e kuptoi se vërtet Allahu nuk ia humb shpërblimin atij që bën vepra të mira.

## PASURIA JOTE DHE PASURIA E HUAJ

Aishja r.a. e kishte prerë një dele. Prej mishit të deles e kishte ndal shpatullën për t'u ushqyer me familje, ndërsa pjesën tjetër ua kishte shpërndarë të tjerëve.

Kur Muhamedi s.a.v.s. e pyet: *“Çfarë ka mbetur prej saj (deles)?”* Ajo i thotë: *“Prej saj ka mbetur vetëm shpatulla.”* Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

*“E gjithë delja ka mbetur, përpos shpatullës.”* (Tirmidhiu)

Një ditë tjetër, Pejgamberi s.a.v.s. i pyet sahabët:

*“Cili prej jush e do më tepër pasurinë e trashëgimtarit të tij, se sa pasurinë e vet personale?”*

Ata përgjigjen: *“Çdo njëri prej nesh pasurinë e vet e do më tepër.”* Pejgamberi s.a.v.s. pastaj u thotë:

*“Pasuria e tij është ajo që e ka dhënë, ndërsa pasuria e trashëgimtarit të tij është ajo që e ka lënë pas!!”* (Buhariu)

## **ÇKA PËRFITOMJË NGA KY LIBËR**

Nga ky libër përfundojmë se:

- Bujaria dhe fisnikëria janë prej cilësive të lavdëruara te Zoti i Lartmadhëruar;
- Bujari është afër Zotit dhe afër Xhenetit;
- Bujaria shton respektin e të tjerëve ndaj teje;
- Të gjithë peygamberët kanë qenë bujarë dhe fisnikë;
- Peygamberi s.a.v.s. është shembull për fisnikëri dhe bujari;
- Allahu i Lartmadhëruar nuk i do koprracët;
- Bujaria shpërblehet nga Zoti i Lartmadhëruar.

## PËRFUNDIM

Të kujtojmë ajetin kur'anor:

***“Shembulli i atyre që shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugë të Allahut janë si shembulli i atij që mbjell kokërr nga e cila mbijnë shtat kallinj, dhe çdo kalli ka nga njëqind kokrra – Allahu ia shton shpërblimin më tepër atij që do, se Allahu është i Ditur dhe Mirëbërës.”***  
(El-Bekare, 261)

Ndërsa, kujtimi është për ata që kanë zemër, që përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën.

Ndoshta kjo çka është e shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe e dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

# **VËRTETËSIA**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

**22**



## VËRTETËSIA

Vërtetësia është e kundërta e gënjeshtërs. Vërtetësia është virtyt i mirë njerëzor dhe është prej vlerave më të mëdha të moralit. Vërtetësia është prej cilësive më të rëndësishme të besimtarit.

Vërtetësia është bazë e ndërtimit të shoqërisë dhe lumturisë. Çdo gjë në jetë është e ndërlidhur me vërtetësinë. Dobia dhe e mira njerëzore varet prej drejtësisë dhe vërtetësisë. Aty ku ka drejtësi dhe vërtetësi ka zhvillim, përparim, paqe dhe lumturi. Me drejtësi dhe vërtetësi janë zhvilluar popujt, dhe deri sa e kanë ruajtur drejtësinë dhe vërtetësinë kanë qenë në kulminacion të lumturisë.

Vërtetësia mund të jetë me fjalë dhe me vepër. Për këtë arsye thuhet: “Filani është i vërtetë në punën e tij”, “i vërtetë në fjalë”, “i vërtetë në luftë”, etj.

Të gjithë pejgamberët kanë qenë të vërtetë në fjalë dhe në vepra.

Zoti i Lartmadhëruar për Ismailin a.s. në Kur'an thotë:

***“Përkujto në libër Ismailin. Vërtet, ai ishte i vërtetë në realizimin e premtimeve të veta.”***

(Merjem, 54)

Me këtë cilësi është dalluar Pejgamberi s.a.v.s. para zbritjes së Kur'anit. Po ashtu me këtë cilësi është dalluar edhe shoku i tij, Ebu Bekri Sidiki, i cili ka qenë halifeja i parë.

Shoqëria e parë islame ka jetuar në paqe dhe lumturi, sepse ata kanë qenë të drejtë, kanë folur dhe kanë vepruar të vërtetën. Ata në çdo pore të jetës kanë qenë të vërtetë.

Islami kujdeset që muslimanët të edukohen, ashtu që zemrat e tyre të jenë të çiltra dhe gjuhët e tyre të jenë të pastra.

Muslimani është vërtet trim dhe nuk i frikësohet askujt tjetër, pos Allahut. Ndërsa gënjeshtari është frikacak, i cili u frikësohet njerëzve.

Pejgamberi s.a.v.s. edhe para shpalljes e ka pasur titullin “I vërtet”. Sepse në jetën e tij ai kurrë nuk ka gënjyer, por e ka folur vetëm të vërtetën.

Pejgamberi s.a.v.s. i ka urdhëruar që edhe sahabët të jenë të vërtetë.

E vërteta është shumë llojesh:

- Vërtetësia me Allahun (ta njohësh Allahun, t'i frikësohesh dhe t'i dëgjosh urdhrat e Tij).

- Vërtetësia me vetveten (që të mos jetosh në iluzione dhe shpresa të kota).

- Vërtetësia me njerëzit.

- Vërtetësia në adhurim (që të thotë atë që beson dhe është i bindur në të, dhe të flas atë që duhet ta flas, të hesht atë që duhet heshtur, dhe të veprojë atë që duhet vepruar).

Zoti i Lartmadhëruar besimtarëve u thotë:

***“O ju që besuat! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë, të drejtë, dhe të vërtetë (në fjalë dhe vepra).”***

*(Et-Tevbe, 119)*

Janë disa gjëra që nuk duhet paraqitur haptazi edhe pse janë të vërteta, si p.sh.: bartja e fjalëve të tjetrit, zbulimi i të metave të tjetrit, zbulimi i turpit të tjetrit, sekreti, etj.

Nuk stabilizohet imani i robit, deri sa t'i stabilizohet zemra; ndërsa nuk i stabilizohet zemra, derisa t'i stabilizohet gjuha. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar e ka mësuar Pejgamberin s.a.v.s. të bëjë këtë lutje:

***“Thuaj (lutu): O Zoti im, më shpjer në vendhyrje të vërtetë (ku do të jam dhe do të Jesh i kënaqur) më bën të dal nga venddalja e vërtetë (ku do të jem i kënaqur, dhe do të Jesh i kënaqur), dhe më dhuro nga Ti fuqi që do të më ndihmojë.”***

*(Isra, 80)*

Këtu janë gjashtë çështje:

- Hyrja në vërtetësi;
- Dalja në vërtetësi;
- Gjuha e vërtetë;
- Ulësja (vendqëndrimi) i vërtetë;
- Qëndrimi i vërtetë;

Në Ditën e Kijametit Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Kjo është Dita në të cilën të vërtetëve u sjell dobi vërtetësia e tyre. Atyre u takojnë kopshtet, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Allahun. Kjo është fitorja e madhe!”***

*(El-Maide, 119)*

## VËRTETËSIA NË KUR'AN

Zoti i Lartmadhëruar vërtetësinë e ka përmendur në shumë vende në Kur'an, sa që edhe fenë e ka simbolizuar me fjalën “e vërtetë”.

Në Kur'an Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Ai, i cili ka ardhur me të vërtetën dhe ai, i cili ka vërtetuar atë, ata janë të devotshmit.”***

*(Ez-Zumer, 33)*

Fjala ***“ka ardhur me të vërtetën”*** është për Xhibrilin a.s., ndërsa fjala ***“ka vërtetuar atë”*** është për Muhamedin s.a.v.s.

Zoti i Lartmadhëruar e ka cilësuar Vetën “i Vërtetë”, në ajetin ku thotë:

***“Dhe thuaje: “Allahu ka folur të vërtetën.” (Ali Imran, 95)***

Ndërsa, në ajetin tjetër:

***“Dhe kush është më i vërtetë në fjalë se sa Allahu.” (En-Nisa, 122)***

Po ashtu vërtetësia është cilësi e të gjithë peygamberëve, ajo çka kanë ftuar dhe ajo që kanë premtuar në thirrjet e tyre është e vërtetë:

***“Kjo është ajo çka ka premtuar i Gjithëmëshirshmi dhe kanë vërtetuar peygamberët.” (Jasinë, 41)***

Po ashtu vërtetësia është cilësi e të mirëve, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Dhe ata, të cilët besojnë në Allahun dhe në peygamberët e Tij, ata janë vërtetuesit.” (El-Hadidë, 9)***

## VËRTETËSIA NË SUNET

Librat e hadithit janë të stërm bushura me temat, të cilat flasin për vërtetësinë dhe rëndësinë e saj në jetë. Por ne do të përmendim vetëm disa prej tyre. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Bëhuni të drejtë dhe flitni të vërtetën, sepse vërtetësia të udhëzon për në mirësi, e mirësia të shpie në xhenet, dhe përderisa njeriu flet të vërtetën dhe i përmbahet të vërtetës, tek Allahu është i regjistruar njeri i vërtetë. Ndërsa rrena të shpie në kriminalitet, e kriminaliteti të shpie në xhehenem, dhe përderisa njeriu rren, tek Allahu është i regjistruar rrenacak.”*

*(Muttefekun alejhi)*

Hatixheja r.a. i ka thënë Muhamedit s.a.v.s.:

*“Vërtet ti e bën ndërlidhjen farefisnore dhe e flet të vërtetën.”*

*(Buhariu)*

*“Kush thotë “La ilahe il-lallah, vërtetësisht, ai do të hyjë në Xhenet.”*

*(Ahmedi)*

*Është pyetur Pejgamberi s.a.v.s.:*

*“A mund të jetë muslimani frikacak?”*

*Është përgjigjur: “Po”.*

*“A mund të jetë koprrac?”*

*Është përgjigjur: “Po”.*

*“A mund të jetë gënjeshtar?”*

*Është përgjigjur: “Jo”.*

*(Transmeton Maliku)*

## PEJGAMBERI S.A.V.S. DHE VËRTETËSIA

Para Islamit Pejgamberi ynë s.a.v.s. është dalluar me besnikëri dhe urtësi, kështu që ai e ka marrë titullin ES-SADIKUL EMINË – I vërteti besnik. Ai ishte flamurtar i vërtetësisë.

Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë i vërtetë në të folur, në vepër dhe në premtim. Ai ka pasur cilësinë e vërtetësisë në të gjitha format. Ai kurrë nuk ka gënjyer.

Nëse dikush e pyeste për diçka Pejgamberin s.a.v.s., ai i jepte përgjigje të vërtetë dhe të saktë. Nëse dikush ia besonte ndonjë send, ai e ruante atë dhe ia kthente pronarit. Nëse premtonte diçka, e përmbushte premtimin.

Pejgamberi s.a.v.s. i pengonte njerëzit nga rrena, mospërmbushja e premtimit, mashtrimi, dhe thoshte:

“Shenjat e dyftytrëshit janë tri:

- Kur flet rrenë;
- Kur premtion tradhton;
- Kur t’i besohet diçka, nuk e kryen atë që i besohet.”

Baza e besimit është vërtetësia, ndërsa baza e dyftytrësisë është rrena.

Përkundër asaj që pabesimtarët kanë luftuar kundër Pejgamberit s.a.v.s. ia besonin gjësendet e veta në ruajtje. Dhe kur Allahu i Lartmadhëruar e urdhëroi Pejgamberin e Vet që ta bëjë hixhretin, ai kërkoi prej Ali Ibën Ebi Talibit r.a. të mbetet në Meke dhe t’i kthejë gjësendet e besuara pronarëve të tyre.

Bekimi i Allahut dhe salavati qoftë mbi Pejgamberi tonë të Vërtetë e Besnik!

## VËRTETËSIA E PEJGAMBERËVE

Të gjithë pejgamberët kanë qenë vërtetues të së vërtetës, por Kur'ani në mënyrë të posaçme i përmend këta pejgamberë.

Për Ibrahimin a.s. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

***“Trego në libër për Ibrahimin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe pejgamber.”***

(Merjem, 41)

Për Idrisin a.s. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

***“Trego në libër për Idrisin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe pejgamber.”***

(Merjem, 56)

Për Ismailin a.s. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

***“Trego në libër për Ismailin! Vërtet, ai ishte i sinqertë në premtimet e veta, ishte i dërguar dhe pejgamber.”***

(Merjem, 54)

Po ashtu edhe nëna e Isa a.s., Merjemja ka qenë e vërtetë:

***“Po ashtu nëna e tij, e cila ka qenë e vërtetë.”***

(El Maide, 75)

Në krye të pejgamberëve për vërtetësi ka qenë Pejgamberi s.a.v.s., i cili me vërtetësi ka qenë i njohur edhe para shpalljes.

Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë edhe vërtetues, sepse ai është, i cili ka besuar në Allahun dhe i ka vërtetuar fjalët e Tij, ka ardhur me të vërtetën e Allahut, po ashtu i ka vërtetuar edhe pejgamberët e mëparshëm, edhe librat e tyre.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

***“Ai, i cili ka ardhur me të vërtetën, e ka vërtetuar atë, ata janë të devotshmit.”***

(Ez Zumer, 33)

## EBU BEKRI SIDIKI

Halifeja i parë i muslimanëve është **Ebu Bekri Sidiki**. Ai ishte fisnik, besnik, i dashur, i moralshëm, mendjemprehtë dhe i vërtetë. Ishte shok i ngushtë i Muhamedit s.a.v.s. Prej tij e kanë pranuar Islamin: Othmani r.a., Abdurrahman bin Avfi, Talha bin Ubejdullahu, Sead bin Ebi Vekasi dhe Zubejr bin Avami. Pasurinë e tij e ka harxhuar për Islam. Ai ka blerë robër dhe i ka liruar, e prej tyre ka qenë edhe Bilalli r.a.

Në vitin e dhjetë Muhamedi s.a.v.s. e ka bërë Isranë dhe Miëraxhin. Israja është udhëtim i shkurtër nate, udhëtim horizontal prej Mesxhidi Haramit në Mekë e deri në Mesxhidi Aksa në Jerusalem. Ndërsa, udhëtimi vertikal prej toke në lartësiat më të larta qiellore quhet Miëraxh.

Kur u kthye Muhamedi s.a.v.s. nga Miëraxhi solli dhuratën më të çmuar për ne, faljen e pesë kohëve të namazit.

Kur i thonë: “O Ebu Bekr, a është e vërtetë se Muhamedi s.a.v.s. ka shkuar në lartësira qiellore?! Ebu Bekri thotë: “Nëse e ka thënë Muhamedi s.a.v.s. atëherë ai gjithmonë e flet të vërtetën dhe është e vërtetë. Unë e besoj edhe shpalljen e tij dhe çdo gjë që i zbret prej Allahut”.

Për këtë arsye Pejgamberi s.a.v.s. e ka titulluar “Vërtetues i së vërtetës”, pra Ebu Bekri Sidiki është vërtetues i së vërtetës.

## E VËRTETA ËSHTË FUQI

**Bilalli r.a.** ka qenë muezin i Pejgamberit s.a.v.s. Ai e kishte zërin e bukur. Një ditë prej ditëve, së bashku me vëllanë e tij shkojnë te një familje kurejshite për të kërkuar dorën e fejesës për vëllanë e tij.

Bilalli i thotë: “Ju e dini për mua dhe vëllanë tim: Kemi qenë robër, por falë Zotit tani jemi të lirë; kemi qenë të humbur, por Zoti na ka udhëzuar në Islam; kemi qenë të varfër, por Zoti na ka pasuruar. Tash kam ardhur te ju që të kërkoj dorën e fejesës për vëllanë tim. Nëse pranoni, falënderojmë Zotin; nëse jo, atëherë çdo gjë është në rregull.”

Familja duke kuvenduar mes vete, njëri u thotë atyre: “Ju duhet ta dini se çfarë pozite dhe çfarë afërsie ka Bilalli te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. Andaj, mos u bëni neglizhent, por jepjani dorën e fejesës.” Pas konsultimit vendosin dhe e fejojnë vajzën e tyre për vëllanë e Bilallit r.a.

Pasi dalin nga shtëpia e tyre, vëllai i thotë Bilallit r.a.: “Zoti të ndihmoftë, po përse nuk u tregoje atyre pozitën tënde në islam?” Bilalli ia ktheu: “O vëllai im! Isha i vërtetë në atë që kam thënë. E ty më së shumti të ndihmoi fjala e vërtetë.”

## SI TË PAJISEMI ME VËRTETËSI

K shumë çështje, të cilat i ndihmojnë njeriut që të pajiset me cilësinë e vërtetësisë dhe të fitojë këtë virtyt të lartë. Prej tyre do të përmendim me sa vijon:

- Duhet ditur se vërtetësia të sjell dobi në këtë botë dhe sjell lumturi edhe në botën tjetër, edhe pse në shikim të parë duket se është e dëmshme, në esencë vërtetësia nuk sjell dëm, por vetëm dobi, sepse Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Thoni dhe pajisuni me të vërtetën edhe nëse e shihni apo e mendoni se ajo është e dëmshme, sepse në të vërtetë rezultati përfundimtar i vërtetësisë është shpëtimi dhe triumfi.”*

- Duhet ditur se vërtetësia është rruga, e cila të shpie në udhëzim, në kënaqësi ndaj Allahut, në falje të gabimeve dhe në Xhenet.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Nuk ka dyshim se vërtetësia shpie në mirësi, e mirësia shpie në xhenet, dhe përderisa njeriu flet dhe vepron të vërtetën Zoti e regjistron në libër njeri të vërtetë.”* (Muttefekun alejhi)

Zoti i Lartmadhëruar për ata që flasin dhe veprojnë me vërtetësi thotë:

***“Kjo është Dita në të cilën të vërtetëve u sjell dobi vërtetësia e tyre. Atyre u takojnë kopshtet, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Allahun. Kjo është fitorja e madhe!”***

*(El-Maide, 119)*

- Duhet ditur se gënjeshtria të sjell hidhërimin e Allahut ndaj teje dhe djegien në zjarr. Nuk ka dyshim se rrena shpie në mëkate, e mëkatet e shpie njeriun në zjarr të Xhehenemit dhe përderisa njeriu rren, te s.a.v.s. shkruhet se është rrenacak.

Për gënjeshtarët Zoti i Lartmadhëruar thotë:

***“Në Ditën e Kijametit do t'i shihni ata, që kanë trilluar gënjeshtria për Allahun, me fytyra të nxira. Vallë, a nuk është Xhehenemi vendqëndrim për kryelartët?!”***

*(Ez-Zumer, 60)*

## E VËRTETA EDHE NË MAHI

Pejgamberi s.a.v.s. e ka folur gjithmonë të vërtetën, e edhe kur është mahitur, por mahitë e tija kanë qenë të vërteta, e jo trillime dhe gënjeshtër.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Unë mahitem, por edhe në mahi e them vetëm të vërtetën.”*

Tregon një grua plakë se ka shkuar te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i ka thënë: “O i Dërguar i Allahut, lute Allahun që të më shpjerë në Xhenet.” Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë: “Po, në Xhenet nuk hyjnë plakat!” Pastaj vazhdon të tregojë plaka: “U pikëllova dhe fillova të qaja, duke menduar se kurrë nuk do të hyjë në xhenet. Mirëpo Pejgamberi s.a.v.s. u tregoi sahabëve që të ma bëjnë me dije se nuk do të hyj në Xhenet duke qenë plakë, por do të më shndërrojnë në vajzë të re, në gjendje të vajzërisë. Këtë e tregon Zoti i Lartmadhëruar në Kur’an:

*“Dhe do t’i bëjmë ato virgjëresha.” (El-Vakiah, 35-36)*

## REZULTATI I FJALËS SË VËRTETË

Në Bagdad jetonte një familje, e cila ishte e edukuar dhe kishte besim të plotë në Zotin. Në atë familje, një nënë e edukonte djalin e saj. Nëna ia mësonte të gjitha virtytet e moralit, ia mësonte Kur'anin, Hadithin, kështu fëmija u rrit dhe u edukua, e u bë besimtar i drejtë. Kur arriti moshën e re filloi të merrej me tregti. Nëna për në udhëtim tregtie ia jep 40 dinarë, dhe para se të nisej nga shtëpia i thotë: “Më premto se kurrë nuk do të gënjesh.” Djaloshi i premtoi dhe u nis për në udhëtim.

Përderisa karvani udhëtonte e sulmon një grup hajnash, të cilët filluan të plaçkitin gjithçka kishin. Kur hajnat arrijnë te djaloshi i thonë: “A ke diçka me vete?” Djaloshi tha: “Po, i kam me vete 40 dinarë.” Hajnat filluan të qeshin, menduan se djaloshi po tallej dhe e dërgojnë te prijësi i tyre. Prijësi i thotë: “Ku i ke 40 dinarët?” Djaloshi i nxori dhe ia tregoi. Në atë moment ai u befasua dhe i tha: “Po të kishe thënë se nuk ke asgjë me vete do të të kishim besuar, por çfarë të shtyri që ta shua të vërtetën? Djaloshi i thotë: “I kam premtuar nënës se do ta flas vetëm të vërtetën. Kjo thënie e impresionoi prijësin e hajnave, dhe i thotë: “Ti po i humb 40 dinarët vetëm e vetëm për të mbajtur premtimin ndaj nënës se do ta thuash të vërtetën dhe po ke frikë se po e rren nënën, ndërsa ne nuk po frikohemi se po e rrejmë Allahun. Dhe urdhëroi t’ia kthejnë djaloshit të hollat. Pastaj prijësi i hajnave tha: “Nga ky moment unë po pendohem.” Në atë moment edhe hajnat tjerë thanë: “Ti ke qenë prijësi ynë në plaçkitje, ndërsa sot je prijësi ynë në pendim, kështu që edhe të gjithë ne po pendohemi me ty.” Dhe të gjithë u pendua, ndërsa shkaktar kryesor ishte fjala e vërtetë e djaloshit të vogël.

## NUK LEJOHET RRENA AS NË ÇËSHTJE TË IMËTA

Muslimani është i drejtë, ai e do të vërtetën, vepron me të vërtetën, e thotë të vërtetën, angazhohet për të vërtetën. Ai e di se çdo gjë që nuk është e vërtetë, është rrenë.

Muslimani nuk bën dallim në mes të rrenës së vogël apo të madhe, në mes të rrenës së dëmshme, apo jo të dëmshme, sepse tek Allahu çdo veprim i tillë shkruhet rrenë.

Tregohet se një nënë e thërret djalin e saj të vogël, e i thotë:

“Eja të të jap diçka.” Kur e dëgjo i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e pyet atë nënë: *“Çfarë e ke ndërmend t’i japësh?”* Ajo i thotë: “E kam ndërmend t’i japë hurma të ëmbla.” Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. i thotë asaj: *“Po mos ta kishe pasur ndërmend t’i japësh diçka, (por vetëm që ta mashtroje) do të ishte regjistruar rrenë.”*

## E VËRTETA NË TREGTI

E vërteta duhet të jetë në fjalë, në sjellje, në vepra, por duhet të jetë edhe në tregti, edhe pse shumica e tregtarëve kur shesin, për ta shitur mallin e tyre, nuk e tregojnë të vërtetën. Për këtë Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Tregtari i vërtetë dhe besnik do të jetë me peygamberët, me të vërtetët dhe me dëshmorët.”* (Tirmidhiu)

*“Shitblerësit nëse flasin të vërtetën dhe këshillohen mes vete, shitblerja e tyre do të jetë e begatshme dhe e bekuar, ndërsa nëse rrejnë, dhe fshehin, atëherë begatia e shitblerjes hiqet nga ata, dhe nuk do të kenë bërëqet në shitblerjen e tyre.”* (Mutefekun alejhi, nga hadithi i Hakim bin Hazamit)

Tregohet se një njeri kishte qenë shitës qumështi. Mirëpo, ai qumështin e përziante me ujë. Kështu ai për një kohë të gjatë gjysmën e enës e mbushte me qumësht, ndërsa gjysmën tjetër me ujë. Një ditë prej ditësh e blen një majmun në treg. Me të udhëtoi me anije. Deri sa ishte ulur, i përvidhet majmuni dhe ia vjedh kuletën me para. Kur tregtari tentoi t’ia merrte të hollat, majmuni iku dhe u ngjit në maje të direktut të anijes dhe filloi ta gjuajë një dërrhem në ujë, kurse tjetrën në anije. Ashtu i gjuajti krejt çka kishte në kuletë, pastaj zbriti prej direktut. Tregtarit i ra ndërmend se çfarë kishte vepruar me qumështin, e kuptoi se Allahu i Lartmadhëruar secilit ia jep hakun e vet, dhe tha:

*“Ujit ia dha hakun e tij, kurse qumështit hakun e tij.”*

## MJAFTON FJALA E VËRTETË

Një njeri kishte shumë të meta, ai ishte i mbushur me gabime. Dëshironte të përmirësohej, por nuk kishte mundësi. Pas një analize, vendosi të shkonte te një njeri me famë, njeri, i cili ishte i njohur për iman dhe devotshmëri. Pasi ia tregoi gjendjen e tij kërkoi prej tij që ta këshillonte se si të përmirësohej.

Dijetari kërkoi që ai të largohej vetëm nga rrena. Kështu e porosi që ai gjithmonë ta flet vetëm të vërtetën.

Ky njeri u habit dhe mendoi në vetvete se kjo është çështja më e lehta në krahasim me mëkatet tjera që t'i përmbahet kësaj këshille.

Ditët kalojnë, ky njeri shkon në një restorant, porosi alkool. Kamerieri ia solli alkoolin në tavolinë, ky e mbush gotën, duke e vendosur alkoolin në gojë, e pyet veten e tij: Po nëse dijetari më pyet, a keni pirë alkool? Si do t'i përgjigjem. A ta gënjej, apo ta them të vërtetën? Jo nuk do ta pi alkoolin as tani, as kurrë. Kështu u largua nga alkooli.

Një ditë tjetër, ky njeri deshi të bënte një mëkat tjerë. Por, kur mendoi në vetvete se nëse dijetari do ta pyeste, a do t'ia tregoj këtë mëkat apo ta gënjej, apo ta them të vërtetën. Jo, pra nuk do ta bëj këtë mëkat.

Kështu çdo herë kur dëshironte të bënte ndonjë mëkat, nuk e bënte, që mos ta gënjente dijetarin. Kështu me kalimin e ditëve ai u largua nga të gjitha mëkatet dhe nga të gjitha të metat, vetëm pse iu përmbajt një këshille, e ajo këshillë ishte “vërtetësia”.

## **I VËRTETI DHE I DREJTI:**

- I vërteti dhe i drejti fiton dashurinë e Allahut, regjistrohet te Allahu i vërtetë, i drejtë dhe fiton Xhenetin;
- Bëhet i njohur si i vërtetë dhe i drejtë, për çka e donë njerëzit, ashtu siç e kanë dashur Pejgamberin s.a.v.s.
- Bëhet prej besimtarëve të vërtetë dhe të drejtë;
- Allahu e shpëton nga çdo e keqe për shkak të vërtetës së tij.

## **RRENACAKU:**

- Rrenacaku fiton hidhërimin e Allahut, regjistrohet te Allahu rrenacak, dhe dënohet me zjarr të xhehenemit;
- Bëhet i njohur si rrenacak, e nga ky shkak largohen njerëzit prej tij;
- Bëhet hipokrit dhe kriminel;

## PASOJA E GËNJESHTRËS

Pejgamberi s.a.v.s. ka shkuar prej Mesxhidi Haramit në Mekë, deri në Mesxhidi Aksa në Jerusalem. Ky udhëtim i tij quhet *Isra*. Pastaj Prej Mesxhidi Aksasë është ngritur në qiejt më të lartë, udhëtim, i cili quhet *Miëraxh*.

Gjatë Miëraxhit ka parë çështje shumë interesante dhe shumë të rëndësishme.

Njëra prej çështjeve që ka parë natën e Miëraxhit është, se e ka parë një njeri, të cilit i vendosej një shufër hekuri prej faqes së majtë, që t'i depërtonte në gjuhën e tij, pastaj ajo shufër i dilte në anën e djathtë të faqes së tij. Kur i dilte shufra e hekurt, i njëjti proces vazhdonte për të dytën herë, për të tretën herë, e kështu me radhë.

Pejgamberi s.a.v.s. e pyeti Xhibrilin: “Po kush është ky?”

Xhibrili i përgjigjet: “Ky është gënjeshtari, dhe kështu do të dënohet deri në Ditën e Kijametit.”

## FORMAT E GËNJESHTRËS

Gënjeshtrë quhet: Të thuash atë që nuk është e vërtetë dhe që nuk ka ndodhur. P.sh. të thuash: “E kam bërë këtë”, ndërsa nuk e ke bërë; ose “e kam parë filanin”, por nuk e ke parë.

Kjo cilësi është cilësi e munafikëve, të cilët i urren Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët.

Prej formave të gënjeshtrës janë:

1. Që njeriu të thotë se diçka është e imja, ndërsa në të vërtetë nuk është e tij. Ai e rren shokun, veten, por edhe Zotin e Madhëruar;
2. Të tregojë ndonjë gënjeshtrë, si p.sh., duke thënë: “Kam top, e në të vërtetë nuk ka;
3. Gënjeshtra ndaj prindërve. P.sh. Kur kthehet fëmija në shtëpi, prindërit kur ta pyesin se ku ka qenë, atëherë fëmija gënnen, duke thënë: “Kam qenë me filan shokun”, e në të vërtetë nuk ka qenë me të. Ose p.sh. thotë: “Kam qenë në shkollë dhe jam vonuar”.
4. Gënjeshtra ndaj mësuesit. P.sh. Kur nuk i bën detyrat, mësuesit i thotë: “Kam qenë i sëmurë”, ose ndonjë arsyer tjetër.
5. Prej formave të gënjeshtrës është: P.sh. Kur njeriu thotë: “Kam parë një ëndërr kështu e ashtu”, e në të vërtetë nuk ka parë ëndërr.
6. Dëshmia e rrejshme;
7. Përbetimi i rrejshëm;
8. Rrena në pendim;
9. Prej rrenave konsiderohet, që njeriu të flet çdo gjë që dëgjon;
10. Prej formave të rrenës është që të thuhet çdo gjë, vetëm e vetëm për të qeshur të tjerët.

## DËSHMIA JO E VËRTETË

Besimtari duhet të dëshmojë drejtë dhe të dëshmojë të vërtetën edhe nëse është në dëm të tij. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

*“O ju që besuat! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush, ose kundër të afërmeve dhe prindërve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni). Allahu është për ata vlerësuesi më i drejtë. Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë. Nëse ju ngatërmoni dëshminë ose i shmangeni asaj, s’ka dyshim se Allahu di ç’bëni ju.”*  
(En-Nisa, 135)

Dëshmia jo e vërtetë është prej mëkateve të mëdha.

Transmetohet nga Ebi Bekrete r.a. se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka pyetur: *“A dëshironi t’ju tregoj për mëkatet e mëdha?”* Ne i thamë: *“Po, si jo, o i Dërguar i Allahut.”* Pastaj u përgjigj:

- *“Idhujtaria ndaj Allahut;*
- *Sjellja e keqe ndaj prindërve, dhe*
- *Vrasja.*

*Ishte i mbështetur, pastaj u drejtua dhe ashtu siç ishte ulur tha: “dhe rrena në dëshmi”. Këtë të fundit e ndërpriste pa ndërprerë, sa që në vetvete thoshim, a thua kur do të ndalet.”*

*(Mutefekun alejhi)*

## FJALË E URTË

Të vërtetën e ka thënë i urti kur ka thënë:

*Kam parë*

*se bukuri e vërtetë*

*s’është bukuria e veprave*

*dhe shëmtim*

*është për shkak të cilësive të shëmtuara.*

*Virtyti më i mirë është*

*Të flitet e vërteta,*

*Kurse vepra më e shëmtuar*

*Është të flitet rrena.*

## ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR

Nga ky libër përfitojmë se:

1. I vërteti është i dashur i Allahut;  
Rrenacaku është armik i Allahut.
2. I vërteti është prej besimtarëve;  
Rrenacaku është prej hipokritëve.
3. Thuaje të vërtetën qoftë edhe e hidhët;
4. Shpëtimi është për të vërtetët;  
Shkatërrimi për gënjeshtarët.
5. I Dërguari i Allahut është titulluar “I vërtetë”;
6. Muslimani gjithmonë e fletë të vërtetën dhe asnjëherë nuk rrenë.

## PËRFUNDIM

Të kujtojmë hadithin:

*“Bëhuni të drejtë dhe flitni të vërtetën, sepse vërtetësia të udhëzon për në mirësi, e mirësia të shpie në xhenet, dhe përderisa njeriu flet të vërtetën, dhe i përmbahet të vërtetës, tek Allahu është i regjistruar njeri i vërtetë. Ndërsa rrena të shpie në kriminalitet, e kriminaliteti të shpie në xhehenem, dhe përderisa njeriu rren, tek Allahu është i regjistruar rrenacak.”*

*(Muttefekun alejhi)*

Ndërsa, kujtimi është për ata që kanë zemër, që përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën.

Ndoshta kjo çka është e shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe e dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.

## LITERATURA E KONSULTUAR

1. “Ibni Rexheb El-Hanbeli, “Xhamiul Ulumë vel hikem, sherh Hamsine hadithen min Xhevamiul kelem”. Botues “Mektebetu Daurath”.
2. Jasir Ali Nurë dhe Asim Abdul Fetah, “Silsiletul kasasul ahkam”.
3. Sehir Ahmed Ali, “Silsiletul Ahlak El-Islamijeti”.
4. Këshilli i dijetarëve më eminentë të “Ez-herit”, Hutab el-xhumu’ati vel idejnë”.
5. Muhamed Gazali, “Ahjau ulumud dinë”.
6. Akashete Abdul Memeni Et-Tibij, “Kasas Tujur vel hajvan fil Kitab ves-Suneti”.
7. Muhamed Muhamed Davud, “Mevakif ve iber”. Botues “Darul Menar.”
8. Ebu Bekr Xhabil El-Xhezairiju, “El-Ilmu vel ulema”.
9. Ahmed Aburrahim e Saih, “El-Fadilete vel Fedail fil Islam”.
10. Hanan Elham, “Hikajat El-Ehfadi”.
11. Abdul Azizë Sejid Heshin, “Silsiletu kasas adab el-Islami”.
12. Seid Hava, “Err-Rresul s.a.v.s.”. Botues “Darus-Selam”.
13. Hamid Ahmed Et-Tahir, “Min vesaja Err-Rresul lil etfalë”.
14. Muhamed Ali El-utbi, “50 Nesihate Nebevijeti minerr-Rresul lit tifli muslim”.
15. Sejid Muhamed Madij Ebul Azaim, “Mearixh El-Mukarrebine”.
16. Muhamed El-Gazilij, “Hulukul Muslim”.
17. Ahmed Ferid, “Et-terbijete ala menhexh ehli suneti vel xhemaati”.

## LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërimit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.
19. “Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem”.
20. “Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpiktë të Kur'anit”.
21. “Texhvidi i muslimanit të vogël”.
22. “Morali i muslimanit të vogël”.

## PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (nga autori Muhamed Sajim);
2. “Islami dhe Politika” (nga autori Jusuf Kardavi);
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (nga autori Abdurrezak Nufel);
4. “Për Kushtetutën Islame” (Dr. Muhamed Sejid Ahmed El- Musejer);
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (nga autori Abduhu Abas El-Velidi)
6. “Vlera e kohës” (nga autori Amër Halid);
7. “Vëllazëria muslimane” (nga autori Amër Halid);
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (nga autori Amër Halid);
9. “Pendimi” (nga autori Amër Halid);
10. “Pasojat e mëkateve” (nga autori Amër Halid);
11. “Vendosmëria në rrugën e Allahut (nga Amër Halid);
12. “Mjetet e vendosmërisë në rrugën e Allahut (nga Amër Halid);
13. “Shkurtimi i thonjve në dritën e sunetit dhe mjekësisë” (nga autorët Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir).
14. “101 Tregime për ta arritur kulminacionin e mirësisë dhe përsosmërinë e devotshmërisë” (nga autori Muhamed Eminë Xhundi).
15. “Fetavatë e Shaëravijut”.

## PËRMBAJTJA:

|                                                  |           |
|--------------------------------------------------|-----------|
| Hyrje.....                                       | 3         |
| <b>DASHURIA NDAJ ALLAHUT.....</b>                | <b>5</b>  |
| DASHURIA PREJ ALLAHUT.....                       | 7         |
| DASHURIA PËR ALLAH.....                          | 8         |
| DASHURIA E ALLAHUT .....                         | 9         |
| DASHURIA E ALLAHUT NDAJ ROBIT TË TIJ .....       | 10        |
| DASHURIA NDAJ TË DËRGUARIT S.A.V.S.....          | 11        |
| DASHURIA E SHOKËVE TË MUHAMEDIT A.S. PËR TË..... | 13        |
| DASHURIA NDAJ ATDHEUT.....                       | 15        |
| DASHURIA NDAJ PRINDËRVE .....                    | 16        |
| DASHURIA NË MES TË BASHKËSHORTËVE.....           | 18        |
| DASHURIA NDAJ FËMIJËVE.....                      | 19        |
| DASHURIA E JAKUBIT NDAJ JUSUFIT A.S. ....        | 20        |
| DASHURIA NDAJ VËLLAIT.....                       | 21        |
| ZEMRA E SHËNDOSHË .....                          | 22        |
| RREGULLAT E DASHURISË.....                       | 23        |
| DASHURIA DHE URREJTJA .....                      | 24        |
| ALLAHU I DO.....                                 | 25        |
| ALLAHU NUK I DO .....                            | 26        |
| POEZI.....                                       | 27        |
| LUTJE .....                                      | 28        |
| ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR .....                | 29        |
| <b>SINQERITETI.....</b>                          | <b>35</b> |
| SINQERITETI NË KUR’AN .....                      | 37        |
| SUREJA E SINQERITETIT – SURETUL IHLAS .....      | 40        |
| SINQERITETI NË HADITHË.....                      | 38        |
| SI TA FITOJMË SINQERITETIN.....                  | 41        |
| SINQERITETI NË ZEKAT DHE SADAKA .....            | 43        |
| SINQERITETI I ZEJNUL ABIDINIT .....              | 44        |
| SUHEJBI( R.A.).....                              | 45        |
| NAMAZI I PAPRANUAR.....                          | 46        |
| SINQERITETI SJELL SHPËTIM.....                   | 47        |
| FJALA E SINQERITETIT .....                       | 49        |
| DY DINARËT.....                                  | 50        |
| IDHUJTARIA E FSHEHTË.....                        | 51        |
| MUHAXHIRI I UMI KAJ SIT.....                     | 52        |
| SHKAKU I TË QAJTURIT .....                       | 53        |
| ÇLIRUESI I KËSHTJELLËS.....                      | 54        |
| MONEDHA FALSE.....                               | 55        |
| ÇKA PËRFUNDOJMË PREJ KËTIJ LIBRI .....           | 56        |

|                                             |                |
|---------------------------------------------|----------------|
| <b>DREJTËSIA</b> .....                      | <b>61</b>      |
| DREJTËSIA NË KUR'AN.....                    | 62             |
| DREJTËSIA NË SUNET .....                    | 63             |
| DREJTËSIA DHE BARAZIA NË MES FËMIJËVE ..... | 64             |
| VJEDHJA E GRUAS NGA FAMILJA ME FAMË.....    | 65             |
| URTËSIA DHE DREJTËSIA .....                 | 67             |
| DREJTËSIA E EBU BEKRI SIDIKIT.....          | 68             |
| DREJTËSIA E OMERIT.....                     | 69             |
| SHTËPIA E ABASIT(R.A).....                  | 70             |
| SI TA FITOJMË DREJTËSINË.....               | 71             |
| PËR NJË TË RËNË KOMPENSIMI ME HAXH .....    | 73             |
| THERA E PESHKUT.....                        | 74             |
| ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR .....           | 75             |
| PËRFUNDIM .....                             | 76             |
| <br><b>EMANETI</b> .....                    | <br><b>79</b>  |
| EMANETI NË KUR'AN .....                     | 83             |
| EMANETI NË SUNET .....                      | 84             |
| EMANETI I PEJGAMBERËVE .....                | 85             |
| SHKOPI INTERESANT .....                     | 86             |
| ARI I MBULUAR.....                          | 87             |
| EMANETI I OMERIT.....                       | 88             |
| BARIU BESNIK .....                          | 89             |
| VAJZA E CILA SHISTE QUMËSHT .....           | 90             |
| RROBA DHE KARAVANI.....                     | 91             |
| MALLI I KALBUR.....                         | 92             |
| PASURIA E PASTËR.....                       | 93             |
| RROBA E SHTRENTJË .....                     | 94             |
| DHURATA.....                                | 95             |
| EBU UBEJDETE BIN XHERRAHI .....             | 96             |
| DËNIMI I TRADHTISË .....                    | 98             |
| ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR .....           | 99             |
| <br><b>TURPI</b> .....                      | <br><b>103</b> |
| TRUPI NË KUR'AN.....                        | 104            |
| TURPI NË SUNET .....                        | 105            |
| SI TË PAJISEMI ME TURP .....                | 120            |
| TURPI PREJ ALLAHUT.....                     | 106            |
| TURPI PREJ KUR'ANIT.....                    | 107            |
| TURPËRIMI I PEJGAMBERIT S.A.V.S .....       | 108            |
| TURPI I MUSA A.S.....                       | 109            |
| OTHMANI R.A.....                            | 110            |
| TURPI I SEHABIJATES .....                   | 112            |
| VAJZA E SHUAJBIT A.S. ....                  | 113            |
| PEMA E MIRË.....                            | 114            |
| TURPI ËSHTË PREJ IMANI.....                 | 116            |
| TURPËRIMI I SINQERT.....                    | 117            |
| TURPI DHE SHKATËRRIMI I NJERIUT .....       | 118            |

|                                                     |            |
|-----------------------------------------------------|------------|
| VAJZA E TURPËRUAR .....                             | 119        |
| ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR .....                   | 123        |
| PËRFUNDIM .....                                     | 124        |
| <b>MORALI .....</b>                                 | <b>127</b> |
| MJETET E MORALIT .....                              | 129        |
| MORALI NË KUR'AN .....                              | 130        |
| MORALI NË HADITHË .....                             | 131        |
| MORALI I MUHAMEDIT S.A.V.S. ....                    | 132        |
| EDUKATA ME ALLAHUN .....                            | 133        |
| EDUKATA ME TË DËRGUARIN E ALLAHUT .....             | 134        |
| DETYRAT NDAJ ALLAHUT XH.SH. ....                    | 135        |
| DETYRAT NDAJ TË DËRGUARIT TË ALLAHUT S.A.V.S. ....  | 136        |
| NËSE PRONARI NUK MË SHEH, ALLAHU MË SHEH .....      | 137        |
| MORALI DHE BESIMI .....                             | 138        |
| MORALI DHE NAMAZI .....                             | 140        |
| MORALI DHE ZEKATI .....                             | 141        |
| MORALI DHE AGJËRIMI .....                           | 142        |
| MORALI DHE HAXHI .....                              | 143        |
| EDUKATA NË RRUGË .....                              | 144        |
| ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR .....                   | 145        |
| PËRFUNDIM .....                                     | 146        |
| <b>DURIMI .....</b>                                 | <b>149</b> |
| DURIMI NE KUR'AN .....                              | 151        |
| DURIMI NË SUNET .....                               | 152        |
| DURIMI I EJUBIT A.S. ....                           | 153        |
| DURIMI I TË VARFËRVE .....                          | 154        |
| DURIMTARËT SHKOJNË NË XHENET PA DHËNË LLOGARI ..... | 155        |
| DURIMI DHE FALËNDERIMI .....                        | 156        |
| URVET BIN ZUBEJRI, BABA I DURIMTARËVE .....         | 157        |
| NËNA DURIMTARE .....                                | 158        |
| DURO DHE LLOGARIT .....                             | 159        |
| DURIMI DHE URTËSIA .....                            | 160        |
| NË TRONDITJEN E PARË .....                          | 161        |
| DURIMI DHE MËSHIRA .....                            | 162        |
| SI TË BËHEMI DURIMTARË .....                        | 163        |
| DIJETARI DHE LUANI NË BURG .....                    | 165        |
| <b>FALËNDERIMI .....</b>                            | <b>166</b> |
| FALËNDERIMI NË KUR'AN .....                         | 167        |
| FALËNDERIMI NË SUNET .....                          | 168        |
| FALËNDERIMI PËR BEGATITË E ALLAHUT XH. SH. ....     | 168        |
| FALËNDERIMI I MUHAMEDIT S.A.V.S. ....               | 169        |
| FALËNDERIMI I SULEJMANIT A.S. ....                  | 170        |
| LLUKMANI A.S. ....                                  | 171        |
| FALËNDERIMI I PRINDIT .....                         | 171        |
| FALËNDERIMI DHE LARGIMI I THERËS. ....              | 172        |
| FALËNDERON PËR TË PAKTËN SHPËRBLEHESH SHUMË .....   | 173        |

|                                                        |            |
|--------------------------------------------------------|------------|
| QENI I URITUR .....                                    | 174        |
| SEXHDE FALËNDERIMI .....                               | 175        |
| MOS U ANKO .....                                       | 176        |
| USHQIMI DHE FALËNDERIMI .....                          | 177        |
| VENDI I SEBEIT .....                                   | 178        |
| ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR .....                      | 179        |
| PËRFUNDIM .....                                        | 180        |
| <b>BAMIRËSIA .....</b>                                 | <b>183</b> |
| DYERT E BAMIRËSISË .....                               | 186        |
| BAMIRËSIA NË KUR'AN .....                              | 184        |
| BAMIRËSIA NË SUNET .....                               | 185        |
| BAMIRËSIA NË ADHURIM .....                             | 186        |
| URDHËRESA PËR BAMIRËSI TË PËRGJITHSHME .....           | 187        |
| MIRËBËRËSI .....                                       | 188        |
| BAMIRËSIA ME PRINDËR .....                             | 189        |
| BAMIRËSIA NDAJ PRINDIT TË SJELLË TË MIRA NË JETË ..... | 190        |
| SHEHADETI .....                                        | 191        |
| BAMIRËSIA ME FËMIJË .....                              | 192        |
| BAMIRËSIA NË TË FOLUR DHE DIALOG .....                 | 193        |
| BAMIRËSIA NË DHËNIE TË PASURISË .....                  | 194        |
| BËN MIRË ME ATË QË TA KA DHËNË ALLAHU .....            | 195        |
| BAMIRËSIA NDAJ TË VARFËRVE .....                       | 196        |
| BAMIRËSIA NDAJ GJALLESAVE .....                        | 197        |
| PËRFUNDIMI I BAMIRËSVE .....                           | 198        |
| ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR .....                      | 199        |
| PËRFUNDIM .....                                        | 200        |
| <b>MËSHIRA .....</b>                                   | <b>203</b> |
| MËSHIRA E ALLAHUT .....                                | 205        |
| MËSHIRA NË KUR'AN .....                                | 206        |
| MËSHIRA NË SUNET .....                                 | 207        |
| MËSHIRA E PEJGAMBERIT s.a.v.s. ....                    | 208        |
| MËSHIRA E PEJGAMBERIT S.A.V.S. NDAJ FËMIJËVE .....     | 209        |
| IBRAHIMI A.S. ME ZJARRPUTISTIN .....                   | 210        |
| ISLAMI FE E MËSHIRËS .....                             | 211        |
| MËSHIRA NDAJ NJERËZVE .....                            | 212        |
| MËSHIRA NDAJ PRINDËRVE .....                           | 213        |
| NËNA ME FOSHNIJËN E SAJ .....                          | 213        |
| MËSHIRA NDAJ FËMIJËVE .....                            | 214        |
| MËSHIRA NDAJ JETIMËVE .....                            | 215        |
| MËSHIRA DHE KUJDESI NDAJ JETIMËVE .....                | 216        |
| DUAJA E JETIMIT .....                                  | 218        |
| MËSHIRA NDAJ TRUPIT .....                              | 218        |
| MËSHIRA NDAJ KAFSHËVE .....                            | 219        |
| ZOGU ME ZOGJTË E SAJ .....                             | 219        |
| DEVEJA, E CILA KA QARË .....                           | 220        |
| MACJA .....                                            | 220        |

|                                                  |            |
|--------------------------------------------------|------------|
| NË XHENET DO TË HYJMË ME MËSHIRËN E ALLAHUT..... | 221        |
| SI SHPËRBLEHEN TË MËSHIRSHMIT .....              | 222        |
| ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR .....                | 223        |
| PËRFUNDIM .....                                  | 224        |
| <b>BUJARIA .....</b>                             | <b>227</b> |
| FISNIKËRIA E ALLAHUT .....                       | 228        |
| FISNIKËRIA NË KUR'AN .....                       | 229        |
| FISNIKËRIA NË SUNET .....                        | 230        |
| KUR'ANI PËR KOPRRACINË.....                      | 231        |
| PRANOJENI ISLAMIN .....                          | 232        |
| JUSUFI a.s.....                                  | 233        |
| GARA NË TË MIRA .....                            | 234        |
| FISNIKËRIA E OTHMANIT r.a. ....                  | 235        |
| TREGTIA PROFITABILE.....                         | 235        |
| FALJA E BORXHEVE .....                           | 236        |
| FISNIKËRIA NË FSHEHTËSI.....                     | 237        |
| TË HOLLAT DHE SHTËPINË PO JUA DHUROJ .....       | 238        |
| FISNIKËRIA DHE TË QAJTURIT .....                 | 239        |
| PASURIA JOTE DHE PASURIA E HUAJ .....            | 240        |
| ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR .....                | 241        |
| PËRFUNDIM .....                                  | 242        |
| <b>VËRTETËSIA .....</b>                          | <b>245</b> |
| VËRTETËSIA NË KUR'AN .....                       | 247        |
| VËRTETËSIA NË SUNET .....                        | 248        |
| PEJGAMBERI S.A.V.S. DHE VËRTETËSIA .....         | 249        |
| VËRTETËSIA E PEJGAMBERËVE.....                   | 250        |
| EBU BEKRI SIDIKI .....                           | 251        |
| E VËRTETA ËSHTË FUQI.....                        | 252        |
| SI TË PAJISEMI ME VËRTETËSI .....                | 253        |
| E VËRTETA EDHE NË MAHI .....                     | 254        |
| REZULTATI I FJALËS SË VËRTETË .....              | 255        |
| NUK LEJOHET RRENA AS NË ÇËSHTJE TË IMËTA.....    | 256        |
| E VËRTETA NË TREGTI.....                         | 257        |
| MJAFTON FJALA E VËRTETË.....                     | 258        |
| PASOJA E GËNJESHTRËS .....                       | 260        |
| FORMAT E GËNJESHTRËS .....                       | 261        |
| DËSHMIA JO E VËRTETË .....                       | 262        |
| ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR .....                | 263        |
| PËRFUNDIM .....                                  | 264        |
| LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit).....       | 266        |
| PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE .....                 | 266        |

Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

28:17

Vërbani, Musli  
Morali i muslimanit të vogël / Musli Vërbani. – Kaçanik,  
[Autori], 2011. – 272. f. ; 21 cm.

**ISBN 978-9951-585-52-1**